

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

MINISTRIA E KULTURËS

2015-2020

Nr.	Data e rregjistrimit të kërkesës	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Statusi i kërkesës	Tarifa
1	09.04.2015	Kërkesë për vënie në dispozicion të informacionit në lidhje me ndërtimet dhe ndryshimet në listën arkitekture të Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli“	Pasi ka kaluar për shqyrtim në institucionin përgjegjës është kthyer përgjigje në datën 25.05.2015 bashkëlidhur përgjigja e institucionit kompetent për këtë çështje	Përfunduar	Nuk ka
2	20.04.2015	Kërkesë për informacion lidhur me procedurën ligjore dhe rregulloren e re të administrimit të Zonës B	30.04.2015 Dërgohet shkresa ku cilësohen dokumentat që duhet të paraqiten	Përfunduar	Nuk ka
3	27.05.2015	Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit lidhur me prodhimin, transmetimin e spoteve	23.06.2015 Kthim përgjigje:MK bazuar në VKM nr.1195, datë 05.08.2008 për blerjen, zhvillimin dhe prodhimin e programeve dhe	Përfunduar	Nuk ka

		publicitare, reklamave si dhe njoftimeve të botuara në shtypin e shkruar nga MK për periudhën 01.09.2013-01.03.2015	reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botimin në median e shkruar si dhe kontratat për kohë transmetimi nga organet e administratës shtetërore“ ju bën me dije se institucioni jonë për periudhën 01.09.2013-31.12.2013 dhe 2014-2015 nuk ka bërë asnjë praktikë të tillë.		
4	04.06.2015	Kërkesë për dokumentacion	11.06.2015 Vënie në dispozicion të fotokopjeve të dokumentacionit	Përfunduar	Nuk ka
5	15.06.2015	Kërkesë për vënie në dijeni nëse ka ndonjë vendim apo udhëzim tjetër vec vjetarit kulturor të vitit 93 dhe me shfuqizimin e vendimit nr.309 dt 21.06.1993 a ka vendim tjetër se si duhet të shpërblehen amatorët	23.06.2015 Kthim përgjigje: Referim në Ligjin nr.10352, datë 18.11.2010 Për Artin dhe Kulturën“ Kreu VI i ndryshuar Vendimi nr.709, datë 24.10.2012 për procedurat e financimit të projekteve dhe veprimtarive kulturore e artistike“	Përfunduar	Nuk ka
6	19.06.2015	Kërkohet njohja me procedimin administrativ	02.07.2015 Përcillet dokumentacioni në lidhje me procedurat e sistemit dhe	Përfunduar	Nuk ka

			informacion mbi ecurinë		
7	07.07.2015	Sugjerim për prishjen e një godine të emërtuar “Shtëpia e bardhë“ në Berat	Nuk është kthyer përgjigje pasi nuk ka adresë dërguesi, as emër dhe as ndonjë të dhënë tjetër të nevojshme për kthimin e përgjigjes		
8	20.07.2015	Kërkesë	21.07.2015 Kthyer përgjigje me anë të të cilës informohet mbi mundësitë që ofron Ministria e Kulturës për mbështetjen e projekteve në fushën e artit dhe të librit	Përfunduar Është kthyer letra pasi personi ndodhet jashtë Shqipërisë	Nuk ka
9	20.07.2015	Ankesë	23.07.2015 Kthyer përgjigje mbi shqyrtimin e ankimit dhe me informacion mbi bazën ligjore mbi të cilën duhet bazuar	Përfunduar	Nuk ka
10	12.08.2015	Kërkesë për vënie në dispozicion dokumentacioni	02.09.2015 Kthyer përgjigje ku i janë bashkëlidhur dokumentat përkatës	Përfunduar	Nuk ka
11	17.09.2015	Kërkesë për vënie në dispozicion dokumentacioni	29.09.2015 Kthyer përgjigje ku i janë bashkëlidhur dokumentat e kërkuar	Përfunduar	Nuk ka
12	25.09.2015	Kërkesë për informacion dhe dokumentacion për kalimin në përdorim të objektit “Ish Vendkomanda e Shtabit të Përgjithshëm“ nr 0744“	06.10.2015 Kthyer përgjigje Ministria e Kulturës nuk ka inicuar asnjë projektvendim për kalimin e pronës së kërkuar në përdorim të saj. Objekti ,“Bunkeri antibërthamor i Linzës“ (objekti 0774,	Përfunduar	Nuk ka

			vendkomanda taktike e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, pranë batalionit të mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura , nr.8010) administrohet nga Ministria e Mbrojtjes në bazë të VKM-së nr.515, datë 18.7.2003 ,“Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes“të ndryshuar. Në ambjentet e kësaj godine është zhvilluar aktiviteti kulturor artistik me titull ,“BUNKART-70 vjet pas çlirimit“. Ky aktivitet ka pasur për qëllim mbajtjen e ekspozitës video muzeale me video instalacione, tinguj, fotografi, drita, imazhe objekte dhe pajisje të tjera dixhitale për të krijuar një rrugëtim historiko emocional të ngjarjeve kryesore historike të periudhës 1939-1944. Ministria e Mbrojtjes është		
--	--	--	--	--	--

			administratore e ligjshme e objektit ndërsa Ministria e Kulturës mbështeti veprimtarinë kulturore artistike dhe muzeale të projektit.		
13	28.09.2015	Kërkesë për informacion	14.10.2015 Kthyer përgjigje nga DRKK Shkodër, informacion lidhur me monumentet në Kukës dhe Has	Përfunduar	Nuk ka
14	15.10.2015	Kërkesë për informacion lidhur me buxhetin e MK-së për vitin 2014 për reklamat në median e shkruar dhe atë audiovizive si dhe cilat media kanë qenë përfitues të këtij buxheti dhe me çfarë baze ligjore është shpërndarë buxheti i reklamave për vitin 2014	02.11.2015 Kthyer përgjigje: Ministria e Kulturës për vitin 2014 nuk ka realizuar asnjë procedurë prokurimi për reklamat në median e shkruar dhe atë audiovizive, por vetëm njoftime për tendera në median e shkruar. Baza ligjore për realizimin e prokurimit të reklamave jnë VKM-të specifike, konkretisht VKM nr.623, datë 29.09.2007 për prokurimin e prodhimeve/transmetimeve të reklamave dhe spoteve nga organet e institucioneve shtetërore në media” dhe VKM nr.1195, datë 5.08.2008 “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve/ të	Përfunduar	Nuk ka

			reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në median e shkruar dhe për kontratat për kohë transmetimi nga organet e institucioneve shtetërore		
15	20.10.2015	Kërkohet informacion lidhur me fondet publike që MK ka ofruar gjatë vitit 2015 për organizatat e shoqërisë civile, sa është numri që kanë aplikuar për fonde, sa është numri që kanë përfituar fonde, sa është shuma min dhe max e përftuar nga një organizatë, sa është numri i shërbimeve të prokuruar nga organizatat gjatë vitit 2015, sa është shuma totale e kontratatve për shërbimet e prokuruar,sa organizata kanë përfituar mbështetje	5.11.2015 Kthyer përgjigje: Shuma e fondeve që MK ka ofruar për organizatat e shoqërisë civile për vitin 2015 është 31.588.600 lek, numri i organizatave që kanë aplikuar është 118, numri i organizatave që kanë fituar fonde është 47, shuma maksimale e fondit të përftuar është 2.200.000 lekë, shuma minimale e përftuar është 107.000 lekë, Për sa i përket numrit të shërbimeve të prokuruar nga organizatat e shoqërisë civile për vitin 2015, nuk ka. Lloji i mbështetjes financiare të ofruar:vënia në dispozicion e ambjenteve për realizimin e projekteve të ndryshme, burime njerëzore/staf.	Përfunduar	Nuk ka

		jofinanciare gjatë 2015, cili ka qenë lloji i mbështetjes jofinanciare të ofruar?			
16	18.04.2016	Kërkesë për informacion nga institucionet publike rreth mbështetjes së OSHC në lidhje me çështjen e LGBT gjatë vitit 2015	10.05.2016 Kthim përgjigje: Ministria e Kulturës shpalli thirrjen për Projekt-Propozimet në fushën Art-Kulturë në harkun kohor 17 nëntor 2014-9 janar 2015. Në rreth 300 aplikime të marra në shqyrtim, u shpallën 82 projekte fituese, nga ku konstatohet se asnjë prej aplikantëve (shoqatë apo individë) me projektet përfaqësuese, nuk trajtojnë çështjet e komunitetit LGBT. Kjo gjë rezulton edhe nga aplikimet e paraqitura pranë MK në dy vitet paraardhëse. Gjithashtu, kriteret e vendosura nga MK për përzgjedhjen e projekteve për mbështetje financiare me fonde publike nuk janë përjashtimore për projektet që trajtojnë komunitete me fokus të tillë.	Përfunduar	Nuk ka
17	18.04.2016	Kërkesë për vënien në dispozicion të	28.04.2016 Kthim përgjigje ku i bashkëlidhet	Përfunduar	Nuk ka

		Vendimit nr.7, datë 08.01.2015 nga MK për shpalljen monument kulture të kullës së Docajve	dokumentacioni që kërkohet		
18	19.09.2016	Kërkesë për vënie në dispozicion të listës/organizatës së stafit që punon në Ministrinë e Kulturës duke përfshirë: Rolin/funksionin e punës, emer, mbiemer, adresën e postës elektronike(e-mail) dhe numrin e telefonit për përdorim zyrtar	5.10.2016 Në rubrikën “Programi i Transparencës”	Perfunduar	Nuk ka
19	03.10.2016	Kërkesë për informacion. Informacion se prej kujt po administrohen elementët e fasadës së ish stadiumit “Qemal Stafa” a ka një sistem mirëmbajtjeje apo konservimi për restaurimin e tyre në vazhdim, para vendosjes në fasadën e ardhshme, siç	13.10.2016 Kthim Përgjigje: Fasada historike ekzistuese kalon në 4 faza të rëndësishme dhe në shumë procese te detajuara. Faza e parë: Rilevimi Gjeometrik i fasadës ekzistuese. Ka përfunduar e plotësuar me analiza dhe raporte të detajuara. Faza e dytë: Çmontimi i elementëve prej guri, numërimi dhe grumbullimi i tyre. Faza	Perfunduar	Nuk ka

		është premtuar. Kërkoj gjithashtu projektin e stadiumit të ri dhe mënyrën si kjo fasade do të përfshihet në të.	e dytë ka përfunduar duke e vendosur materialin e grumbulluar në një vend magazinimi dhe punimi i pajisur me një hapësirë që do të mbulohet për të kryer disa nga fazat e restaurimit. Faza e tretë; Restaurimi. Nuk ka filluar të zbatohet. Faza e katërt: rimontimi dhe zbatimi final. Përfundon me përfudimin e të gjithë objektit. Ndërhyrjet po ndiqen me përpikmëri në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Kërkesa e dytë për venien në dispozicion të projektit të stadiumit të ri : Autoriteti Kontraktor është Qendra Sportive Kuq e Zi dhe mund të drejtoheni këtij institucioni për projektin e plotë të zbatimit. Ministria e Kulturës disponon vetëm projektin: “Ndërhyrja metodologjike për riaftësimin dhe integrimin e fasadës historike ekzistuese të stadiumit Qemal Stafa” për të cilin mund të merrni informacion në	
--	--	--	--	--

			ambjentet e Ministrisë së Kulturës.		
20	14.10.2016	Kërkesë për informacion lidhur me : 1.Sa është numri i konsultimeve publike të realizuar gjatë periudhës 1.12.2015-30.09.2016 mbi draft politikat dhe ligjet? 2.Sa përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile kanë marrë pjesë në konsultimet publike? 3.A ka institucioni juaj zyrtarë përgjegjës për koordinimin, monitorimin dhe raportimin e përfshirjes së OJF-ve në konsultimet publike? 4.A janë të përfshirë të përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në organet këshillimore pranë institucionit?	28.10.2016 1.Sa është numri i konsultimeve publike të realizuar gjatë periudhës 1 dhjetor 2015-30 shtator 2016 mbi draft politikat dhe ligjet? Për periudhën 1 dhjetor 2015-30 shtator 2016, Ministria e Kulturës në nismat e saj për draft politikat dhe projektligjet ka realizuar në mënyrë periodike sipas kërkesave të Ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” , projekt aktet si më poshtë : ✓ Ligji nr.35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” , për të cilin kanë përfunduar të gjitha fazat e miratimit dhe konsultimit të tij. Ky ligj ka hyrë në fuqi në datën 22 tetor 2016 .	Perfunduar	Nuk ka

		5.Nëse po cilat janë organet këshillimore të cilat kanë në grupin e tyre përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile? 6.A janë të përfshirë përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në organet ndërsektoriale? 7.Nëse po, cilat janë këto organe ndër sektoriale të cilat kanë në grupin e tyre përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile?	✓ Projektligji “Për pensionet e disa profesioneve të vështira të artistëve”, për të cilin janë zhvilluar takime konsultime dhe aktualisht është në fazën e diskutimit me Ministrinë e linjës. ✓ Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9616, date 27.09.2006 ‘Për librin në Republikën e Shqipërisë’ i cili është në fazë konsultimi. Aktet nënligjore në zbatim të Ligjit nr.35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” të cilat janë në fazën e konsultimit për mendim në institucionet e linjës ✓ <i>Projektvendim i Këshillit të Ministrave për shumat e shpërblimit nga riprodhimi i veprave për përdorim privat</i>		
--	--	---	--	--	--

			dhe vetjak ose për perdorim tjetër personal; ✓ Projektvendim i Këshillit të Ministrave për procedurat e regjistrimit, organizmit, klasifikimit dhe çertifikimit të veprave të së drejtës së autorit; ✓ Projektvendim i Këshillit të Ministrave për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria e të Drejtave të Autorit; ✓ Projektvendim i Këshillit të Ministrave për përbërjen, mënyrën e funksionimit, shpërblimin dhe organizimin e Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA); ✓ Udhëzim i Ministrit të Kulturës për		
--	--	--	---	--	--

			<i>përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të tjera shpresë në sqarim të kriterëve të parashikuara në nenin 133, si dhe përcaktimin e kushteve dhe procedurës së marrjes së licencës ose ripërtëritjen e saj, në bazë të nenit 134, të ligjit nr.35/2016, datë 31.03.2016</i> <i>“Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.</i> Aktualisht, Ministria e Kulturës është në fazën e hartimit të Ligjit të ri të Trashëgëmisë Kulturore, dhe ka filluar procesin e konsultimit publik edhe për këtë ligj të ri të rëndësishëm. Në kuadër të këtij qëllimi, me datë 26 tetor 2016, Ministria e Kulturës në bashkëpunim me Universitetin Alma Mater Studiorum të Bologna-s, Fondacionin Flaminia Ravenna,		
--	--	--	--	--	--

			Fakultetin e Drejtësisë Universiteti i Tiranës, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Shkollën Shqiptare të Administratës Publike dhe Institutin Italian të Kulturës, organizuan në ambientet e Fakultetit të Drejtësisë së Universitetit të Tiranës, Konferencën ndërkombëtare akademike <i>“Kontribute në përpunimin e projektligjit të ri të Trashëgimisë Kulturore në Shqipëri”</i>. Kjo konferencë vjen si një event pararendes i fazës së konsultimeve të projektligjit të ri të <i>"Trashëgimisë Kulturore & Muzeve"</i> që do të ndërmerret nga Ministria e Kulturës në javët në vijim. 2.Sa përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile kanë marrë pjesë në konsultimet publike? Lidhur me pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile në konsultimet publike, Ministria e Kulturës ka qenë e hapur për konsultim me		
--	--	--	---	--	--

			të gjithë grupet e ineteresit të cilët janë impaktuar nga nisma, por dhe më gjerë, dhe i ka bërë pjesë të konsultimeve, duke ndjekur procedurat lidhur me format njoftimit sipas ligjit: me postë elektronike, me publikim ne faqen zyrtare të institucionit, apo takime të drejtpërdrejta me grupet e interesuara. Të gjithë rekomandimet e tyre lidhur me draftin janë pasqyruar në formë tabelare për të gjitha palët duke evidentuar edhe duke bërë transparente të gjitha propozimet e tyre. Në vijim, lidhur me të gjithë praktikën e ndjekur është raportuar tek Ministri për Marrëdhëniet me Parlamentin si dhe në Kuvend gjatë shqyrtimit dhe diskutimit të fazes parlamentare. 3.A ka institucioni juaj zyrtarë përgjegjës për koordinimin, monitorimin dhe raportimin e përfshirjes së OJF-e në konsultimet publike?		
--	--	--	---	--	--

			Ministria e Kulturës ka caktuar personin përgjegjës, i cili është i ngarkuar me koordinimin të gjitha propozimeve që vijnë në adresë të nismës apo draftligjit të propozuar. 4.Nëse po, cilat janë organet këshillimore të cilat kanë në grupin e tyre përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile? Në të gjitha p/aktet, për të cilat ka qenë nevojë ose domosdoshmëri të parashikohet ngritja e organit këshillimor është marrë parasysh përfshirja e përfaqësuesve të organizatave me qëllim realizimin e një politike gjithpërfshirëse, të qëndrueshme ku të harmonizohen sa më shumë interesa dhe organi këshillimor i ngritur të luajë funksionin e tij më të plotë. Edhe për to paraprakisht p/akti, është konsultuar me grupet e interesit, duke pasur dhe në konsideratë shkallën e (përfaqësimit)		
--	--	--	--	--	--

			anëtarësimit nga ana e tyre. 5. Nëse po, cilat janë organet këshillimore të cilat kanë në grupin e tyre përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile? 1 Organ Këshillimor në kuptim të dispozitave amenduese të Ligjit për Librin në të cilin do të ketë përfaqësi nga insitucionet e pavaruara si dhe ekspertë të fushës. 6/7. A janë të përfshirë përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në organet ndërsektoriale?/Nëse po, cilat janë këto organe ndërsektoriale të cilat kanë në grupin e tyre përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile? Po, do të ketë përfaqësi, për aq sa është e nevojshme dhe në organet ndërsektoriale (projekt akt i hartuar si një detyrim ligjor që e autorizon Ligji 35/2016 “Për të drejtën e		
--	--	--	---	--	--

			autorit”), siç është rasti i Krijimit të Këshillit Kombëtar të së Drejtës së Autorit në përberjen e të cilit lihet hapësira për pjesmarrjen e ekspertëve të jashtëm apo drejtues të Agjensive në mbrojtjen e të drejtës së Autorit.		
21	28.10.2016	Po i drejtohem institucionit tuaj të na vini në dispozicion të dhënat e përcaktuara më poshtë për territorin e administruar nga Bashkia Mat. Lista e informacioneve të nevojshme : Lista e monumenteve të kulturës që ndodhen brenda territorit administrative të Bashkisë Mat për secilën nga kategoritë e mëposhtme: Objekte kulti Vepra inxhinierike	31.10.2016 Kthyer përgjigje nga Instituti i Monumenteve të Kulturës Është dërguar lista e monumenteve të kulturës për Bashkinë Mat sipas njësive administrative përkatëse. Për informacion më të plotë për vendodhjen e saktë të çdo monumenti në Republikën e Shqipërisë duke treguar pozicionin e tij, gjurmën që zë monumenti në terren, zonën e mbrojtur, ju lutem vizitoni faqen zyrtare http://ëëë.imk.gov.al Rubrika: ËëbGIS IMK. Harta ËëbGIS database ofron informimin e publikut dhe gjithë institucioneve të tjera lidhur me kombinimin e informacionit të	Perfunduar	Nuk ka

		Ndërtime të arkitekturës vernakulare Kala Vendbanime Vepra arti Vendvarrime Zonifikime Ndertesë e projektuar Për secilën nga monumentet e mësipërme, ju lutem të sqaroni statusin e mbrojtjes që ato gëzojnë, masat që janë marrë të paktën 10 vitet e fundit për mbrojtjen e tyre dhe dokumente ligjore / plane menaxhimi që duhet të mërren parasysh gjatë procesit të planifikimit të territorit. Një listë të lejeve ndërtimore madhore që janë dhënë nga KKR të paktën gjatë 10 viteve të fundit, brenda territorit të bashkisë Mat. Nëse ka ndonjë raport specifik që duhet të marrim	monumenteve me të gjitha informacionet e tjera si rjeti rrugor, projektet arkeologjike, pasuritë e paluajtshme(nga ASIG), ortofotot, imazhe satelitore, harta topografike, zonat e mbrojtura natyrore, etj.		
--	--	--	--	--	--

		në konsideratë gjatë hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor për Territorin e Bashkisë Mat.			
22	28.10.2016	Kërkesë për informacion lidhur me zbatimin e ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”	03.11.2016 1.Në nenin 6, të ligjit 146/2014 “ <i>Për njoftimin dhe konsultimin publik</i> ”, parashikohet detyrimi që kanë organet publike të marrin të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të krijojnë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në proçesin e njoftimit e të konsultimit publik. Në gërmën “b” specifikisht përcaktohet detyrimi për publikim të programit të transparencës, si dhe të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me proçesin e vendimmarrjes sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Në kuadër të këtyre detyrimeve ligjore të sipërpërmendur a, Ministria e Kulturës ka	Perfunduar	Nuk ka

			hartuar programin e transparencës, i cili është publikuar dhe në faqen zyrtare të instucionit, ëëë.kultura.gov.al (Programi transparencës), duke u bërë i aksesueshëm nga dhe për këdo që është interesuar si dhe duke rritur transparencën mbi vendimarrjet institucionale. Ky program përditësohet nga autoriteti publik në mënyrë të vazhdueshme. Ministria e Kulturës është në fazën e rishikimit të Programit të Transparencës. 2. Për periudhën janar – tetor 2016, Ministria e Kultures në nismat e saj për draft politikat dhe projektligjet, ka realizuar konsultime në mënyrë periodike sipas kërkesave të Ligjit		
--	--	--	--	--	--

			nr.146/2014 “Per njoftimin dhe konsultimin publik” , për projektaktet si më poshtë : ✓ Projektligji “Per pensionet e disa profesioneve të vështira të artistëve”, për të cilin janë zhvilluar takime konsultime dhe aktualisht është në fazën e diskutimit me Ministritë e linjës. ✓ Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9616, date 27.09.2006 ‘Për librin në Republikën e Shqipërisë’ i cili është në fazë konsultimi. Aktet nënligjore në zbatim të Ligjit nr.35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” të cilat janë në fazën e konsultimit për mendim në institucionet e linjës: ✓ <i>Projektvendim i Këshillit të Ministrave për</i>		
--	--	--	---	--	--

			shumat e shpërblimit nga riprodhimi i veprave për përdorim privat dhe vetjak ose për përdorim tjetër personal; ✓ Projektvendim i Këshillit të Ministrave për procedurat e regjistrimit, organizimit, klasifikimit dhe çertifikimit të veprave të së drejtës së autorit; ✓ Projektvendim i Këshillit të Ministrave për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria e të Drejtave të Autorit; ✓ Projektvendim i Këshillit të Ministrave për përbërjen, mënyrën e funksionimit, shpërblimin dhe organizimin e Këshillit Kombëtar për të Drejtën e		
--	--	--	---	--	--

			<i>Autorit (KKDA);</i> ✓ <i>Udhëzim i Ministrit të Kulturës për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të tjera shitesë në sqarim të kriterëve të parashikuara në nenin 133, si dhe përcaktimin e kushteve dhe procedurës së marrjes së licencës ose ripërtëritjen e saj, në bazë të nenit 134, të ligjit nr.35/2016, datë 31.03.2016</i> <i>“Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.</i> Njekohësisht, Ministria e Kulturës është në fazën e hartimit të Ligjit të ri të Trashëgëmisë Kulturore, dhe ka filluar procesin e konsultimit publik edhe për këtë ligj të ri të rëndësishëm. Në kuadër të këtij qëllimi, me datë 26 tetor 2016, Ministria e Kulturës në		
--	--	--	--	--	--

			bashkëpunim me Universitetin Alma Mater Studiorum të Bologna-s, Fondazione Flaminia Ravenna, Fakultetin e Drejtësisë Universiteti i Tiranës, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Shkollën Shqiptare të Administratës Publike dhe Institutin Italian të Kulturës, organizuan në ambientet e Fakultetit të Drejtësisë së Universitetit të Tiranës, Konferencën ndërkombëtare akademike <i>“Kontribute në përpunimin e projektligjit të ri të Trashëgimisë Kulturore në Shqipëri”</i>. Kjo konferencë vjen si një event pararendes i fazës së konsultimeve të projektligjit të ri të <i>"Trashëgimisë Kulturore & Muzeve"</i> që do të ndërmerret nga Ministria e Kulturës në javët në vijim. Lidhur me këto projekte, Ministria e Kulturës ka qenë e hapur për konsultim me të gjithë grupet e ineteresit të cilët janë impaktuar nga nisma,		
--	--	--	--	--	--

			por dhe më gjerë, dhe i ka bërë pjesë të konsultimeve, duke ndjekur procedurat lidhur me format e njoftimit sipas ligjit: me postë elektronike, me publikim në faqen zyrtare të institucionit, apo takime të drejtpërdrejta me grupet e interesuara. Të gjithë rekomandimet e tyre lidhur me draftin janë pasqyruar në formë tabelare për të gjitha palët duke evidentuar edhe duke bërë transparente të gjitha propozimet e tyre. Në vijim, lidhur me të gjithë praktikën e ndjekur, sipas fazës së konsultimit, është raportuar tek Ministri për Marrëdhëniet me Parlamentin.		
23	3.11.2016	Kërkesë për informacion lidhur me zbatimin e së drejtës së informimit nga institucionet publike, konkretisht të programeve të transparencës , kërkesa për	30.11.2016 Informacionet gjenden në Programin e Transparencës	Perfunduar	Nuk ka

		informacion në lidhje me dokumentat dhe informacionin që duhet të bëhet publik pa kërkesë			
24	7.11.2016	Kërkesë për informacion Ministria e Kulturës, me cilësinë e Autoritetit Kontraktues shpalli njoftimin për zhvillimin e një tenderi me fonde buxhetore për rikonstruksionin e Teatrit të Operas. Kompania fituese u shapll një Bashkim operatorësh Agikons dhe Edil ALIT. A kanë zbatuar këto kompani edhe në të shkuarën punë të ngjashme publike, objektet e të cilave kanë qenë monumente arkitekturore të kësaj kategorie , nëse po, cilat konkretisht? A ka pasur një vlerësim		Në proces	

		paraparak, një vëzhgim mbi kushtete e sallës nga autoriteti në formë të shkruar, mbi nevojat konkrete të saj për rikonstruktion?			
25	11.11.2016	Kërkesë për informacion lidhur me tenderin e Teatrit të Operas dhe Baletit 1.A ka patur një vetëdeklarim paraparak rast për rast të ekzistencës së interesave private nga Ministri i Kulturës gjatë periudhës, përpara se znj.Mirela Kumbaro, si autoritet kontraktues, të përfshihej në një vendimarrje të tillë? 2.A keni miratuar Rregullore të Brendshme për parandalimin e konfliktit të interesave dhe a	21.11.2016 Në datën 8.1.2016, Ministri i Kulturës, bazuar në nenin 27 të Kodit të Procedurave Administrative si dhe nenin 56 Kreu VII të VKM-së nr.918, datë 29.12.2014 “Për kryerjen e prokurimit në mënyrë elektronike”, e ka autorizuar znj.Elira Kokona, Sekretar i Përgjithshëm pranë Ministrisë së Kulturës, në cilësinë e titullarit të nënshkruajë kontratat që Ministria e Kulturës lidh me operatorët ekonomik fitues gjatë vitit kalendarik 2016. <i>Si rrjedhojë, znj.Elira Kokona është përfaqësues i Autoritetit Kontraktor me autorizimin nr.69 prot, datë 8.1.2016 bashkëlidhur kësaj shkrese. Bazuar në Ligjin nr.9643, datë</i>	Përfunduar	Nuk ka

		mund të kem një kopje të saj? 3. A keni nënshkruar një kontratë pune (për tenderin në fjalë) me kompanitë fituese dhe a mund të kem një kopje të saj?	20.11.2006, i ndryshuar “Për prokurimin” dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit”, neni 64 “Hapja e ofertave” citohet se: “Në momentin e hapjes së ofertave, zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit të ofertave nënshkruajnë një deklaratë përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës”. Në rastin konkret, znj.Kumbaro, Ministër i Kulturës, nuk ka qenë pjesë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave”. Ministria e Kulturës gjatë procedurave të prokurimit, i referohet nenit 64 “Hapja e ofertave” të VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Lidhur me këtë tender, Autoriteti Kontraktor që është Ministria e Kulturës e autorizuar		
--	--	---	--	--	--

			dhe përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm, znj.Elira Kokona, ka lidhur kontratë me Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë “Agikons shpk” dhe “Edil-Al it”, kontrata me nr.5349, datë 31.10.2016. Pjesë e kësaj kontrate është edhe Akt Marrëveshja e bashkëpunimit të përkohshëm me nr.4239Rep. dhe nr.1010 Kol. Datë 27.09.2016, palët bien dakort që shoqëria “AgiKons shpk” do të jetë shoqëria që do të veprojë me autoritetin e përfaqësuesit të këtij Joint venture gjatë procedurës së tenderit si dhe gjatë zbatimit të kontratës.		
26	9.12.2016	Kërkesë për informacion lidhur me : 1.Sa është shuma e fondeve publik që MK gjatë periudhës 1.12.2015-30.09.2016 për organizatat civile? Sa është numri i ogranizatave civile që kanë	8.02.2017 1.Sa është shuma e fondeve publike që institucioni juaj gjatë periudhës 1 dhjetor 2015-30 shtator 2016 për organizatat e shoqërisë civile? Shuma e fondeve publike për subjektet e shoqërisë civile (individ dhe organizata) për vitin 2015, është 23 milion	Përfunduar	Nuk ka

		aplikuar për këto fonde? Sa është numri i organizatave të shoqërisë civile që kanë përfituar nga këto fonde? Sa është shuma maksimale dhe minimale e përfituar? Sa është numri i shërbimeve të prokuruar nga organizatat e shoqërisë civile gjatë periudhës 1.12.2015-30.09.2016? Sa është shuma totale e kontratave për shërbimet e prokuruar nga organizatat e shoqërisë civile? Sa organizata të shoqërisë civile kanë përfituar mbështetje jo financiare gjatë periudhës 1.12.2015-30.09.2016? Cili ka qenë lloji i mbështetjes jo financiare të ofruar?	lekë dhe për vitin 2016 është 54.7 milion lekë. 2.Sa është numri i organizatave të shoqërisë civile që kanë aplikuar për këto fonde? Për vitin 2015 janë aplikuar <u>132</u> (projekte me aplikim të hapur) organizata të shoqërisë civile (96 organizata në fushën e artit; 22 organizata për fushën e librit; 14 organizata në fushën e trashëgimisë) Për vitin 2016 kanë aplikuar <u>143</u> organizata të shoqërisë civile (<u>projekte me aplikim të hapur</u>) (91 organizata kanë aplikuar në fushën e art-kulturës; 19 organizata kanë aplikuar për fushën e librit dhe 33 në fushën e trashëgimisë). 3.Sa është numri i organizatave të shoqërisë civile që kanë përfituar nga këto fonde? Për vitin 2015, numri i subjekteve të shoqërisë civile të cilat janë mbështetur nga Ministria e Kulturës me fonde është <u>48</u> (nga të cilat 38 organizata	
--	--	--	--	--

			aplikuese të projekteve me thirrje në fushën e artit dhe 10 në fushën e librit) nga <u>158 subjekte të mbështetura për këtë vit.</u> Për vitin 2016, numri i subjekteve të shoqërisë civile të cilat janë mbështetur nga Ministria e Kulturës me fonde është <u>71</u> (nga të cilat 55 organizata aplikuese të projekteve me thirrje të fushës së kulturës dhe 11 në fushën e librit dhe 5 në fushën e trashëgimisë) nga <u>187 subjekte të mbështetura për këtë vit.</u> 4.Sa është shuma maksimale dhe minimale e fondit të përfituar nga një organizatë? Shuma minimale e përfituar nga një organizatë për vitin 2015 është 200.000 lekë, ndërsa shuma maksimale është 2.119.000 lekë. Për vitin 2016, shuma minimale e përfituar është 195.300 lekë, ndërsa shuma maksimale është 1.500.000 lekë.		
--	--	--	--	--	--

			7.Sa organizata të shoqërisë civile kanë përfituar mbështetje jo-financiare gjatë periudhës 1 dhjetor 2015-30 shtator 2016? Numri i organizatave të shoqërisë civile të cilat kanë përfituar mbështetje jo financiare për vitin 2015 janë rreth 40 organizata të shoqërisë civile. Për vitin 2016 janë mbështetur rreth 50 organizata të shoqërisë civile. 8.Cili ka qenë lloji i mbështetjes jo-financiare të ofruar? Lloji i mbështetjes jo-financiare të ofruar janë: ambjentet e Ministrisë së Kulturës, sallat e Institucioneve të varësisë, staf dhe burime njerëzore si dhe promovim dhe komunikim mediatik dhe në faqet zyrtare të Ministrisë së Kulturës.		
27	13.12.2016	Lidhur me prokurimin e	Përsa i përket përgjigjes së kërkesës suaj “Për	Përfunduar	Nuk ka

		fondeve për rikonstrukcionin dhe ndryshimin e destinacionit të ish Laboratorit të Hidroteknikës, në qendër arti “Skena e Re”, të organizuar nga Ministria e Kulturës, kërkoj sim ë poshtë vijon: 1.Dokumentacionin e plotë të siguruar nga ana e autoritetit për çeljen dhe zhvillimin e procedurës së hapur për rehabilitimin e ish-Laboratorit në fjalë, ku të përfshihen të dhënat në formë dokumentash, vërtetimesh apo cfarëdolloj forme tjetër, si pjesë e dokumentacionit të ofertave të sjella prej çdo kompanie pjesëmarrëse në garë, të nevojshme për plotësimin e kriterëve të	<i>dokumentacionin e plotë të siguruar nga ana e autoritetit për çeljen dhe zhvillimin e procedurës së hapur për rehabilitimin e TKOB-it, ku të përfshihen të dhënat në formë dokumentash, vërtetimesh apo cfarëdolloj forme tjetër si pjesë e dokumentacionit të sjella prej çdo kompanie pjesëmarrëse në garë të nevojshme për plotësimin e kriterëve të përcaktuara prej autoritetit”</i> ju bëjmë me dije se : Dokumentacioni që ju kërkon, për çdo kompani pjesëmarrëse, nuk përbën informacion referuar edhe në ligjin Nr.119/2014” <i>Për të drejtën e informimit”</i> Kreu II, neni 3/3 : <i>Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin përkatës, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.</i>		
--	--	---	--	--	--

	përcaktuara prej autoritetit. 2.Dokumentacionin, ku tregohen kriteret e vendosura prej autoritetit për tu plotësuar prej kompanive. 3.Kontrata e nënshkruar me kompaninë fituese 4.Raportet e monitorimit të punimeve në terren(të deritanishme). Kërkesa e mësipërme mbështet të drejtën e publikut për tu informuar mbi punën e qeverisë, siguron informacion mbi procedurat e prokurimit publik dhe ushqen besimin publik. Çdo kufizim i mundshëm nga ana juaj, në lidhje me të dhënat personale apo sekretet tregtare të mos çënojë vlerësimin mbi një gjykim	Gjithashtu, Ministria e Kulturës në cilësinë e Autoritetit kontraktor bazuar në nenin 8, të ligjit Nr.44/2015 Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: <i>“Pjesëmarrësit në një procedurë prokurimi kanë të drejtë të kërkojnë që të dhënat e tyre personale dhe konfidenciale të trajtohen në për-puthje me legjislacionin në fuqi”</i> si dhe nenit 9 i tij i cili parashikon se : <i>“Organi ka detyrimin që gjatë përpunimit të ligjshëm e të drejtë të të dhënave personale, të të dhënave që lidhen me veprimtarinë tregtare ose profesionale, me të cilat njihet gjatë procedurave administrative dhe që mbrohen sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, të ndërmarrë masa lidhur me</i>		
--	--	---	--	--

		objektiv të zhvillimit të prokurimit, mirëpërdorimit të fondeve publike, nxitjes së konkurrencës dhe sigurimit të një trajtimi të barabartë, jodiskriminues ndaj operatorëve pjesëmarrës.	<i>mbrojtjen, ruajtjen, mospërhapjen, si dhe konfidencialitetin e tyre</i>”, kemi detyrimin e mbrojtjes së të dhënave të subjekteve pjesëmarrëse. Përsa i përket pikës 2 të kërkesës suaj “<i>Dokumentacionin ku tregohen kriteret e vendosura prej autoritetit kontraktor për tu plotësuar prej kompanive</i>” si dhe pika 3 “<i>Kontrata e nënshkruar me kompanin fituese</i>”, bashkëlidhur kësaj shkrese do të gjeni : 1. Dokumentet Standarte të Tenderit në të cilin janë përcaktuar kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor si dhe 2. Kontratën e lidhur me operatorin ekonomikë fitues për procedurën e sipërcituar.	
--	--	--	---	--

			Gjithashtu, ju bëjmë me dije se Ministria e Kulturës është në proces të zbatimit të projekteve të sipërcituara, si rrjedhojë raportet e monitorimit do të vihen në dispozicion pas përfundimit të punimeve në terren.		
28	13.12.2016	Lidhur me prokurimin e fondeve për rehabilitimin e Teatrit Kombëtar të Operas dhe Ansamblit Popullor, të organizuar nga Ministria e Kulturës, kërkoj informacion si më poshtë vijon: 1.Dokumentacionin e plotë të siguruar nga ana e autoritetit për çeljen dhe zhvillimin e procedurës së hapur për rehabilitimin e TKOB-it, ku të përfshihen të dhënat në formë dokumentash, vërtetimesh apo cfarëdolloj forme	16.01.2017 Përsa i përket pikës 1 të kërkesës tuaj “Për dokumentacionin e plotë të siguruar nga ana e autoritetit për çeljen dhe zhvillimin e procedurës së hapur për rehabilitimin e TKOB-it, ku të përfshihen të dhënat në formë dokumentash, vërtetimesh apo cfarëdolloj forme tjetër si pjesë e dokumentacionit të sjella prej çdo kompanie pjesëmarrëse në garë të nevojshme për plotësimin e kriterëve të përcaktuara prej autoritetit” ju bëjmë me dije se : Dokumentacioni që ju kërkon, për çdo kompani pjesëmarrëse, nuk përbën informacion	Përfunduar	Nuk ka

	tjetër, si pjesë e dokumentacionit të ofertave të sjella prej cdo kompanie pjesëmarrëse në garë, të nevojshme për plotësimin e kriterëve të përcaktuara prej autoritetit. 2.Dokumentacionin, ku tregohen kriteret e vendosura prej autoritetit për tu plotësuar prej kompanive. 3.Kontrata e nënshkruar me kompaninë fituese 4.Raportet e monitorimit të punimeve në terren(të deritanishme). Kërkesa e mësipërme mbështet të drejtën e publikut për tu informuar mbi punën e qeverisë, siguron informacion mbi procedurat e prokurimit public dhe ushqen besimin publik.	38isten referuar edhe në ligjin Nr.119/2014” <i>Për të drejtën e informimit</i>” Kreu II, neni 3/3 : <i>Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin, nëpërmjet dokumentit ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.</i> Gjithashtu, Ministria e Kulturës në cilësinë e Autoritetit kontraktor bazuar në nenin 8, të ligjit Nr.44/2015 Kodit të Proçedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: <i>“Pjesëmarrësit në një proçedurë prokurimi kanë të drejtë të kërkojnë që të dhënat e tyre personale dhe konfidenciale të trajtohen në për-puthje me legjislacionin në fuqi”</i>		
--	--	--	--	--

		Cdo kufizim i mundshëm nga ana juaj, në lidhje me të dhënat personale apo sekretet tregtare të mos çënojnë vlerësimin mbi një gjykim objektiv të zhvillimit të prokurimit, mirëpërdorimit të fondeve publike, nxitjes së konkurrencës dhe sigurimit të një trajtimi të barabartë, jodiskriminues ndaj operatorëve pjesëmarrës.	si dhe nenit 9, i tij i cili parashikon se : <i>“Organi publik ka detyrimin që gjatë përpunimit të ligjshëm e të drejtë të të dhënave personale, të të dhënave që lidhen me veprimtarinë tregtare ose profesionale, me të cilat njihet gjatë procedurave administrative dhe që mbrohen sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, të ndërmarrë masa lidhur me mbrojtjen, ruajtjen, mospërhapjen, si dhe konfidencialitetin e tyre”, kemi detyrimin e mbrojtjes së të dhënave të subjekteve pjesëmarrëse.</i> Përsa i përket pikës 2 të kërkesës suaj <i>“Dokumentacionin ku tregohen kriteret e vendosura prej autoritetit kontraktor për tu plotësuar prej kompanive”</i> si dhe pikës 3 <i>“Kontrata e nënshkruar me kompanin fituese”</i>, bashkëlidhur kësaj shkrese do të gjeni :		
--	--	---	--	--	--

			1. Dokumentet Standarte të Tenderit në të cilin janë përcaktuar kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor si dhe 2. Kontratën e lidhur me operatorin ekonomikë fitues për procedurën e sipërcituar. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se Ministria e Kulturës është në proces të zbatimit të projekteve të sipërcituara, si rrjedhojë raportet e monitorimit do të vihen në dispozicion pas përfundimit të punimeve në terren.		
29	19.12.2016	Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) me Vendimin Nr.86, Datë 30/06/2016 “Për evadimin e materialeve të auditimit të brëndshëm ,	05.01.2017 Në zbatim të Ligjit nr.152/2013 “Për nënpunësin civil”: -Proçesi për zgjedhës bazohet në vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve nëpërmjet një konkurimi publik,	Përfunduar	Nuk ka

	“rehabilitimi i ish-të përndjekurve politikë në periudhën e tranzicionit” ka bere nje sere konstatimesh dhe rekomandimesh, per kete shtrese te marginalizuar të shoqërisë shqiptare. Ne kete raport, nder te tjera thuhet: “Masat për dëshmshpërblimin material përbëjnë veprimet të cilat shpesh ngatërrohen brenda njëri-tjetrit. Rehabilitimi i referohet procesit të rikthimit të një personi në pozitën (personale, profesionale, etj.) që ka patur përpara fillimit të regjimit represiv. Dëshmshpërblimi i referohet masave që ofrojnë kompensime të cilat zakonisht	që përfshin një testim të shkruar, një testim me gojë dhe çdo formë tjetër të përshtatshme të verifikimit të aftësive, vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatit. Pranimi në shërbimin civil bazohet në parimet e shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit dhe kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës transparent e të drejtë”. Gjithashtu sqarojmë që njësia përgjegjëse për rekrutimet në administratën publike është Departamenti i Administrës Publike”. Për sa i përket numrit të punonjësve në Ministrinë e Kulturës, të cilët kanë statusin e ish të përndjekurit politik si dhe numrit të punonjësve që janë trashëgimtarë ligjorë të ish të përndjekurve politikë, Ju bëjmë me dije se në zbatim të Vendimit nr.117, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve” « të personelit		
--	---	--	--	--

		marrin formën e paketave të përfitimeve, zhdëmtimeve dhe pagesave të veçanta. Kthimi i referohet dorëzimit të pasurisë së konfiskuar ose të vjedhur pronarëve të saj të ligjshëm apo të pasardhësve të tyre”. Ligji Per Statusin e Ish – te Perndjekurve Politike nga Sistemi Komunist parashikon: http://ishperndjekurit.gov.al/al/ep-content/uploads/2015/03/Ligj-stat.-e-te-perndjekurve-politike-7748-DT-04.08.1993.pdf Neni 3 Në bazë të ligjit “Për pafajësinë dhe amnistinë e ish-te dënuarve dhe të perndjekurve politikë” nr.7516,	e të rregjistrit qendror të personelit”, nuk parashikohet që dosja personale të përmbajë dokumentacion që tregon status të vecantë të nëpunësve civilë.		
--	--	--	--	--	--

		ndryshuar me ligjin nr.7660, datë 14.1.1993 dhe me ligjin nr.7719, datë 8.6.1993, të përndjekurit politikë sipas këtij statusi ndahen në pesë kategori: “a) Persona që kanë humbur jetën ose janë të sëmurë psikik për shkak të përndjekjes. b) Persona që janë dënuar me heqje lirie ose kanë qëndruar në arrati brenda vendit për shkak të përndjekjes. c) Persona që janë dënuar me internim, dëbim për shkak të përndjekjes; persona shqiptarë që kanë pasur shtetësi të huaj, sot shtetas shqiptar, e që kanë jetuar në kampe përqendrimi të ngritura posaçërisht për ta.			
--	--	---	--	--	--

		d) Persona që kanë humbur të drejtat qytetare, kulakët e fshatit, të deklasuarit dhe ata që kanë pësuar privime të llojeve të ndryshme për shkak të përndjekjes. e) Persona, të cilët megjithëse plotësojnë kushtet për t'u kategorizuar në një nga kategoritë e mësipërme, nuk përfitojnë të drejtën e këtij statusi” Me ane te kesaj kerkese, kerkoj te pajisem me informacionin e meposhtem: 23) Sa eshte numri i punonjes ve në Institucionin Tuaj, të cilet kane statusin e ish të perndjekurve			
--	--	--	--	--	--

		politikë, sipas kategorive të mesiperme: a), b), c), d) dhe e) ? Nese ka, cilat role mbulojnë ata? 2) Sa eshte numri i punonjesve në Institucionin Tuaj, të cilet jane trashegimtare ligjore të ish të perndjekurve politikë, sipas kategorive të mesiperme: a), b), c), d) dhe e) ? Nese ka, cilat role mbulojnë ata? 3) Nese nuk ka, cila eshte arsyeja e mosperfshirjes se kesaj shtrese te marginalizuar, në organiken e stafit te Institucionit Tuaj? 4) Raporti i KLSH-se ka parashikuar disa rekomandime per trajtimin e kesaj çeshtjeje. Cilat jane masat që Institucioni Juaj ka ndermarre në			
--	--	--	--	--	--

		reflektim dhe zbatim te rekomanimeve te KLSH-se? Kerkoj nje kopje te plan veprimit te Institucionit Tuaj per gjithperfshirjen dhe rehabilitimin e kesaj shtrese te marginalizuar të shoqerise shqiptare. Nese nuk, ka cila eshte arsyeja? Në zbatim të Nenit 14 te Ligjit Per te Drejten e Informimit pika 2 b) “një kopje të plotë të informacionit nëpërmjet postës elektronike”, kerkoj qe informacioni të më dergohet me email në adresen e sipercituar. Në zbatim të Nenit 15 te Ligjit Per te Drejten e Informimit kerkoj që i gjithë 46isten46t46on ii kerkuar në piken 1, të			
--	--	--	--	--	--

		me dergohet sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se brenda 10 ditë pune.			
30.	04.01.2017	Kërkesë për informacion ku të paraqitet lista e plotë e objekteve apo e materialeve të cilësuar si monumente të Trashëgimisë Kulturore dhe të shpallura sit ë tilla gjatë vitit 2016, në kompetence dhe me iniciativë të autoritetit si Ministri	13.01.2017 Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, me nr. 1 prot, hyrës në Ministrinë e Kulturës, datë 04.01.2017, me anë të së cilës kërkoni listen e Monumenteve të Trashëgimisë Kulturore të shpallura gjatë vitit 2016, bashkëlidhur është dërguar lista e kërkuar.	Përfunduar	Nuk ka
31.	09.01.2017	a)Kërkesë për nje kopje të diplomës së shkollës së lartë të Drejtorit në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore b) Kërkesë për procedurën se si është emëruar si drejtor në Qendrën Kulturore të Inventarizimit të	18.01.2017 Kthyer përgjigje me dokumentacionin e kërkuar	Përfunduar	Nuk ka

		Pasurive Kulturore			
32.	15.01.2017	Shpjegim nga Ministria e Kulturës në lidhje me motivimin e përdorur për ti rekomanduar President të Republikës dhënien e shtetësisë për merita të veçanta për shtetasit e përmendur në kërkesë	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion të regjistruar me nr. 179.prot hyrës në Ministrinë e Kulturës, datë 17.01.2017 dhe e regjistruar me nr. Rendor nr. 32 në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, lidhur me motivimin e përdorur për t'i rekomanduar Presidentit të Republikës dhënien e shtetësisë për merita të veçanta të shtetasve të përmendur në shkresë, ju bëjmë me dije se objekti i kërkesës suaj për informacion nuk është trajtuar nga ana e Ministrisë së Kulturës.	Përfunduar	Nuk ka
33	06.03.2017	Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit. Kopje e procesverbalit të mbajtur gjatë mbledhjes të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve, të zhvilluar në datë 13.09.2016, në	05.04.2017 Kthyer përgjigje nga Instituti i Monumenteve të Kulturës: I kërkohet të specifikohet çështja apo projekti për të cilin interesohet, në mënyrë që informacioni të jetë i saktë për arsye se sipas rendit të ditës për mbledhjen në fjalë janë shqyrtuar një sërë çështjesh	Përfunduar	Nuk ka

		audio dhe/ose hardcopy			
34	23.03.2017	Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit : Kopje e procesverbaleve të mbajtura gjatë mbledhjeve të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve, në audio dhe/ose hardcopy, të zhvilluara në datë 20.01.2016, datë 10.05.2016, datë 14.09.2016	7.4.2017 I janë dërguar kopje të procesverbaleve të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve datë 20.01.2016 dhe 14.09.2016. Për sa i përket mbledhjes së datës 10.05.2016, i është kërkuar të përcaktohet çështja për të cilën interesohen	Përfunduar	Nuk ka
35	3.4.2017	Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit : Një kopje të listës së 18 veprave në pikturë dhe vizatim, pjesë e Fondit të Galerisë Kombëtare të Arteve, që do të dërgohen jashtë Shqipërisë, me qëllim realizimin e ekspozitave	5.4.2017 -Vendimi nr.271, datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave “Për lëvizjen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të 18 veprave të artit në pikturë dhe vizatim, pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Arteve, me qëllim realizimin e ekspozitave “Documenta 14”, që do të zhvillohen në ambientet e Muzeut Kombëtar të Artit Bashkëkohor Athinë,	Përfunduar	Nuk ka

		“Documenta 14” të miratuar me vendim nga Këshilli i Ministrave më datë 29.03.2017.(http://ëëë.kryeministria.al/al/neësroom/vkm/vendime-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-29-mars-2017&page=1)	<i>Greqi dhe në Muzeun e Arteve të Bukura, Neue Galerie, Kassel, Gjermani”</i>, -Lista e veprave të ekspozitës “<i>Dokumenta 14</i>” në Athinë, -Lista e veprave të ekspozitës “<i>Dokumenta 14</i>” në Kasse		
36	10.04.2017	Në faqen zyrtare në facebook të Bashkisë Patos, në postimin e datës 03 Prill 2017 https://ëë.facebook.com/pg/bashkiapatos/photos/?tab=album&album_id=10158386135435655 citohet “Pranë lapidarit në Margëlliç është zhvilluar përkujtimi i 73 vjetorit të Betejës së Margëlliçit, si ngjarja më e rëndësishme historike e qytetit.	21.04.2017 Objekti të cilit i referohet kërkesa administrohet nga organet e qeverisjes vendore. Çështja që trajtohet nuk është në kompetencë të Ministrisë së Kulturës	Përfunduar	Nuk ka

		Kryebashkiakja Balilaj shprehu vlerësimin maksimal për figurat që kontribuan në Luftën për Çlirimin e Vendlës dhe vlerësoi rëndësinë që ka përkujtim i këtyre ngjarjeve, si simbol dhe si vlerë që krenon çdo brez. Deputete e zonës znj. Antoneta Dhima, Sekretari i Përgjithshëm i Komitetit Kombëtar të Veteranëve të LANC z. Odise Porodini dhe Kryetari i Veteranëve të qytetit z. Harun Nazëraj, mbajtën fjalën e rastit duke shprehur vlerësime dhe nderime për figurën e dëshmorëve dhe kësaj ngjarje me jehonë kombëtare. #NgjarjeHistorike”			
--	--	---	--	--	--

		Në lapidarin / perkujtimoren e mesiperme, nder të tjera, citohet: “Forcat e brigades se VI sulmuese zhvilluan luftime te ashpra kundër nazisteve Gjermane dhe tradhetareve te vendit” Në lidhje me këtë permendore kërkoj te informohem sa vijon: 1. Cili autoritet shtetëror e ka vlerësuar dhe miratuar mbishkrimin e vendosur në pllaken perkujtimore të ketij lapidari / monamenti? 1. Në lidhje me fjalën “tradhetareve te vendit”: Cilet jane tradhetaret e vendit? Kërkoj nje kopje te emrave, mbiemrave, vendlindjet dhe vendbanimet, e te			
--	--	--	--	--	--

		gjithe atyre qe iu referohet kjo pjese e mbishkrimit? 2. Mbi cilen baze ligjore dhe cili autoritet kompentent / gjykate e pavarur i ka shpallur, keta persona “tradhtare të vendit”? Kerkoj te pajisem me nje kopje te ketyre vendimeve? Nese nuk ka, mbi çfare baze ligjore eshte miratuar ky mbishkrim? 3. A mendoni qe ky mbishkrim i permbush te gjitha detyrimet ligjore dhe eshte në perputhje me kerkesat ligjore të legjislacionit vendas, Per Mbrojtjen Nga Diskriminimi si dhe Konventen Evropiane e Te Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut? Nese po, si e arsyetoni kete? Nese jo,			
--	--	--	--	--	--

		cilat jane masat qe do te ndermarrë institucioni Juaj në ndreqjen e ketij mbishkrimi?			
37	13.04.2017	Kërkesë për informacion të detajuar në lidhje me : Bazuar në pikën 5, Kreu VI i Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, lutemi informacion për përfundimin nga juaj të procesit të verifikimit të të dhenave të deklaruar dhe nëse ka pasur, për numrin dhe emrat /funksionet e personave që kanë rezultuar në kushtet e ndalimit apo që nuk kanë	30.05.2017 Ministria e Kulturës në zbatim të detyrimeve ligjore të parashikuara në Ligjin nr.138/2015 “për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe në Vendimin e Kuvendit nr.17, datë 04.03.2016 “për përcaktimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka kryer procesin e verifikimit të të dhënave nga Zyra e Gjëndjes Gjyqësore. Në përfundim të këtij proçesi, rezulton që, anëtarët e stafit të Kabinetit të Ministrit të Kulturës si edhe disa titullarë të institucioneve në varësi të cilët emërohen nga Ministri, të kenë dorëzuar brenda afateve ligjore formularin e vetëdeklarimit si dhe rezultojnë te padënuar	Përfunduar	Nuk ka

		dorëzuar formularin e vetë deklarimit.	nga gjykatat penale shqiptare, sipas shkresës nr.2295/1, datë 19.05.2017 të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.		
38	26.04.2017	Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të kopjes së hartës së zonifikimit të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Tiranës”, më datë 12.4.2017	26.05.2017 Bashkëlidhur shkresës i është dërguar : Kopje e VKM-së nr.325, datë 12.4.2017 “Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Tiranës dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj të zonës së mbrojtur përreth” dhe hartën bashkëlidhur VKM-së. Kjo VKM gjendet e publikuar dhe në fletoren zyrtare nr.83, datë 20.04.2017	Përfunduar	Nuk ka
39	16.06.2017	Kërkesë për vënie në dispozicion të kopjes së procesverbalit të mbajtur gjatë mbledhjes së Këshillit Kombëtar të Restaurimeve ku është miratuar ndërhyrja në fasadën e Kryeministrit (instalimi i veprës së	21.7.2017 Kthyer përgjigje shkresës ku i është bashkëlidhur kopja e procesverbalit të mbledhjes në të cilën është diskutuar projekti “Vendosja e veprave të artit Marque dhe Mushroom në Kryeministri” si dhe kopje e projektit “The mushroom-Kërpudha-Carsten Holler” dhe “Marquee-Tirana” të vendosura në	Perfunduar	Nuk ka

		Philippe Parrenos, “Marquee Tirana”) si dhe konstruksioni i COD-se, ne audio dhe/ose hardcopy.	dispozicion nga Instituti i Monumenteve të Kulturës		
40	16.06.2017`	Kërkesë për marrje dokumentash, materialesh personale dhe pagesa	Dërguar dokumentacioni i kërkuar	Përfunduar	Nuk ka
41	26.06.2017	Kërkohet plotësimi i formularit me pyetje lidhur me aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara në institucion	18.07.2017 Kthyer përgjigje. Pyetësi i plotësuar	Përfunduar	Nuk ka
42	27.06.2017	Kërkesë për informacion lidhur me projektin “Pallati i Drejtësisë”, që do të përfshijë Gjykatën dhe Prokurorinë e rrethit, projekt që pritet të zbatohet pranë Mauzoleumit të Dëshmorëve. A ka aplikuar Bashkia Durrës për të marrë leje nga institucioni	Kthyer përgjigje nga ASHA Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion në lidhje me projektin “Sheshi publik dhe godina shërbimi institucionale pranë Mauzoleumit të Dëshmorëve”, investim i Bashkisë Durrës, bazuar në Ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, neni 3 pika 2, ju bëjmë me dije se: Pranë ASHA është depozituar	Përfunduar	Nuk ka

		juaj për zhvillimin e këtij projekti? Nëse po, cfarë parashikon projekti lidhur me objektet arkeologjike të evidentuara më herët në këtë perimetër ?Duke ju referuar studimeve me karakter arkeologjik, për pasurinë e nëntokës së kësaj zone mbi cfarë ekspertize dhe argumentash mund apo do ta lejojë Ministria e Kulturës zbatimin e këtij projekti? Cilat institucione do të kenë përgjegjësinë për monitorimin e punimeve? A parashikon projekti një ze të veçantë për kryerjen e sondazheve arkeologjike dhe jo vetëm?	kërkesa e Bashkisë Durrës për projektin e sipërpërmendur, i cili është përcjellë për shqyrtim dhe vendimarrje në KKA. Gjeni bashkëlidhur kopjen e vendimit të KKA nr.96, datë 26.04.2017 në lidhje me këtë projekt.		
43	10.07.2017	1.Sa është numri i projektligjeve/pr	18.07.2017 Ministria e Kulturës për periudhën kohore	Perfunduar	Nuk ka

	objekteve/strategji ve që janë hartuar nga institucioni juaj për periudhën 01.01.2016-06.06.2017? 2.A i janë nënshtruar projekt aktet e mësipërme procedurës së njoftimit dhe konsultimit publik? 3.Na vini në dispozicion një kopje të tabelës për përpunimin e të dhënave në funksion të hartimit të raportit për njoftimin dhe konsultimin publik, sipas parashikimeve të VKM nr.653, datë 18.03.2015 “Për disa ndryshime në vendimin nr.584, datë 28.08.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave” të ndryshuar për	01.01.2016-6.6.2017, ka qenë në proces hartimi të projektligjeve të mëposhtme: -Projektligji “për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” -Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9616, datë 27.9.2006 “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar -Projektligjin “Për pensionet e disa profesioneve të vështira të artistëve” -Projektvendim “Për përcaktimin e tarifave për shpërblim të arsyeshëm nga riprodhimi i veprave për përdorim privat dhe vetjak ose për përdorim tjetër personal” Ministria e Kulturës, në përputhje me Ligjin nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” si dhe VKM-në nr.828/2015 “Për miratimin e rregullave të krijimit dhe administrimit të regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike”, ka marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim		
--	--	---	--	--

		secilin projekt akt të hartuar nga institucioni juaj.	që tu krijojë mundësinë për pjesëmarrje publikut dhe të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik. Gjithashtu, aktete e mësipërme i janë nënshtruar procedurës së konsultimit të drejtpërdrejtë për të cilën janë mbajtur dhe procesverbalet përkatëse si dhe janë publikuar në Rregjistrin elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet publike dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës.		
44	10.10.2017	Në lidhje me tenderin e zhvilluar prej Ministrisë së Kulturës “Për rehabilitimin e TKOB-it”, afatin për mbylljen e të cilit ju e shtytë me pesë ditë, kërkoj: Vendimin e shtyrjes(që përfshin datën dhe arsyet)	23.10.2017 Dërguar me e-mail kopje e vendimit të shtyrjes	Përfunduar	Nuk ka
45	11.10.2017	1.Korrespondenca me UNESCO-n për sa I përket konsultimit me këtë organizëm në	19.10.2017 Kthyer përgjigje me e-mail	Përfunduar	Nuk ka

		lidhje me punimet për ndërtimin e një qendre multifunkSIONALE në Parkun Kombëtar të Butrintit, 2.Detajet e projektit. Nëse është Ministria e Kulturës, detajet nga kjo ministry, nëse është nga një kompani private projektin e saj paraqitur në Ministri. 3.Cila është procedura e ndjekur në përzgjedhjen e kompanisë të cilës I është dhënë leja nga MK për të ndërtuar qendrën multifunkSIONALE në Parkun Kombëtar të Butrintit. 4.Vënien në dispozicion të marrëveshjes kontraktuale mes MK dhe kompanisë private për menaxhimin e kësaj qendre multifunkSIONALE/			
46	23.10.2017	Kërkesë për dokumentacion	30.10.2017 Procedura e shpronësimit në	Përfunduar	Nuk ka

			objektin e trashëgimisë kulturore të cituar në kërkesën tuaj është realizuar nga Ministria e Kulturës dhe Sporteve në vitin 2000. Kjo procedurë ka marrë miratimin me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 292, datë 02.06.2000 <i>“Për shpronësimin e godinës aktuale të Muzeut Etnografik në qytetin e Krujës për inetersa publikë”</i> është vendosur shpronësimi në dobi të Ministrisë së Kulturës dhe Sporteve (sot Ministria e Kulturës) godinës të Muzeut Etnografik”. Referuar ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 <i>“Për arkivat”</i> dorëzimi i dokumentave të institucioneve shtetërore në arkivat përkates, bëhet sipas nenit 42 dhe 43 dhe më konkretisht: <i>“Dokumentet arkivore, me mbarimin e afatit të shërbimit operativ pranë arkivave të institucioneve fondkrijuese, dorëzohen nga këta të fundit për ruatje dhe administrim në arkivat shtetërore, në</i>		
--	--	--	---	--	--

			<i>përputhje me nenin 9 shkronjat "b", "c", "ç" dhe "d" te këtij ligji. Te sistemuara dhe te inventarizuara, sipas rregullave te percaktuara nga Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave.</i> a) <i>dokumentet administrative dorezohen pasi te kene kaluar 10 vjet nga data e krijimit. Ky afat eshte i detyrueshem edhe per dokumentet ne figurë, ne zë, e ne lëvizje, që përbëjnë dokumente administrative.”</i> Nisur sa më sipër, dokumentat administrative të kërkuara nga ju janë dokumenta të krijuara nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ne vitin 2000, përpara 17 vjetësh, dhe janë dorëzuar në Drejtorinë e Pergjithshme të Arkivave sipas parashikimeve ligjore.		
47	30.11.2017	Kërkesë për informim	11.12.2017 Është dërguar Urdhri nr. 164, datë 5.10.2017	Përfunduar	Nuk ka

		Urdhëri për miratimin e strukturës dhe të organikës të Ministrisë së Kulturës dhe organigramën	“Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Kulturës”. Organigrama e Ministrisë së Kulturës		
48	6.12.2017	1.A ka site arkeologjike, banesa, etj me status monument kulture qe u permbyten nga vershimi I lumenjve? 2.Nese po, ju lutem na e bëni me dije se cilat janë konkretisht 3.A ka monumente kulture që janë dëmtuar nga rënia e shirave me intensitet të lartë për disa ditë? 4.Nëse po, ju lutem na e bëni me dije se cilat janë konkretisht. 5.Nëse ka monumente kulture të dëmtuara, cfarë masash do të merren për rikthimin e tyre në normalitet?	29.12.2017 Ministria e Kulturës dhe institucionet në varësi të saj, përgjatë ditëve me reshje të dendura shiu, kanë qenë në dispozicion duke monitoruar orë pas ore situatën e objekteve të trashëgimisë në të gjithë vendin. Nga raportimet periodike, ka rezultuar se nuk ka patur emergjenca në objektet e trashëgimisë, por situata të menaxhueshme në disa pika ku janë paraqitur probleme për shkak të përmbytjeve dhe reshjeve masive si: -Xhamia e Plumbit në të cilën ka pasur pak ujëra, si rezultat i ujërave nëntokësore pasi është nën nivelin e lumenjeve Kir dhe Drin; -Në qarkun e Durrësit: Kisha e Gjon Pagëzorit në Derven të Krujës ka paraqitur problematika për shkak të përmbytjes	Përfunduar	Nuk ka

		6.A ka një përlllogaritje të dëmeve të shkaktuara në vlera financiare? 7.A ka një përlllogaritje të ndërhyrjeve për restarumin e tyre, në vlera financiare? 8.A ka një projekt për restaurimin dhe eliminimin e përmbytjeve në Kishën e Gjon Pagëzorit, në fshatin Derven, Krujë, që u përmbyt edhe vitin e kaluar?	së të gjithë zonës. Tek Forumi Bizantin (Macellum Forum) ka patur rrëshkitje të dherave dhe disa gurëve të mbushjes së trotuarit. U morën masat e menjëhershme për sistemimin dhe përforcimin e skarpatës nga punonjësit e DRKK Durrës; -Në qarkun e Fierit u paraqitën këto problematika: Kisha e Shën Kollit në Vanaj (probleme me çatinë), Kisha e Shën Gjergjit në Libofshë (probleme me çatinë), Kisha e Shën Marisë (probleme me çatinë) dhe Kisha e Shën Gjergjit në Suk, strumë (probleme pasi ndodhet në fushë). -Ka pasur inspektime dhe monitorime në Urën e Golikut; -Janë sistemuar rasat e Kishës së Shën Gjergjit në Shipskë; -Në Vithkuq nuk ka pasur dëmtime serioze të monumenteve të kësaj zone; -Në Parkun Bylis janë dëmtuar vetëm 2 tabela.		
--	--	--	---	--	--

49	3.1.2018	Kopje e buxhetit total për projektet në Art, Kulturë dhe Trashëgimi Kulturore për vitin 2018	12.01.2018 Buxheti total për projektet në programin “Art dhe Kulturë” për vitin 2018, për Ministrinë e Kulturës dhe institucionet në varësi të saj është 137,332,000 lekë. -Buxheti total për projektet në programin “Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë “ për vitin 2018 për Ministrinë e Kulturës dhe institucionet në varësi të saj është 27,524,000 lekë. Theksojmë se jemi në pritje të miratimit të buxhetit për vitin 2018, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.	Përfunduar	Nuk ka
50	8.1.2018	Kërkohej plotësimi I pyetësorit “Indeksi rajonal I hapjes institucionale”	5.2.2018 Plotësuar dhe dërguar	Përfunduar	Nuk ka
51	9.1.2018	Kërkesë për informacion “Vendimi nr. 6, datë 7.1.2005 “Për miratimin e zonave arkeologjike brenda qendrave të banuara në Shkodër, Lezhë, Krujë, Durrës, Elbasan, Berat,	18.01.2018 Dërguar bashkëlidhur vendimi	Përfunduar	Nuk ka

		Vlorë dhe Sarandë”. Të jenë të shoqëruara me hartat dhe cdo material tjetër të lidhur me to.			
52	8.2.2018	1.Sa është shuma e fondeve publike të akorduara nga MK, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2016, për organizatat e shoqërisë civile? Po për vitin 2017? 2.Sa është numri i organizatave civile që kanë aplikuar për këto fonde (të ndara sipas viteve, 2016 dhe 2017)? 3.Sa është numri i organizatave të shoqërisë civile që kanë përfituar nga këto fonde (të ndara sipas viteve 2016 dhe 2017)? 4.Sa është shuma maksimale dhe minimale e përfituar (të ndara sipas	1.3.2018 1. Sa është shuma e fondeve publike të akorduara nga MK, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2016, për organizatat e shoqërisë civile? Po për vitin 2017? Shuma e fondeve publike të akorduara nga MK për vitin 2016, për projekte artistike në fushën e art, kulturë dhe trashëgimi kulturore, në mbështetje të subjekteve të shoqërisë civile është 147.593.227 lekë. Shuma e fondeve publike të akorduara nga MK për vitin 2017, për projekte artistike në fushën e art, kulturë dhe trashëgimi kulturore, në mbështetje të subjekteve të shoqërisë civile, është 157.655.671 lekë. 2. Sa është numri i organizatave civile që kanë aplikuar për këto fonde (të ndara sipas	Përfunduar	Nuk ka

		viteve 2016 dhe 2017)? 5.Sa është numri i shërbimeve të prokuruar nga organizatat e shoqërisë civile gjatë vitit 2016? Po gjatë vitit 2017? 6.Sa është shuma totale e kontratave për shërbimet e prokuruar nga organizatat e shoqërisë civile gjatë 2016, 2017? 7.Sa organizata të shoqërisë civile kanë përfituar mbështetje jo financiare gjatë vitit 2016? Po gjatë vitit 2017? 8.Cili ka qenë lloji i mbështetjes jo financiare të ofruar?	viteve, 2016 dhe 2017)? Numri i subjekteve të shoqërisë civile që kanë aplikuar për mbështetje financiare, nga thirrja e hapur publike për mbështetje të projekteve artistike në fushën art, kulturë dhe trashëgimi kulturore për vitin 2016, është 248Numri i subjekteve të shoqërisë civile që kanë aplikuar për mbështetje financiare, nga thirrja e hapur publike për mbështetje të projekteve artistike në fushën art, kulturë dhe trashëgimi kulturore për vitin 2017, është 269. 3. Sa është numri i organizatave të shoqërisë civile që kanë përfituar nga këto fonde (të ndara sipas viteve 2016 dhe 2017)? Numri i subjekteve të shoqërisë civile që kanë përfituar nga këto fonde, për vitin 2016, është rreth 92 në total. Numri i subjekteve të shoqërisë civile që kanë përfituar nga këto fonde, për vitin 2017, është rreth 123 në total.		
--	--	--	--	--	--

			4. Sa është shuma maksimale dhe minimale e përfituar (të ndara sipas viteve 2016 dhe 2017)? Për vitin 2016, shuma maksimale e përfituar është 1.500.000 lekë dhe shuma minimale është 200.000 lekë. Për vitin 2017, shuma maksimale e përfituar është 1.600.000 lekë dhe shuma minimale është 200.000 lekë. 5. Sa është numri i shërbimeve të prokuruar nga organizatat e shoqërisë civile gjatë vitit 2016? Po gjatë vitit 2017? Nuk ka pasur shërbime të prokuruar. 6. Sa është shuma totale e kontratave për shërbimet e prokuruar nga organizatat e shoqërisë civile gjatë 2016, 2017? Nuk ka pasur. 7. Sa organizata të shoqërisë civile kanë përfituar mbështetje jo financiare gjatë		
--	--	--	---	--	--

			vitit 2016? Po gjatë vitit 2017? Për vitin 2016, janë mbështetur rreth 35 organizata të shoqërisë civile. Për vitin 2017, janë mbështetur rreth 43 organizata të shoqërisë civile. 8. Cili ka qenë lloji i mbështetjes jo financiare të ofruar? Lloji i mbështetjes jo financiare të ofruar janë ambientet e Ministrisë së Kulturës, sallat e institucioneve në varësi të saj, staf dhe burime njerëzore, si dhe promovim dhe komunikim mediatik dhe në faqet zyrtare të Ministrisë së Kulturës.		
53	12.02.2018	Një kopje e plotë, të përditësuar të listës/organikës së stafit që punon në Autoritetin tuaj public duke përfshirë: Rolin/funksionin e punës, emër, mbiemër, datën zyrtare e fillimit të punës, adresën e postës elektronike (email) dhe numrin e	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, të ardhur me e-mail në datën 11 shkurt 2018 dhe të regjistruar në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve me numër rendor 53, me anë të të cilës kërkohet një kopje e përditësuar e listës/organikës së stafit që punon në Ministrinë e Kulturës, bashkëlidhur do të gjeni: -Listën e punonjësve të Ministrisë së Kulturës me të dhënat : emër,	Përfunduar	Nuk ka

		telefonit për përdorim zyrtar	mbiemër, pozicioni i punës. Adresa elektronike e punonjësve të Ministrisë së Kulturës për përdorim të brendshëm është emër.mbiemër@kultura.gov.al , ndërsa adresa zyrtare për komunikimet me të tretë është info@kultura.gov.al . Numrat e telefonit për komunikimin me publikun janë: (04)2271324 dhe (04)2222508.		
54	05.03.2018	Kërkesë për: Kopje të raporteve vjetore të procesit të vendimarrjes për vitin 2016-2017	15.03.2018 Programi i Transparencës, i cili u miratua me Urdhër Ministri nr. 173, datë 30.04.2015 dhe u publikua në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës, ëëë.kultura.gov.al . -si dhe Programin e Transparencës për vitin 2017, miratuar me Urdhër Ministri nr. 147, datë 31.3.2017, të cilin e gjeni të përditësuar në faqen zyrtare ëëë.kultura.gov.al , në linkun; http://ëëë.kultura.gov.al/al/programi/programi-i-transparences/programi-i-transparences	Përfunduar	Nuk ka

55	07.03.2018	Kërkesë për informacion	16.03.2018 Pika 1 Sa është numri i stafit të përfshirë në mekanizmat e kontrollit të brendshëm në 3 vitet e fundit (2015,2016,2017)? Numri i stafit të përfshirë në mekanizmat e kontrollit të brendshëm në 3 vitet e fundit është : Për vitin 2015-2016 është 4 punonjës (1-drejtor dhe 3-specialist) dhe për vitin 2016-2017 është 3 punonjës (1 përgjegjës sektori dhe 2 – specialist). Pika 2 Kush i emëron dhe përmes çfarë procedurash stafin dhe drejtuesin e kontrollit të brendshëm? Stafi i kontrollit të brendshëm dhe drejtuesi i njësisë së kontrollit të brendshëm emërohen në bazë të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” si dhe të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik” Pika 3 Sa është numri i emërimeve në vit në drejtorinë e kontrollit të brendshëm(përfshi periudhën për dy	Përfunduar	Nuk ka
----	------------	-------------------------	---	------------	--------

			ciklet e fundit zgjedhore)? Numri i emërimeve në drejtorinë e kontrollit të brendshëm në 3 vitet e fundit (përfshirë periudhën për dy ciklet zgjedhore) është 1 punonjës. Pika 9 Sa është numri i personave të ngritur në detyrë në vit në 3 vitet e fundit (2015,2016,2017)? Numri i personave të ngritur në detyrë për vitin 2015 është 2 punonjës, për vitin 2016 është 2 punonjës dhe për vitin 2017 është 3 punonjës. Pika 10 Sa është numri i personave të pushuar në vit në 3 vitet e fundit (2015,2016,2017)? Numri i personave të pushuar nga puna në vitin 2015 është 1 punonjës, në vitin 2016 është 0 punonjës dhe në vitin 2017 është 0 punonjës. Pika 11 Sa është numri i personave me lëvizje paralele në vit në administratën publike në 3 vitet e fundit (2015,2016,2017)? Numri i personave me lëvizje pralele në vitin 2015 është 1 punonjës , në vitin 2016 është 0	
--	--	--	---	--

			punonjës dhe në vitin 2017 është 1 punonjës. Pika 12 Sa është numri i personave të shpërblyer (shpërblime materiale dhe jo-materiale) në vit, në 3 vitet e fundit (2015,2016,2017)? Gjatë viteve 2015-2017 nga ana e Ministrisë së Kulturës nuk janë dhënë shpërblime. Pika 13 Sa është numri i sinjalizuesve në vit, në 3 vitet e fundit (2015,2016,2017) dhe a janë mbrojtur ata? Numri i sinjalizuesve në 3 vitet e fundit është 2. Po, janë të mbrojtur.		
56	7.03.2018	Kërkesë për informacion	20.03.2018 1. Cili është institucion përgjegjës për shpërndarjen e fondeve publike për OJF-të si në nivel qendror dhe lokal (nëpërmjet kontratave të grantimit)? Institucioni përgjegjës për shpërndarjen e fondeve per OJF-të në nivel qendror është Ministria e Kulturës ndërsa në nivel lokal Qarqet dhe Bashkitë. 2. Cili është autoriteti përgjegjës dhe cila është procedura për emërimin e strukturave drejtuese që caktojnë shpërndarjen e	Përfunduar	Nuk ka

			fondeve publike për OJF-të? Autoriteti përgjegjës është Ministria e Kulturës. Procedura e emërimit të strukturave drejtuese që caktojnë shpërndarjen e fondeve publike për OJF-të caktohet me urdhër Ministri. 3. Cila është jurisprudenca e tyre? Ju lutem përshkruani kompetencat e tyre dhe specifikoni entitetet për të cilat ata janë përgjegjës. Jurisprudenca e tyre është: Me urdhër Ministri ngrihet Kolegjiumi i cili i propozon Ministrit shpërndarjen e fondeve për OJF-të sipas kërkesave të tyre konform Udhëzimit dhe kriterëve të nxjerra nga Ministria e Kulturës në faqen e saj ëeb. duke përfshirë të gjitha entitetet që aplikojnë për mbështetje financiare në Ministri. 4. Sa është numri i punonjësve të angazhuar në zbatimin e rregullores për shpërndarjen e fondeve tek OJF-të? Numri i punonjësve të angazhuar në zbatimin e rregullores së shpërndarjes së fondeve për OJF-të është: 5 punonjës anëtarë Kolegjiumi dhe 5 punonjës sekretari teknike, si dhe 1 punonjës		
--	--	--	---	--	--

			i Drejtorisë së Financës. 5. Sa është numri i emërimeve brenda institucionit përgjegjës për shpërndarjen e fondeve për OJF-të në vit (ju lutem përfshini periudhën e dy cikleve zgjedhore 2013-2017, 2017-2021)? Në të dy ciklet zgjedhore 2013-2017 dhe 2017-2021 nuk ka emërime enkas brenda institucionit përgjegjës për shpërndarjen e fondeve tek OJF-të, Kolegjiumi që ngrihet për të mbështetjen financiare për OJF-ngrihet me Urdhër të Ministrit dhe përbëhet nga punonjës ekzistues të Ministrisë. 6. Ju lutemi përshkruani kuadrin rregullator (aktet ligjore dhe nënligjore) të miratuar gjatë vitit të kaluar (2017) në fushën e medias dhe shoqërisë civile. Për vitin 2017 nuk është miratuar asnjë akt në fushën e medias dhe shoqërisë civile.		
57	15.03.2018	Kërkohej informacion se cilat janë institucionet e Ministrisë së Kulturës që vlerësohen Autoritete Publike	26.03.2018 Institucionet e Ministrisë së Kulturës të cilët vlerësohen autoritete publike -Instituti Monumenteve të Kulturës "Gani Strazimiri"	Përfunduar	Nuk Ka

			-Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Berat -Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Gjirokokastër -Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Korçë -Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Durrës -Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Shkodër -Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Vlorë -Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik, Apolloni -Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik, Bylis -Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Kombëtar të Butrintit -Muzeu Historik Kombëtar -Muzeu Kombëtar :Gj. K. Skënderbeu" dhe Etnografik, Krujë -Qendra Kombëtare e Muzeumeve, Berat -Muzeu i Artit Mesjetar, -Muzeu i Arsimit dhe Muzeu Arkeologjik, Korçë -Muzeu Kombëtar "Gjethi" Muzeu Kombëtar i Pavarësisë Vlorë		
--	--	--	--	--	--

			-Muzeu Kombëtar i Fototografisë "Marubi" -Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike -Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore -Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, Tiranë INSTITUCIONET E KULTURES -Teatri Kombëtar I Operas, Baletit dhe - Ansamblit Popullor Teatri Kombëtar -Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë -Galeria Kombëtare e Arteve -Bibloteka Kombëtare -Qendra Kombëtare e Realizimit të Veprave të Artit -Arkivi Qëndror Shtetëror i Filmit		
58	20.03.2018	Kërkesë për Relacionin shoqërues të projekt-vendimit që është miratuar si vendim Nr.325, Date 12.4.2017 Për Shpalljen e Qendrës Historike të Qytetit të Tiranës dhe Miratimin e Rregullores për Administrimin e saj e të Zonës së Mbrojtur përreth. Çdo dokument me të cilin është justifikuar	29.03.2018 Të interesuarit i është vendosur në dispozicion materiali i kërkuar.	Përfunduar. Kthim përgjigje me mail	Nuk ka

		përjashtimi i Teatrit Kombëtar nga harta e zonës së mbrojtur që i bashkangjitet Vendimit të lartpërmendur.			
59	21.03.2018	Kërkesë për informacion në lidhje me auditin e brendshëm. Pyetja 1 Sa auditime janë realizuar çdo vit gjatë tri viteve të fundit (2015,2016,2017)? Pyetja 2 Sa rekomandime janë dhënë dhe sa nga rekomandimet e dhëna janë zbatuar gjatë 3 viteve të fundit(2015,2016 ,2017)? Pyetja 3 Sa është numri i emërimeve në vit brenda njësisë së auditimit të brendshëm(duke përfshirë periudhën mes dy cikleve zgjedhore)? Jepni një shembull. Pyetja 4 Sa anëtarë të stafit janë angazhua r për	6.04.2018 Sqarojmë se për pyetjet 1 dhe 2 të gjitha materialet e kërkuara do ti gjeni të publikuara në faqen zyrtare ëeb të Ministrisë së Kulturës, ëëë.kultura.gov.al në linkun si më poshtë vijon: http://ëëë.kultura.gov.al/al/programi/programi-i-transparences/programi-i-transparences Pyetja 3 Sa është numri i emërimeve në vit brenda njësisë së auditimit të brendshëm(duke përfshirë periudhën mes dy cikleve zgjedhore)? Jepni një shembull. Numri i emërimeve në drejtorinë e kontrollit të brendshëm në 3 vitet e fundit (përfshirë periudhën për dy ciklet zgjedhore) është 1 punonjës. Shembull; emërimi i drejtorit të njësisë.	Përfunduar	Nuk ka

		kryerjen e auditimit të brendshëm gjatë tri viteve të fundit (2015, 2016, 2017)? Pyetja 5. A janë të disponueshme për publikun raportet e auditimit të brendshëm? Raportet vjetore të drejtorisë së auditit të brendshëm janë të publikuara në faqen zyrtare ëeb të Ministrisë së Kulturës ëëë.kultura.gov.al, në linkun; http://ëëë.kultura.gov.al/al/programi-i-transparences/programi-i-transparences	Pyetja 4 Sa anëtarë të stafit janë angazhuar për kryerjen e auditimit të brendshëm gjatë tri viteve të fundit (2015, 2016, 2017)? Për kryerjen e auditimeve gjatë tre viteve të fundit është angazhuar e gjithë drejtoria, ku përfshihen tre specialistët dhe drejtori i njësisë audituese. Pyetja 5. A janë të disponueshme për publikun raportet e auditimit të brendshëm? Raportet vjetore të drejtorisë së auditit të brendshëm janë të publikuara në faqen zyrtare ëeb të Ministrisë së Kulturës ëëë.kultura.gov.al, në linkun; http://ëëë.kultura.gov.al/al/programi-i-transparences/programi-i-transparences		
60	23.03.2018	Kërkohet informacion në lidhje me:	29.03.2018 Dërgohet tabela me të dhënat statistikore për periudhën janar-shkurt	Kthim përgjigje me e-mail dhe me postë	Nuk ka

		1- Numrin e vizitorëve që kanë vizituar muzetë për muajin Janar & Shkurt 2018, të veçuara. 2- Numrin e vizitorëve për çdo muze të vizituar në muajin Janar & Shkurt 2018 të veçuara. 3- Numrin e vizitorëve që kanë vizituar kalatë për muajin Janar & Shkurt 2018 të veçuara. 4- Numrin e vizitorëve për çdo kala të vizituar në muajin Janar & Shkurt 2018 të veçuara. 5- Numrin e vizitorëve që kanë vizituar parqet për muajin Janar & Shkurt 2018 të veçuara. 6- Numrin e vizitorëve për çdo park në muajin Janar & Shkurt 2018 të veçuara.	2018 në kala, parqe kombëtare, muze kombëtarë dhe GKA.		
61	26.03.2018	-Kërkohej informacion në lidhje me konkursin për ndërfitjen e	28.03.2018 Kthyer përgjigje. Ju informojmë se për përfshirjen e librave artistikë në tekstet	Kthim përgjigje me e- mail dhe dërguar me postë	Nuk ka

		librave artistikë në programin vjetor mësimor. Si organizohet, si mund të konkurohet, pra cilat janë procedurat dhe hapat që duhen ndjekur. -Gjithashtu kërkohet informacion sesi funksionon portali "albanianbooks".	shkollore është përgjegjëse Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Për sa i përket portalit Albanian books, përfshja e autorëve dhe përkthyesve në portal bëhet nga drejtoria përgjegjëse për politikën e librit, pas shqyrtimit të kërkesës së paraqitur prej krijuesve të interesuar. Aktualisht portali është në rikonceptim dhe së shpejti do të jetë sërish on line.		
62	26.03.2018	Kërkesë për informacion në lidhje me “Kopje të raporteve vjetore për transparencën në fushën e vendimmarrjes për vitin 2016, 2017	10.04.2018 Kthyer përgjigje sipas kërkesës së të interesuarit.	Përfunduar.	Nuk ka
63	30.03.2018	Kërkesë për informacion shtesë në lidhje me kërkesën datë 19.03.2018	6.04.2018 Kthyer përgjigje ku i është bashkëlidhur dokumenti përkatës	Përfunduar. Kthyer përgjigje me e- mail.	Nuk ka
64	11.04.2018	Kërkesë për informacion shtesë.	23.04.2018 Kthyer përgjigje ku i janë bashkëlidhur dokumentet përkatëse. 1. kartelën e trashëgimisë kulturore për "kompleksin ndërtimor" në rrugën "Murat Topani" (kodi në hartën e Tiranës II-044)	Përfunduar. Kthyer përgjigje me e- mail.	Nuk ka

			2. V.K.M. për shpalljen e Ansamblit Monument-Kulture të Aksit Kryesor dhe Qendrës Historike të Qytetit të Tiranës (viti 2000) 3. Hartën e Qendrës Historike të qytetit të Tiranës (viti 2017)		
65	11.04.2018	Kërkesë për informacion për Skenën Alternative të Tiranës	3.05.2018 Duke qenë se Autoriteti Kontraktor për hartimin dhe ndjekjen e kësaj procedure është Fondi Shqiptar i Zhvillimit, lutemi drejtojuni këtij institucioni për informacionin e kërkuar në kërkesën tuaj për informacion. Lidhur me relacionin sqarues, planimetri dhe prerje rrethore të këtij projekti si dhe preventivin e përgjithshëm të shpenzimeve, për shkak të volumit të dosjes në fjalë, jeni i lutur të paraqiteni pranë Ministrisë së Kulturës brenda orarit zyrtar të punës, për tu njohur dhe konsultuar me përmbajtjen e këtyre materialeve.	Përfunduar. Kthyer përgjigje me e- mail	Nuk ka.
66	12.04.2018	Kërkesë për informacion shtesë në lidhje me kërkesën datë 23.03.2018	23.04.2018 Kthyer përgjigje ku i janë bashkëlidhur të dhënat statistikore për janar-shkurt 2017	Përfunduar. Kthyer përgjigje me e- mail dhe postë.	Nuk ka

67	19.04.2018	Kërkesë për plotësimin e pyetësorit “Për fuqizimin e personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet punësimit.	10.05.2018 Kthyer përgjigje ku i janë bashkëlidhur të dhënat e pyetësorit.	Përfunduar. Kthyer përgjigje me postë.	Nuk ka
68	25.04.2018	Kërkesë për informacion.	30.04.2018 Informacionin e kërkuar mund ta gjeni në linkun; http://ëëë.kultura.gov.al/al/bazaligjore/projektligje/projektligji-per-trashegimine-kulturore-dhe-muzete-2017	Përfunduar. Kthyer përgjigje me mail.	Nuk ka.
68	25.04.2018	1.A janë ishujt e Ksamilit zonë e mbrojtur? 2. A ka Ministria e Kulturës një plan për mbrojtjen dhe zhvillimin e ishujve? 3. A lejohen ndërtimet në ishujt e Ksamilit? Deri në çfarë mase dhe me çfarë materialesh?	7.05.2018 1.A janë ishujt e Ksamilit zonë e mbrojtur? Ishujt e Ksamilit referuar vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 676, date 20.12.2002 “Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare”, janë shpallur zonë e mbrojtur e monumenteve të natyrës. Gjithashtu referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 693, datë 10.11.2005 “Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit “park kombëtar”, i ndryshuar me Vendimin nr. 134, datë 10.11.2005 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 693, datë 10.11.2005	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail.	Nuk ka.

		të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit “park kombëtar” janë shpallur nënzonë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore. 2. A ka Ministria e Kulturës një plan për mbrojtjen dhe zhvillimin e ishujve? Ministria e Kulturës nuk ka një plan specifik të miratuar për mbrojtjen dhe zhvillimin e ishujve. Siç çdo zonë e mbrojtur e trashëgimisë kulturore duhet t’i referohet ligjit nr. 9048, datë 7.04.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar. Duke qenë se ishujt e Ksamilit janë zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare, duhet ti referoheni edhe legjislacionit dhe institucioneve të ngarkuara me ligj për zonat e mbrojtura natyrore: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura. 3.A lejohen ndërtimet në ishujt e Ksamilit? Deri në çfarë mase dhe me çfarë materialesh?		
--	--	---	--	--

			Siç është parashtruar më sipër megjithëse nuk ka një plan specifik të miratuar, referuar ligjit për trashëgiminë kulturore, çdo zhvillim në këtë territor duhet të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje edhe në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve dhe Këshillin Kombëtar të Arkeologjisë.		
69	25.04.2018	Kërkesë për informacion për Skenën Alternative të Tiranës	3.05.2018 Duke qenë se Autoriteti Kontraktor për hartimin dhe ndjekjen e kësaj procedure është Fondi Shqiptar i Zhvillimit, lutemi drejtojuni këtij institucioni për informacionin e kërkuar në kërkesën tuaj për informacion. Lidhur me relacionin sqarues, planimetri dhe prerje rrethore të këtij projekti si dhe preventivin e përgjithshëm të shpenzimeve, për shkak të volumit të dosjes në fjalë, jeni i lutur të paraqiteni pranë Ministrisë së Kulturës brenda orarit zyrtar të punës, për tu njohur dhe konsultuar me përmbajtjen e këtyre materialeve.	Përfunduar. Kthyer përgjigje me e- mail	Nuk ka.
70	30.04.2018	Kërkesë për Informacion mbi zbulimin e disa furrave për	30.04.2018 Agjencia e Shërbimit Arkeologjik i është përgjigjur kërkesës suaj	Përfunduar. Kthyer përgjigje me e- mail	Nuk ka.

		prodhimin e qeramikës në qytetin e Durrësit	në datën 27.04.2018, duke saktësuar çdo pikë të kërkesës që keni parashtruar për informim.		
71	30.04.2018	Kërkesë për informacion e pajisje dokumentacioni - objekti “Hostel Babameto” - Gjirokastrë, monument kulture kategoria I	8.05.2018 Ministria e Kulturës, me qëllim vlerësimin e kësaj kërkesë ka kërkuar informacion pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës, institucion në varësi të Ministrisë së Kulturës. Nga ky komunikim jemi vënë në dijeni se në arkivin e këtij institucioni nuk ka të depozituar një dokumentacion, referuar kërkesës dhe të dhënave nga ju, në lidhje me objektin “Hostel Babameto – Gjirokastrë”. Në këto kushte, në pamundësi të këtij informacioni ju sugjerojmë që kërkesa juaj t’i drejtohet edhe Fondacionit “Gjirokastra” me të cilin keni lidhur kontratën e bashkëpunimit dhe të shfrytëzimit të këtij objekti dhe Fondacionit “Trashëgimia Kulturore pa Kufij” – Zyra Shqipëri, e cila ka kryer punimet e restaurimit. Ndërkohë një kopje e dokumentacionit i cili duhet të shoqëronte kontratën duhet tu ishte vënë detyrimisht në	Përfunduar. Kthim Përgjigje me e-mail.	Nuk ka.

			dispozicion që në momentin e nënshkrimit të kontratës. Për sa më sipër, Ministria e Kulturës dhe institucionet e saj të specializuara, në varësi të përgjigjes së fondacioneve të sipërcituar janë të gatshme të vijnë asistencën e tyre.		
72	30.04.2018	Kërkesë për kopje të dokumentacionit që lidhet me ndërtimin e Teatrit Kombëtar	11.5.2018 Ministria e Kulturës nuk ka marrë në dorëzim asnjë masterplan apo detyrë projektimi dhe nuk është duke zhvilluar asnjë procedurë prokurimi apo partneriteti në lidhje me Teatrin Kombëtar. Për këtë arsye nuk disponojmë asnjë material të kërkuar nga ana juaj. Për informacion më të detajuar në lidhje me kërkesën tuaj drejtojeni institucionit të Bashkisë së Tiranës.	Përfunduar. Kthyer përgjigje me postë.	Nuk ka.
74	9.05.2018	Kërkesë për informacion: <i>1. Cilat janë planet konkrete për vitin 2018 për mirëmbajtjen e monumentit të trashëgimisë kulturore “burgu i Spacit”?</i>	30.5.2018 Kthyer përgjigje sipas kërkesës së të interesuarit.	Përfunduar. Kthim Përgjigje me e-mail	Nuk ka.

		2. <i>Sa është fondi i përcaktuar nga buxheti për këtë monument?</i>			
75	16.05.2018	Kërkesë për të dhënat statistikore në lidhje me numrin e vizitorëve gjatë vitit 2017 në institucionet kulturore në Tiranë	25.5.2018 Kthyer përgjigje ku i janë bashkëlidhur të dhënat e kërkuara.	Përfunduar. Kthim Përgjigje me e-mail	Nuk ka.
76	21.05.2018	Kërkesë për informacion në lidhje me punimet për ndërtimin e sheshit "Veliera" në qytetin e Durrësit dhe prishjen e murit nga firma private që po zbaton projektin.	6.06.2018 Në lidhje me zbatimin e punimeve për ndërtimin e sheshit "Veliera" në qytetin e Durrësit ju bëjmë me dije se Institucionet e specializuara pas marrjes se njoftimit janë duke ndjekur te gjithë procesin për të kryer verifikimet e nevojshme.	Përfunduar. Kthim Përgjigje me e-mail	Nuk ka.
77	24.05.2018	Kërkesë për kopjen dixhitale të ekspertizës së kryer nga IMK në ndërtesën e TK.	29.5.2018 Kthyer përgjigje ku i është bashkëlidhur materiali i kërkuar.	Përfunduar. Kthim Përgjigje me e-mail	Nuk ka.
78	30.05.2018	Kërkesë për; 1- Pse në ligjin nr 35/ 2016 nuk përfshihet e drejta e autorit ? 2- A janë bërë përpjekje për të bërë një ligj të posaçëm për median online në Shqipëri ?	11.6.2018 Kthyer përgjigje sipas pyetjeve të kërkuara.	Përfunduar. Kthim Përgjigje me e-mail	Nuk ka.

		3 - Pse deri më tani në Shqipëri nuk është miratuar një ligj për të drejtën e autorit në median online dhe çfarë e ka penguar miratimin e një ligji të tillë?			
	31.5.2018	Kërkesë-ankesë për lëvizje paralele.	4.6.2018 Kthyer përgjigje pas verifikimeve të kryera nga drejtoria përkatëse, ku rezulton i kualifikuar për fazën e parë dhe do ndjekë fazat e tjera të konkurimit.	Përfunduar. Kthim Përgjigje me e-mail	Nuk ka
80	14.06.2018	-A ka një projekt për restaurimin e Kalasë së Libohovës? -Nëse po, a është restauruar ndonjëherë kalaja dy vitet e fundit?	26.6.2018 Për objektin Monument Kulture "Kalaja e Libohovës" janë hartuar 2 projekte restaurimi nga viti 2015-2018. 1. Projekti i Restaurimit të "Kalasë së Libohovës", Gjirokastrë, i miratuar në KKR me Vendim Nr. 157, datë 27.08.2015; 2. Projekti "Punime mirëmbajtje dhe Vendosja e tabelave informuese në Kalanë e Libohovës", i miratuar në KKR me Vendim Nr. 148, datë 12.05.2017. Për projektin e dytë të miratuar është bërë një investim nga Donatorët	Përfunduar. Kthim Përgjigje me e-mail	Nuk ka

			në vitin 2017, i cili ka përfunduar.		
81	3.07.2018	Kërkesë për vënie në dispozicion të korrespondencës mes MK, Bashkisë së Tiranës dhe firmës “Fusha” për Teatrin Kombëtar.	13.7.2018 Kthyer përgjigje ku i është bashkëlidhur dokumentacioni i kërkuar i njehsuar me origjinalin.	Përfunduar. Kthim Përgjigje me postë	Nuk ka.
82	16.7.2018	Kërkesë për informacion; 1. A po harton apo ka në plan të hartojë ministria e Kulturës një program për guida nënujore që aplikojnë turizmin arkeologjik nënujor me anë të zhytjes? 2. A ka një projekt për ndërtimin e një muzeu që i dedikohet arkeologjisë nënujore në vend?	23.7.2018 1. Ministria e Kulturës nuk ka një program dedikuar guidave nënujore që aplikojnë turizmin arkeologjik nënujor me anë të zhytjes. Duke qenë një aktivitet në kompetencë dhe fushë përgjegjësie të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, institucioni shtetëror që certifikon guidat kombëtare dhe lokale, Ministria e Kulturës është e gatshme të japë kontributin e saj dhe të institucioneve të saj të varësisë në përgatitjen e një nënprogrami dedikuar arkeologjisë nënujore që mund të jetë pjesë e programeve të kualifikimit të udhërrëfyesve turistik kombëtarë dhe lokalë, brenda seksionit të Arkeologjisë, Prehistorisë dhe Antikitetit.	Përfunduar. Kthim Përgjigje me e-mail	Nuk ka

			2. A ka një projekt për ndërtimin e një muzeu që i dedikohet arkeologjisë nënujore në vend? Aktualisht nuk ka një projekt zbatimi për ndërtimin e një muzeu që i dedikohet arkeologjisë nënujore në vend. Në kuadër të një prej objektivave të Ministrisë së Kulturës për përmirësimin e produktin kulturor-turistik përmes shtimit të numrit dhe tipologjive të muzeve, MK duke filluar nga viti 2014 ka ndërmarrë dhe finalizuar hapjen për publikun të 4 muzeve: Muzeu Arkeologjik Durrës, Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi”, Shkodër, Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar, Korçë dhe Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Gjethi”, Tiranë. Në këtë kuadër, në funksion të përmirësimit dhe plotësimit të ofertës muzeale Ministria e Kulturës është duke vlerësuar mundësinë e bashkëpunimit me Institutin e Arkeologjisë, që një nga		
--	--	--	---	--	--

			katet e sipërme të muzeut arkeologjik në Durrës t'i dedikohet arkeologjisë nënujore.		
83	18.07.2018	Kërkesë për informacion mbi: 1) Numrin e vizitorëve në të gjitha sitet e trashëgimisë kulturore nga periudha janar-qershor 2017 dhe janar-qershor 2018 2) Data e saktë në të cilën ka filluar restaurimi i xhamisë së Et'hem Beut në Tiranë	25.7.2018 Informacion mbi numrin e vizitorëve në të gjitha sitet e trashëgimisë kulturore nga periudha janar-qershor 2017 dhe janar-qershor 2018, - Data e saktë në të cilën ka filluar restaurimi i xhamisë së Et'hem Beut në Tiranë. Sipas informacionit të marrë nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, në cilësinë e Mbikëqyrësit të Punimeve, Data e fillimit të punimeve është 23.04.2018.	Përfunduar. Kthim përgjigje me mail.	Nuk ka
84	31.07.2018	Në lidhje me ndërtimin e HEC-it "Slabinjë" ("Slabinjë 1"), nga subjekti "LNK sh.p.k", Ministria e Kulturës ka dhënë një vendim me nr. 55, datë 18.03.2010. Ju lutemi na e vendosni në	06.8.2018 Të interesuarit i është derguar; -Raporti i Vëzhgimit arkeologjik -Vendimi i KKA Nr. 55 datë 18.03.2010	Përfunduar. Kthim përgjigje me mail.	Nuk ka

		dispozicin këtë vendim, si edhe dokumentet shoqëruese, si ato të dorëzuara tek ministria e Kulturës nga kjo kompani, po ashtu edhe ato që specialistët e kulturës apo palët e treta mund të kenë përgatitur lidhur me fushën që ju mbulon.			
85	22.08.2018	Kërkesë për informacion në lidhje me: 1-A bëhet monitorimi online i siteve të trashëgimisë kulturore? 2- Nëse po, cilat janë sitet që po monitorohen online? 3-Prej sa kohësh bëhet monitorimi i këtyre siteve?	28.08.2018 1-Sot Monitorimi online i trashëgimisë kulturore kryhet në masën 100% në institucionet muzeore kombëtare. 2-Ndër vite ky proces është realizuar hap pas hapi në mënyrë të pjesshme në monumentet e kulturës dhe parqet arkeologjike ku pjesë e monitorimit janë dhe strukturat e biletarive elektronike. 3- Është një proces në vijim dhe një prej prioriteteve të MK.	Përfunduar. Kthim përgjigje me mail.	Nuk ka.
86		28.08.2018 Kërkesë për Informacion në lidhje me vizitimin e bazilikës paleokristiane të	04.09.2018 1. Si funksionon vizitimi i këtyre mozaikëve, a ka sistem pagese? - Vizita është pa pagesë.	Përfunduar. Kthim përgjigje me mail.	Nuk ka

		Linit, në Pogradec. 1. Si funksionon vizitimi i këtyre mozaikëve, a ka sistem pagese? 2. Në cilat ditë mund të vizitohet? 3. Në çfarë orarësh? 4. Cili është institucioni që kryen mirëmbajtjen dhe administrimin e tyre?	2. Në cilat ditë mund të vizitohet? 3. Në çfarë orarësh? - Mozaiket mund të vizitohen nga e Hëna në të Premte nga ora 09:00-19:00 - Sipas konfirmimit nga IMK Mozaiku i bazilikës paleokristiane Lin, në Pogradec do të jetë i vizitueshëm nga qytetarët shqiptarë dhe të huaj dhe është parashikuar të qëndrojë i hapur deri në datën 15.09.2018. 4. Cili është institucioni që kryen mirëmbajtjen dhe administrimin e tyre? - Institucioni që kryen mirëmbajtjen dhe ka në administrim Baziliken e Linit është Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Korçë.		
87	10.09.2018	Kërkesë për vendosjen në dispozicion të shkresës që Ministria e Kulturës i ka dërguar Drejtorisë së Aluizni-t, Vlorë për mbrojtjen e Zonës	20.09.2019 Të interesuarit i është vendosur në dispozicion informacioni i kërkuar.	Përfunduar.	Nuk ka.

		Arkeologjike dhe Historike në lagjen “Pavarësia” nga ndërtimet informale.			
88	10.09.2018	Kërkesë për informacion në lidhje me procesin e liçensimit të shoqatës “Gramma”	18.09.2018 Të interesuarit i është vendosur në dispozicion materiali i kërkuar.	Përfunduar. Kthim përgjigje me mail.	Nuk ka.
89	11.09.2018	Kërkesë për informacion për “Promovimin e artizanatit në Krujë. -Çfarë projektesh janë realizuar nga 2016-2018 mbi artizanatin në Krujë? -Cilat janë karakteristikat e këtyre projekteve? Psh, fushata promovimi (publiku i targetuar-metodat), restaurimi i pazarit të Krujës... -Sa është numri i turistëve që kanë vizituar Krujën në 2016, 2017 dhe 2018? -Cilat janë karakteristikat e këtyre turistëve (kombësia, mosha, gjinia)?	26.09.2018 Kthyer përgjigje; për informacionin e kërkuar mund ti drejtoheni Bashkisë së Krujës.	Përfunduar. Kthyer përgjigje me telefon.	Nuk ka.

90	19.09.2018	Kërkesë për vendosjen në dispozicion të listës së Busteve dhe statujave në qytetin e Tiranës	28.9.2018 Kthim përgjigje dhe delegim kërkesë pranë Bashkisë Tiranë pasi informacioni i kërkuar është brenda kompetencave të këtij institucioni	Përfunduar. Kthim përgjigje personit të interesuar me e-mail dhe postë.	Nuk ka.
91	20.09.2018	Kërkesë për informacion lidhur me përmbytjen e katit të nëndheshëm të Ministrisë së Kulturës.	10.10.2018 Kthyer përgjigje	Përfunduar. Kthim përgjigje personit të interesuar me e-mail dhe postë.	Nuk ka.
92	20.09.2018	Kërkesë për informacion: 1- Kalaja e Pogradecit, a kategorizohet si pjesë e siteve kulturore? 2- A ka patur dhe a ka Ministria e Kulturës, projekte për rehabilitimin e kësaj kalaje? 3- A ka pasur investime nga ana e qeverisë qendrore dhe nga Ministria e Kulturës? 4- A është pjesë e projekteve për rehabilitimin nga ana e Ministrisë së Kulturës, Kalaja e Pogradecit?	01.10.2018 Në listën zyrtare të monumenteve të kulturës për vitin 2018, në Bashkinë Pogradec, “Kalaja e Pogradecit” është objekt me status monument kulture, kategoria e parë, shpallur me Vendim nr.6, datë 15.01.1973, të Rektoratit të Universitetit Shtetëror të Tiranës, dhe Vendim nr.1886, datë 10.06.1973, të Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës. Sa I përket pikave të tjera sqarojmë se Instituti i Monumenteve të Kulturës nuk ka hartuar dhe miratuar asnjë projekt lidhur me rehabilitimin e Kalasë së Pogradecit.	Përfunduar. Kthim përgjigje personit të interesuar me e-mail.	Nuk ka

		5- Nëse keni ndonjë projekt për rehabilitimin e Kalasë, na dërgoni një kopje të projektit? 6- Sa është kostoja e projektit?			
93	1.10.2018	Kërkesë për Informacion në lidhje me ArTurbina, në të cilën kërkohet vendosja në dispozicion ; Kopje të 1.Korrespondencës zyrtare midis Ministrisë së Kulturës dhe Teatrit Kombëtar në lidhje me administrimin e sallës së TK. 2.Urdhrave eventuale të Ministrit për përdorimin ose mospërdorimin e kësaj sale. 3.Aktit të marrjes në dorëzim të sallave të Arturbinës nga TK (nga ndërtuesi privat ose Ministria e Kulturës). 4.Korrespondencën zyrtare midis Ministrisë së Kulturës dhe Teatrit Kombëtar	12.10.2018 Kthyer përgjigje për pikat 1.2.3.6 ku I është vendosur në dispozicion dokumentacioni I kërkuar. Ndërsa për pikat 4.5.7.8 MK nuk e disponon informacionin e kërkuar.	Përfunduar. Kthyer përgjigje me e-mail.	Nuk ka.

		në lidhje me projektin e ndërtesës së re të Teatrit Kombëtar (përfshi korrespondencën me kompaninë Fusha shpk, studion projektuese Bjarke Ingels Group dhe Bashkinë Tiranë). 5.Akteve të ekspertimit për ndërtesën e Teatrit Kombëtar Eksperimental. 6.Planimetrisë së ndërtesave të TK dhe TKE, përfshi edhe oborrin mes tyre dhe sipërfaqet përkatëse të cituara për çdo mjedis të katit përdhes, pra kuota zero. 7.Vendimit të Këshillit të Ministrave apo Urdhrit të Ministrit për shembjen e TKE dhe dokumentacionin mbi të cilin është bazuar. 8.Informacionit mbi mënyrën e funksionimit të TKE pas ndërtimit eventual të Teatrit të ri Kombëtar mbi gjurmën ekzistuese të TK dhe TKE.			
--	--	--	--	--	--

94	28.09.2018	Në maj të këtij viti, një grup qytetarësh kanë propozuar shpalljen e kompleksit teatrore që përfshin TK dhe TKE “monument kulture”. Kërkoj kopje të proces-verbaleve të mbledhjeve, opinionave, vendimit dhe çdo dokumenti tjetër të lidhur me shqyrtimin e këtij propozimi, në vitin 2018 dhe në vitin 2004, të prodhuar nga IMK dhe Ministria e Kulturës.	10.10.2018 Ministria e Kulturës në bashkëpunim me Institutin e Monumenteve të Kulturës, Ju informon si më poshtë vijon: Kompleksi që përfshin godinat e Teatrit Kombëtar dhe Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli” ndodhet brenda Zonës së Mbrojtur të Qendrës Historike të Tiranës. Ky kompleks u ndërtua në 1938, si një strukturë e përkohshme, me kërkesë të qeverisë së kohës për të përmbushur nevojat kulturore për qytetarët e Tiranës. I projektuar si një kompleks ndërtimor që përbëhet nga dy godina simetrike, përgjatë një aksi dhe të lidhura mes tyre me një kolonadë të hapur; kompleksi përfshinte funksione të ndryshme. Në njërin prej objekteve u realizua teatri, në objektin tjetër përmbledheshin funksione më të përgjithshme si sallë balloje, sallë lojërash, librari, restorante e ambiente shërbimi; ndërsa në oborrin e pasmë pozicionohej zona e sportive me palestrën, fushën e	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail	Nuk ka
----	------------	---	--	---	--------

			tenisit e ambientet e shërbimit për to. Që prej ndërtimit të tij e deri në ditët e sotme, objekti ka pësuar transformime të shumta që lidhen me shërbimet, funksionet e deri te ndërtimi në vetvete, pasi njëri prej objekteve aktualisht shërben si Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, ndërsa objekti tjetër funksionon si Teatri Kombëtar me një sallë shfaqjeje, ndërkohë ndërtesat e dikurshme të palestrës në fund të kompleksit janë përshtatur në ambiente ndihmëse. Bazuar në përshkrimin e mësipërm është e dukshme që në këtë kompleks ndërhyrjet ndër vite kanë qenë të shumta. Këto ndërhyrje kanë të bëjnë me shtesa e rikonstruksione me qëllim përshtatjen e ambienteve ekzistuese të kompleksit për nevojat e funksioneve që iu janë dhënë atyre kohë pas kohe si dhe përpjekjet për përmirësimin e kushteve për funksionet ekzistuese. Në vitin 2004, si pjesë e nismës për shpalljen e monumenteve të kulturës së kategorisë II në qytetin e Tiranës,		
--	--	--	---	--	--

			objekti i Teatrit Kombëtar së bashku me një listë prej rreth 100 objektesh të tjera në qytetin e Tiranës është shqyrtuar në Këshillin Shkencor (KSH) të Institutit të Monumenteve të Kulturës (IMK) që asokohe përbëhej nga: - Dr. Gazmend Muka (Drejtor IMK), kryetar, - Prof. Dr. Emin Riza (specialist), anëtar, - Prof. Dr. Gjerak Karaiskaj (specialist), anëtar, - Prof. Dr. Valter Shtylla (specialist), anëtar, - Dr. Latif Lazimi (specialist), anëtar, - Prof. Dr. Muzafer Korkuti (Drejtor i IA), anëtar i jashtëm, - Përgjegjësi i sektorit materiale në DTK, anëtar i jashtëm. Bazuar në përfundimin e diskutimeve në KSH dhe në dërgimin e shkresës Nr.356 Prot., datë 18.05.2004, ku IMK i dërgon Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve listën e objekteve monument kulture të kategorisë II në Qendrën Historike të Tiranës, vërehet se në		
--	--	--	---	--	--

			pikën 70 të listës bashkëlidhur kësaj shkrese, objekti “Teatri Kombëtar” përmendet si <i>ndërtesë pa vlera</i>, duke mos u përfshirë në Urdhrin Nr.122, datë 05.03.2007 “Për Shpalljen Monument Kulture të kategorisë së II-të të ndërtesave në Aksin Kryesor të Qendrës Historike të qytetit të Tiranës”. Disa herë janë kryer inspektime në këtë objekt nga IMK dhe nga Instituti i Ndërtimit për të vlerësuar gjendjen e Teatrit Kombëtar, të cilat sjellin në vëmendje gjendjen e rënduar dhe të amortizuar. Gjithashtu, propozimi i Sindikatës së Artistëve të Skenës dhe Ekranit u shqyrtua në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Restaurimeve (KKR) i cili u zhvillua në datë 11.06.2018. Gjatë mbledhjes u paraqit i gjithë dokumentacioni i disponueshëm dhe u konkludua se objekti në fjalë nuk përmbush kriteret dhe nuk paraqet vlera të veçanta arkitektonike për t’u bërë pjesë e listës së monumenteve të qytetit të Tiranës.		
--	--	--	--	--	--

95	10.10.2018	Bazuar ne ligjin 118/2004, lutemi na vini në dispozicion listën e aktiviteteve, investimeve dhe projekteve të MK dhe institucioneve në varësi të adresuara për territorin e qarkut Gjirokastër, si dhe projektet e vendosura tashmë për periudhën deri në 31 dhjetor 2018.	15.10.2018 INVESTIME NË TERRITORIN E QARKUT GJIROKASTËR: <u>NGA BUXHETI I SHTETIT</u> Restaurim "Banesa Vëllezërve Frashëri", Përmet - 2018 Restaurim "Kisha Shën Mërisë" Peshkëpi e Sipërme- Gjirokastër - 2018 Restaurimi "Kisha e Shën Apostujve", Hoshtevë-Zagori - 2018 Restaurim " Ura e Kollorcës" 4 km në juglindje të Gjirokastrës ,Lazarat - 2018 Restaurim "Ura Nivanit", Nivan-Ndëran, Zagori, Gjirokastër , - 2018 Projekti për përforcimin e shpatit, Kalaja Gjirokastër, 2018 - 2019 Restaurimi I Shkollës "Asim Zeneli", Gjirokastër , 2018 - 2019 <u>INVESTIME DONATORË</u> AADF - Restaurimi i Pazarit të Gjirokastrës, për Blloqet B3, B6, B7, B8, B1, B9, B5, B10 - 2018	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail	Nuk ka
----	------------	--	---	--	--------

			TIKA - Restaurimi i Kullës së Sahatit Gjirokaster 2017-2018 TIKA - Ndriçimi i kullës së sahatit, Gjirokastër - 2018 ChEB- Vendosja e Tabelave informuese në Kalanë e Gjirokastres - 2018 FSHZH - Rehabilitimi i infrastrukturës dhe restaurimi i kalldrëmeve në Pazarin e Gjirokastrës 2018-2019 TIKA - Restaurim Xhamia e Pazarit, Gjirokastër 2018-2019 <u>PROJEKTE</u> <u>MIRËMBAJTJE TË</u> <u>REALIZUARA NGA</u> <u>DRTK</u> <u>GJIROKASTËR:</u> -Restaurim i pjesshëm i çatisë së Banesës "ZEKO", -Ndërhyrje përforcuese në banesën "Fico", -Përfundimi i punimeve në banesën Asllan Dalipi "Konomi", -Fillim i punimeve në banesën "Duka", -Ndërhyrje restauruese banesa "Sinoimeri", -Përfundimi i punimeve banesa "Koko", -Përfundimi i punimeve në banesën S.Karaulli, -Përfundimi i punimeve në banesën Hoxha në pazarin e vjetër,		
--	--	--	--	--	--

			-Mirëmbajtje, pastrime, sistemime në Kalanë Gjirokastrër. Projektet me Thirrje të Artit,Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore në Qarkun e Gjirokastrës. AKTIVITETE TË REALIZUARA : 1.Projekti “<i>Traditë Arti Kulturë</i>”- <i>Çelsat e ruajtjes së Trashëgimisë</i>”, organizuar nga Shoqata CESVI në qytetin e Përmetit më 14 mars, me rastin e Ditës së Verës. 2. Projekti “<i>Java e Ali Pashës</i>”, zhvilluar në qytetin e Tepelenës në datat 25-28 maj, zhvilluar nga Qendra Kulturore Tepelenë. 3. Projekti i Festivalit Përmeti Multikulturor 2018, edicioni 16-të, u organizua nga Seksioni Shqiptar i CIOFF-it në qytetin e Përmetit më datat 21-22-23 qershor 2018 4.Projekti „Lirika e Divanit lunxhjt“ u zhvillua nga Qendra Rajonale „Syri i Medias së Re“ në fshatin Dhoksat, në 11 gusht.		
--	--	--	--	--	--

			5. Projekti „Brumi i jetës“ u zhvillua nga Shoqata „Miqësia“ në qytetin e Gjirokastrës, në datat 6-7 shtator. 6. Projekti „Realizimi i Shtëpisë Muze-Rijetezimi i figurës së Artistit të Popullit Usta Laver Bariu“. Ky projekt u realizua nga z. Kliton Nurka, person fizik, në periudhën mars-shtator 2018, në qytetin e Përmetit. 7. Tourismovie” nga “TUN NELFILM“- Përmet/Gjir okastër/ Korçë Pogradec/ në datat 26, 27 maj dhe 4, 5 korrik. 8. „Gojëdhëna e harruar „ nga <i>Open Doors for Albanian Youth</i> “Oday” në qytetin e Memaliajt, në datat 1-2 gusht. 10. QKKF Turi Veror Kulturor “Ne jemi rreze”, 6 korrik – 6 gusht 2018 • “Tre shfaqje për fëmijë” nga QKKF në Gjirokastrë- 26 korrik 2018 11. TKOBAP • “ Sokaku i të marrëve” nga Ansambli Popullor në Gjirokastrë- 18 – 21 korrik 2018		
--	--	--	--	--	--

			Projekte me Thirrje EDUKIM : 1. Projekti: “Edukimi përmes këngës gjirokastrite të brezit të ri”, u realizua nga këngëtari Roland Çenko në qytetin e Gjirokastrës, periudha Mars-Qershor. 2. Projekti “Edukimi i fëmijëve përmes trashëgimisë kulturore, materiale dhe jomateriale”, zhvillohet nga znj. Arianë Todhe në qytetin e Përmetit, në periudhën mars-qershor. 3. Projekti “Rijetëzimi i trashëgimisë së luleve të traditës-ndikon në edukimin e të rinjve dhe turizmin mjedisor” zhvillohet nga z. Ali Delialaj në qytetin e Përmetit më datë 6.6.2018.		
--	--	--	--	--	--

			Projekte me Thirrje që do të realizohen në periudhën tetor-dhjetor 2018 1.Projekti „Frymëzime nga shtëpitë-legjendë të Gjirokastrës“ zhvillohet nga Shoqata „Open Doors“ në qytetin e Gjirokastrës në periudhën qershor-tetor. Përmban promovim objekteve, ekspozitë fotografike, konkurs. 2.Takimi Mbarëkombëtar i Teatrit “Kadri Roshi” nga Shoqata ”Çajka”, Gjirokastrë 9-15 nëntor. Ndërsa Drejtoria Rajonale- Gjirokastrë për periudhën janar-shtator 2018 ka organizuar 28 aktivitete në të gjithë qarkun.		
96	22.10.2018	1. Kopje të planimetrisë, për çdo kat, të ndërtesave të Teatrit Kombëtar dhe TKE “Kujtim Spahivogli”, me përmasat, sipërfaqen dhe funksionin e tyre. 2. Kopje të prerjeve tërthore dhe kuotat	1.11.2018 Ministria e Kulturës nuk e disponon informacionin e kërkuar.	Përfunduar. Kthim përgjigje me postë dhe e-mail	Nuk ka.

		përkatëse të lartësisë për të ndërtesat e Teatrit Kombëtar dhe TKE “Kujtim Spahivogli”. 3. Kopje të vlerësimit financiar të kapitalit fizik të Teatrit Kombëtar dhe TKE “Kujtim Spahivogli” që do të asgjësohet në rast të shembjes së këtyre ndërtesave.			
97	22.10.2018	1. A është aktualisht në përdorim salla “Kadri Roshi” e Teatrit Kombëtar? Nëse po, cili institucion e administron dhe pse nuk ka aktualisht shfaqje në program? Nëse jo, cila instancë ka marrë vendim për mbylljen e saj dhe mbi ç’bazë ligjore? Kërkoj kopje të dokumentave. 2. A ka pasur korrespondencë zyrtare mes TK dhe MK në lidhje me	2.11.2018 1.Salla “Kadri Roshi” nuk është në përdorim dhe aty nuk zhvillohet asnjë program artistik. Kjo sallë administrohet nga Teatri Kombëtar dhe Programi Artistik po realizohet pranë qendrës multikulturore ArTurbina. Instituti i Ndërtimit në shkresën nr. 75/1, datë 23.3.2018 është shprehur që salla “Kadri Roshi” nuk mund të jetë funksionale. 2. Nuk ka asnjë korespondencë zyrtare mes institucioneve lidhur me propozimin e pakërkuar të firmës “Fusha” SH.P.K. 3. Lidhur me çështjet e lartpërmendura informacioni i kërkuar	Përfunduar. Kthim përgjigje me postë dhe e-mail	Nuk ka.

		propozimin e pakërkuar të firmës Fusha shpk dhe projektimin e ndërtesës së re të TK? Nëse jo, pse? Nëse po, dua një kopje të kësaj korrespondence? A do të shembet salla e TKE “Kujtim Spahivogli” për t’i hapur rrugë ndërtimit të ndërtesës së re të TK? Nëse po, cila instancë shtetërore ka vendosur shembjen? A është bërë ekspertiza teknike nga Instituti i Ndërtimit dhe vlerësimi i pasurisë që do të sakrifikohet me këtë rast? Nëse janë kryer, a mund të jepni kopje të këtyre dokumenteve? A do të vazhdojë të ekzistojë institucioni i TKE “Kujtim Spahivogli” pas shembjes së sallave të tij aktuale? Nëse po, ku do ta kryejë	mund të jepet në varësi të konkluzioneve të dala nga aktet përkatëse të miratuara në zbatim të ligjit nr.37/2018, date 20.09.2018. Institucioni do të ekzistojë dhe vijojë veprimtarinë e tij artistike.		
--	--	--	---	--	--

		veprimtarinë ky institucion?			
98	22.11.2018	1.Pasur parasysh që buxheti i Ministrisë së Kulturës për vitin 2018 nuk është i publikuar në faqen Tuaj të ëëbit, kërkojmë të kemi në dispozicion buxhetin e këtij viti. 2.Cili është buxheti i planifikuar për vitin 2019? 3.Cilat janë aktivitetet kryesore që Ministria Juaj ka zhvilluar gjatë vitit 2018? 4.Cilat janë aktivitetet kryesore që Ministria Juaj do të zhvillojë gjatë vitit 2019? 5.Cilat janë fokuset kryesore të Ministrisë së Kulturës për vitin 2019?	12.12.2018 Referuar pikës 1 dhe 2 të kërkesës suaj sqarojmë se informacionin e kërkuar mund ta gjeni në linkun e mëposhtëm, të publikuar në faqen zyrtare ëeb të Ministrisë së Kulturës. http://kultura.gov.al/ëp-content/uploads/2018/12/Raporti-per-buxhetin-2019-Ministria-e-Kultures.pdf Referuar pikës 3 të kërkesës suaj, informacionin e kërkuar e gjeni në linkun e mëposhtëm. http://ëëë.kultura.gov.al/shpallen-projektet-fituese-ne-art-kulture-trashegimi-per-vitin-2018-2/ Referuar pikës 4 dhe 5 të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se, Ministria e Kulturës në fillim të muajit dhjetor hapi Thirrjen për projekt- propozime në Art, Kulturë, Trashëgimi Kulturore për vitin 2019, në të cilën është parashtruar	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail	Nuk ka

			edhe fokusi kryesor për vitin 2019. Të dhënat mund ti gjeni në linkun si më poshtë vijon: http://ëëë.kultura.gov.al/projekt-propozime-ne-art-kulture-dhe-trashegimi-kulturore-per-vitin-2019/		
99	6.12.2018	Kërkesë për informacion, në lidhje me : 1.Çmimet e te gjitha destinacioneve turistike në të gjithë vendin, 2.Çmimet në grup dhe individuale. 3.Çmimet për guidat që ofrohen në këto destinacione. 4. Sa nga këto destinacione mund të pritët bileta online?	14.12.2018 1. Referuar kuadrit ligjor në fushën e trashëgimisë kulturore ligjit nr. 27/2018 çmimi dhe formati i biletës per site dhe muze ne varësi të Ministrisë së Kulturës miratohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Në këto kushte bashkëlidhur gjeni informacionin mbi çmimet e biletave dhe reduktimet e tyre sipas kategorive shoqërore, në institucionet e trashëgimisë kulturore. • Njëkohësisht ju bëjmë me dije se referuar legjislacionit në fuqi, VKM Nr.776, date. 14.12.2005 “Për vendosjen e çmimeve të reduktuara të biletave të	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail	Nuk ka

			<i>muzeve publikë për kategori të caktuara shoqërore”, i ndryshuar reduktim bilete përfitojnë kategoritë e caktuara shoqërore që janë shtetas shqiptar, (vizitorëve vendas) dhe jo të huaj.</i> 1.1 Njëkohësisht bashkëlidhur gjeni informacionin mbi ditët kur Ministria e Kulturës ofron hyrje të lirë me tarifë zero, në të gjitha institucionet dhe sitet e trashëgimisë kulturore të vizitueshme. 2. Referuar informacionit mbi çmimin e guidave dhe prerjes së biletave online ju informojmë se: • Guidat në institucionet e trashëgimisë kulturore të vizitueshme janë pjesë e stafeve të këtyre institucioneve në varësi të Ministrisë së Kulturës. Lidhur me	
--	--	--	---	--

			guidat e licencuara me pagesë sjellim në vëmendje se ato nuk janë pjesë e administrimit dhe përgjegjësisë së Ministrisë së Kulturës, por e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, institucion prej të cilit çertifikohen. • Lidhur me mundësinë e rezervimit të biletave online u informojmë se ky proces është në fazën e hartimit dhe të implementimit të projektit nga Ministria e Kulturës..		
100	12.12.2018	Kërkoj informacion bazuar në ligjin për të drejtën e informimit 119/2014 për aktivitetet e planifikuara nga Plani Kombëtarë i Veprimit për Romët dhe Egjiptianët si më poshtë nëse janë realizuar dhe nëse jo kërkoj	20.12.2018 Referuar pikës 1 të kërkesës suaj sqarojmë se, Ministria e Kulturës punon për integrimin e vlerave kulturore të të gjitha pakicave kombetare në përgjithësi e në veçanti për komunitet rom në të gjitha veprimtaritë kombëtare të trashëgimisë kulturore jomateriale. Gjithashtu në të gjitha veprimtaritë e përvitëshme	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail	Nuk ka

		arsyet e mos-zbatimit 1-Aktiviteti 4.1 Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe artistike të frymëzuara nga identitetet dhe folklori Rom dhe Egjiptian dhe i aktiviteteve që nxisin bashkëpunimin ndërkulturor 2.Aktiviteti 4.4 Përfshirja e historisë, artizanatit dhe identitetit rom dhe egjiptian në guidat turistike dhe krijimi i broshurave për të dy këto komunitete në Shqipëri 3- Aktiviteti 4.5 Informimi i organizatave të romëve dhe egjiptianëve për thirrjen për propozime të Ministrisë së Kulturës dhe burimet e tjera përkatëse të financimit (pra, dërgimi i lidhjes me email) dhe garantimi që projektet e përzgjedhura do	kombëtare të trashëgimisë jomateriale që zhvillon Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike janë ftuar të marrin pjesë grupe të ndryshme nga pakicat kombëtare, ku mund të përmendim Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës, Festivalet Folklorike Tipologjike Kombëtare, etj. Viti 2014 -Projekti “Festojmë së bashku 8 prillin”, Ditën Ndërkombëtare të Romëve” Shoqata “Romët për integrim”, u organizua një pasdite kulturore me familje dhe fëmijë romë. -Projekti organizuar më datë 21Maj - me rastin e Ditës Botërore të Diversitetit Kulturor, u organizua për herë të parë aktiviteti lançues i nismës “Trego Kulturën Tënde”. Në këtë aktivitet, të zhvilluar në Muzeun Historik Kombëtar, u transmetuan video të regjistruara nga përfaqësues të pakicave kombëtare, të cilat kishin në fokus trashëgiminë jomateriale. Viti 2016 -Projekti “ Botimi i Fjalorit Rromisht-		
--	--	---	---	--	--

		të përfshijnë ato projekte që zbatohen nga organizatat rome dhe egjiptiane	Shqip” nga Organizata Rromani Bax Albania. Viti 2017 -Dhënien e sallës së Teatri Kombëtar Eksperimental “Spahivogli” pa pagesë për projektin e shfaqjes së dramës “ Pjata Prej Druri”, interpretuar nga të rinjtë Rom dhe jo Rom. Aktiviteti u realizoua në kuadër të 8 Prillit, Ditës Ndërkombëtare të Popullit Rom, me mbështetjen e Institutit të Kulturës Rome në Shqipëri, Ministrisë së Kulturës dhe UNPD-së/ Projekti ESERE. Referuar pikës 2 të kërkesës suaj drejtojuni Ministrisë që mbulon fushën e Turizmit si institucioni përgjegjës për dhënien e informacionit të kërkuar. Referuar pikës 3 të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se, Ministria e Kulturës në fillim të muajit dhjetor hapi Thirrjen publike për projekt- propozime në Art, Kulturë, Trashëgimi Kulturore për vitin 2019. Të dhënat mund ti gjeni në linkun si më poshtë vijon:		
--	--	---	---	--	--

			http://ëëë.kultura.gov.al/projekt-propozime-ne-art-kulture-dhe-trashegimi-kulturore-per-vitin-2019/		
101	24.12.2018	Kërkesë për vënie në dispozicion të dokumentacionit në lidhje me : 1- procedurat për mbledhjen e informacioneve dhe opinioneve përpara hartimit të një akti, sipas parashikimeve të nenit 12 të ligjit nr.146/2014 « për njoftimin dhe konsultimin publik », etj	7.01.2019 Të interesuarit i është vendosur në dispozicion dokumentacioni i kërkuar.	Përfunduar. Kthim përgjigje me postë.	Nuk ka
102	8.01.2019	Plotësim i pyetësorit : « Indeksi Rajonal i Hapjes Institucionale »	28.01.2019 Pyetësori është plotësuar dhe dërguar.	Kthyer përgjigje me postë.	Nuk ka
103	10.01.2019	Kërkesë për informacion.	14.01.2019 1. Lidhur me pikën 1 të kërkesës tuaj, me anë të së cilës kërkon identifikimin e listës së OJF-ve, grupeve të interesit, aktivistëve të cilët kontribuojnë dhe ftohen në konsultimet e projektakteve, ju bëjmë me dije se Ministria e Kulturës, për të gjitha nismat ligjore në proces ka të identifikuar grupet e interesit të cilat operojnë brenda fushës së saj të veprimtarisë, në	Kthyer përgjigje me postë.	Nuk ka

			fushën e artit, kulturës, librit dhe trashëgimisë kulturore. Ashtu siç ju kemi raportuar edhe në korrespondencat e mëparshme aktualisht janë në proces dy nisma ligjore: a) Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar”, b) Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9616, datë 27.09.2006 ‘Për librin në Republikën e Shqipërisë”, për të cilat Ministria e Kulturës, ka kryer konsultimin publik me të gjitha format që parashikon ligji nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, listat e të cilave do ti gjeni bashkëlidhur. 2. Lidhur me pikën 2 të kërkesës tuaj, ju informojmë se funksioni i koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik në Ministrinë e Kulturës aktualisht kryhet nga z. Ledion Lako, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë se Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës. Në bazë të nenit 10 të ligjit nr. 146/2014 ”Për		
--	--	--	--	--	--

			njoftimin dhe konsultimin publik”, z. Ledion Lako është caktuar Kryetar grupi pune për njoftimin dhe konsultimin bazuar në Urdhrin Nr. 505, datë 30.7.2018, “Për ngritjen dhe funksionimin e rrjetit për konsultimin publik” (bashkëlidhur). 3. Lidhur me pikën 3 të kërkesës tuaj ju sqarojmë se Ministria e Kulturës është gjithnjë e gatshme të ofrojë ndihmë aktive për këdo që drejtohet pranë institucionit tonë duke kërkuar të kuptojë, të informohet apo të përfshihet në konsultimin publik të projektakteve. Të gjitha sugjerimet e ardhura nga individët ose përfaqësuesit e grupeve të interesit, të cilët i janë drejtuar institucionit tonë, janë marrë parasysh dhe në kuadër të tyre janë lidhur edhe marrëveshje bashkëpunimi me synim hartimin e akteve sa më gjithëpërfshirëse. Së fundmi vlen të përmendim, Memorandumin e Mirëkuptimit të lidhur mes Ministrisë së Kulturës dhe Skenës së Pavarur nëpërmjet të cilit Skena e Pavarur, si një organizatë që		
--	--	--	--	--	--

			përfaqëson interesat e bashkimit të të gjitha shoqatave të artit dhe kulturës, është angazhuar për të kontribuar në disa iniciativa të rëndësishme tonat, ndër më të rëndësishmet vlen të përmendim: a) Analizë e thellë e paketës ligjore; b) Konsultim për elementët strukturorë të Dokumentit të draft Strategjisë së Kulturës; c) Konsultim me ekspertët e huaj që janë përfshirë në procesin e hartimit të ligjit/ligjeve/strategjisë përpara ndryshimeve në ligjin nr. 10352 datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën” i ndryshuar dhe/ose akteve nënligjore; 4. Lidhur me pikën 4 të kërkesës tuaj ju sqarojmë se ministria ka filluar procesin e planifikimit për të mundësuar aksesimin e personave me aftësi të kufizuar në proceset e konsultimit publik, si dhe mbështetje dhe përfshirje në projektet e organizuara nga Ministria e Kulturës. Më konkretisht janë realizuar disa projekte me fokus personat me aftësi të kufizuara të cilat kanë pasur të bëjnë me projekte në fushën e		
--	--	--	--	--	--

			librit në ndihmesë të personave me aftësi të kufizuar dhe në veçanti ata me vështirësi shikimi, si: a) “<i>Libra Audio- Marvin Vokopola</i>”, Projekt i cili është përqendruar në ngritjen e një portali për librin e lexuar në ndihmesë të personave me aftësi të kufizuar në shikim. b) “<i>Me sytë e shpirtit</i>”, projekt i mbështetur i Qendrës Kombëtare të rehabilitimit të verbërve Aktivitete të Shoqatës së të verbërve gjatë Lëvizjes Kombëtare për Lexim. Instituti i të verbërve “Ramazan Kabashi” vuri në skenë shfaqjen “Borëbardha dhe 7 xhuxhat” në kuadër të Lëvizjes Kombëtare të Leximit, në sallën e Arturbina. 5. Lidhur me pikën 5 të kërkesës tuaj ju sqarojmë se monitorimi i efektivitetit të procedurës së konsultimit publik për projektaktet realizohet në përputhje me nenin 20 të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, sipas të cilit “organet publike janë të detyruara të hartojnë dhe të publikojnë raporte vjetore për transparencën në	
--	--	--	---	--

			procesin e vendimmarrjes, ku përfshihet informacion për: a) numrin e akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit referues, të cilat publikohen dhe përditësohen periodikisht në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës (www.kultura.gov.al); b) numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara, të cilat administrohen dhe vlerësohen nga struktura përgjegjëse duke u pasqyruar në tabelën e njoftim konsultimit publik ; c) numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes; ç) numrin e takimeve publike të organizuara.” Duke analizuar të dhënat e këtij raporti vjetor, Ministria e Kulturës bën vlerësimin e efektivitetit të procedurës së konsultimit publik për projektaktet dhe nxjerr rekomandime për t’u zbatuar gjatë konsultimit të projektakteve në vijim.		
--	--	--	--	--	--

104	22.01.2019	Lidhur me projekt-vendimin për miratimin e rregullores për “Administrimin e zonës arkeologjike "A" dhe "B" të qytetit të Durrësit”, që është miratuar nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë, me vendimin nr.47 datë 08.03.2018, shoqëruar me hartën për zonat arkeologjike “A” dhe “B”, si edhe me koordinatat e qytetit të Durrësit, paraqitur nga ASHA dhe IMK, shtrojmë pyetjet: 1. Përse ishte i nevojshëm hartimi i rregullores së re për administrimin e zonës arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Durrësit? 2. A i ka burimet njerëzore të mjaftueshme dhe infrastrukturën e nevojshme DRKK Durrës, për zbatimin e rregullores së re?	29.01.2019 Në lidhje me pyetjen 1: Përse ishte i nevojshëm hartimi i rregullores së re për administrimin e zonës arkeologjike A dhe B të qytetit të Durrësit? Nevoja për një rregullore të re të administrimit të zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Durrësit, lindi për arsye: ☐ VKM Nr. 237 datë 23.03.2011 "Për administrimin e zonës arkeologjike "A" dhe "B" të qytetit të Durrësit", në veçanti për zonën arkeologjike “A”, nuk ishte koherente me zhvillimet e ndodhura përgjatë këtyre viteve, dhe kërkesave për rikualifikime urbane si dhe rikonstruksione të banesave ekzistuese që mund të rrezikohen nga faktorë të ndryshëm. ☐ Hyrja në fuqi e ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, bëri të nevojshëm harmonizimin dhe përshtatjen e VKM për zonat arkeologjike të Durrësit në të njëjtën frymë me ligjin e ri. ☐ Harta e zonifikimit e miratuar me VKM Nr. 237 datë 23.03.2011, përmbante disa pasaktësi të koordinatave në	Përfunduar. Kthyer përgjigje me e-mail dhe postë.	Nuk ka
-----	------------	---	--	--	---------------

		3. A do të ketë rritje të burimeve njerëzore të DRKK Durrës për zbatimin e rregullores së re? Nëse po, cilat do jenë ndryshimet? 4. Në çfarë faze është shqyrtimi i këtij projekt-vendimi dhe kur pritet të miratohet ai?	hapësirën pranë rrugës “Egnatia”, për të cilën janë bërë saktësime, duke bërë njësimin e kufijve të zonës “A” dhe “B” në këtë segment. Në lidhje me pyetjen 2 dhe 3: A i ka burimet njerëzore të mjaftueshme dhe infrastrukturën e nevojshme DRKK Durrës për zbatimin e rregullores së re? A do të ketë rritje të burimeve njerëzore të DRKK Durrës për zbatimin e rregullores së re? Nëse po cilat do të jenë ndryshimet? Plani për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e zonave arkeologjike ‘A’ dhe ‘B’ të qytetit të Durrësit përgjithësisht nuk parashikon detyrime të reja. Institucionet e ngarkuara me zbatimin e planit dhe detyrimeve që rrjedhin prej tij DRKK Durrës, Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, Instituti i Monumenteve të Kulturës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkinë Durrës. Deri më tani nuk është parashikuar rritje e burimeve njerëzore të DRKK Durrës.		
--	--	---	---	--	--

			Në lidhje me pyetjen 4: Në çfarë faze është shqyrtimi i këtij projekt-vendimi dhe kur pritet të miratohet ai? Projekt vendimi është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 26.12.2018 “Për miratimin e zonës arkeologjike "A" dhe "B" të qytetit të Durrësit dhe planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”, Fletore Zyrtare 192, datë 7 janar 2019.		
105	30.01.2019	Kërkesë për informacion dhe vënien në dispozicion të dokumentave mbi hetimin administrativ në institucionin e Cirkut Kombëtar.	08.02.2019 Kthim përgjigje: Ministria e Kulturës pasi shqyrtoi dosjen e çështjes ju sqaron si më poshtë: 1. Lidhur me pikën e parë të shkresës suaj, ju bëjmë me dije se nuk ka një akt delegimi pasi jemi në rastet e një hetimi administrativ, ku bazuar në ligjin nr. 90/2012 “Për organizmin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, Sekretari i Përgjithshëm ka të drejtë të ngrejë grupe pune dhe të mbikëqyrë veprimtarinë e	Përfunduar. Kthyer përgjigje me postë.	Nuk ka

			institucioneve në varësi. 2. Në lidhje me pikat 2 dhe 4 të shkresës suaj, ju vëmë në dispozicion materialet shkresore të kërkuara, konkretisht procesverbalin e datës 24.5.2017 dhe procesverbalin e datës 25.5.2017. 3. Në lidhje me pikën e tretë të shkresës suaj, ju bëjmë me dije se raporti i hetimit administrativ pasqyron vetëm situatën faktike bazuar në kërkesën me nr. 392 prot., datë 19.5.2017, për miratim udhëtimi, të revokuar me kërkesën nr. 396 prot., datë 22.5.2017, për mosaprovim udhëtimi, të drejtuar në Ministrinë e Kulturës, si dhe videon e publikuar në emisionin “STOP”. Gjithashtu, sqarojmë se jeni njoftuar për fillimin e hetimit administrativ me procesverbalin e datës 24.5.2017, ku ju keni qenë prezent dhe keni marrë dijeni.		
--	--	--	--	--	--

106	4.02.2019	Bazuar në Ligjin mbi të Drejten e Informimit kërkojmë nga ana juaj të na vihet ne dispozicion një informacion të detajuar mbi listën e investimeve dhe projekteve të kryera në sektorin e kulturës në territorin e Bashkisë Vlorë, Durrës dhe Kamëz gjatë vitit 2018 dhe listën e investimeve dhe projekteve në këto fusha të parashikuara në buxhetin tuaj të vitit 2019 për këto njësi vendore.	05.02.2019 Të interesuarit i është vendosur në dispozicion materiali i kërkuar.	Përfunduar. Kthyer përgjigje me e-mail	Nuk ka.
107	04.02.2019	Kërkesë për informacion në lidhje me : 1. A pati thirrje publike ku ftoheshin studio apo arkitektë të sillnin projekt-propozime për rikonstruksionin e teatrit Skampa?	06.02.2019 Delegim kerkese Bashkisë Elbasan.	Përfunduar. Kthim përgjigje dhe delegim kerkese, me postë.	Nuk ka

		2.Cilat ishin procedurat e përzgjedhjes së projektit fitues për rikonstrukcionin e Teatrit Skampa ? 3.Cilët ishin anëtarët e jurisë për përzgjedhjen e projektit fitues ?			
108	18.02.2019	Sa ka qenë buxheti total për Ministrinë e Kulturës në vitin 2017?	26.02.2019 Të interesuarit i është vendosur në dispozicion materiali i kërkuar	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail dhe postë	Nuk ka.
109	25.02.2019	1. Të gjitha vendimet e Këshillit Kombëtar të Restaurimeve në vitet 2013-2018, për objektet/ monumentet që i është hequr statusi “Monument Kulture”; 2. Të gjitha listat e objekteve/ monumenteve që i është hequr statusi “Monument Kulture”, pas miratimit nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në vitet 2013-2018; 3. Të gjitha propozimet e Drejtorive	Delegim kërkesë IMK	Përfunduar	Nuk ka.

		Rajonale të Kulturës Kombëtare për heqjen e statusit “Monument Kulture” të të gjitha objekteve/monumenteve të cilësuar si të tilla dhe që më pas janë miratuar në mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Restaurimeve në vitet 2013-2018; 4. Propozimet, kërkesat apo rekomandimet që kanë bashkëshoqëruar arsyetimet dhe listat për objektet/monumentet që i është hequr statusi “Monument Kulture” dhe që janë miratuar nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në vitet 2013-2018.			
110	25.02.2019	Lista e të gjithë punonjësve të Ministrisë që kanë kryer studime universitare apo pas universitare jashtë vendit, me postet e tyre dhe	18.03.2019 Të interesuarit i është vendosur në dispozicion informacioni me të dhënat e kërkuara.	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail.	Nuk ka.

		shtetet ku kanë kryer studimet.			
112	31.03.2019	Një kopje të plotë të listës së punonjësve /stafit të Ministria e Kulturës dhe të gjitha institucioneve nën varësinë Tuaj, duke përfshirë: emër, mbiemër, funksionin, adresë emaili dhe numër telefoni për përdorim zyrtar.	17.04.2019 Të interesuarit i është vendosur në dispozicion informacioni për Ministrinë e Kulturës dhe i është deleguar kërkesa institucioneve në vartësi.	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail.	Nuk ka.
113	3.04.2019	Informacion për kalatë me status “Monument Kulture”	26.04.2019 ➤ Informacioni mbi Kalatë me status “monument kulture”: Kalaja e Prezës shpallur monument kulture me: - Vendim të Institutit të Shkencave (botuar në Gazetën Zyrtare Nr. 95, datë 16.10.1948); - Vendim Nr. 6, datë 15.01.1963 të Rektoratit të Universitetit Shtetëror të Tiranës; - Shkresë të Ministrisë së	Përfunduar. Kthim përgjigje në portal	Nuk ka

			Arsimit dhe Kulturës Nr.1886 datë 10.06.1973. Kalaja e Ndroqit, shpallur monument kulture me: - Vendim të Institutit të Shkencave (botuar në Gazetën Zyrtare Nr. 95, datë 16.10.1948); - Vendim Nr. 6, datë 15.01.1963 të Rektoratit të Universitetit Shtetëror të Tiranës; - Shkresë të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës Nr.1886 datë 10.06.1973. Kalaja e Vaqarrit, shpallur monument kulture nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës me shkresë Nr.1886 datë 10.06.1973. Kalaja e Petrelës, shpallur monument kulture me: - Vendim të Institutit të Shkencave (botuar në Gazetën Zyrtare Nr. 95, datë 16.10.1948); - Vendim Nr. 6, datë 15.01.1963		
--	--	--	--	--	--

			të Rektoratit të Universitetit Shtetëror të Tiranës; - Shkresë të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës Nr.1886 datë 10.06.1973. Kalaja e Tujanit shpallur monument kulture me shkresë të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës Nr.1886 datë 10.06.1973. Kalaja e Ishmit shpallur monument kulture nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës me Urdhëresë datë 08.01.1977. Kalaja e Dajtit në Rrëzë të Malit të Dajtit shpallur monument kulture me: - Vendim të Rektoratit të Universitetit Shtetëror të Tiranës Nr. 6, datë 15.01.1963 - Shkresë të Ministrit të Arsimit dhe Kulturës Nr.1886 datë 10.06.1973. • Kalaja e Gracenit, shpallur		
--	--	--	---	--	--

			monument kulture me shkresë Nr.1886 datë 10.06.1973 të Ministrit të Arsimit dhe Kulturës. • Kalaja në qytetin e Tiranës është shpallur monument kulture me shkresë Nr.1886, datë 10.06.1973 të Ministrit të Arsimit dhe Kulturës. • Mozaiku i Tiranës është shpallur monument kulture me shkresë Nr.1886, datë 10.06.1973 të Ministrit të Arsimit dhe Kulturës. ➤ Objektet të cilat nuk gëzojnë statusin “monument kulture” janë si më poshtë: • Kalaja e Bovillës,		
--	--	--	--	--	--

			• Kalaja e Kuçit, Vorë, • Kalaja e Selbes, • Kalaja e Pëllumbasit, • Kalaja e Skuterrës, • Kalaja e Bastarit, • Kalaja e Shëngjinit, • Kalaja e Killojkës, • Kalaja e Vakumonës, 1. Ministria e Kulturës ka si mision ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë sonë kombëtare. Kalatë dhe të gjitha objektet të cilat janë me status mbrojtje “monument kulture” janë në mirëmbajtje të vazhdueshme nga struktura përgjegjëse që ka në administrim territorin ku ndodhen këto objekte, Drejtoritë Rajonale e Kulturës Kombëtare në rang vendi. Në realizimin e objektivave të saj ajo bashkëpunon me organet e qeverisjes vendore si dhe organizmat kombëtare dhe ndërkombëtare që		
--	--	--	--	--	--

			operojnë në fushën e trashëgiminë kulturore me qëllim ngritjen e fondeve dhe rijetëzimin e monumenteve. Njëkohësisht bashkëpunimi me institucionet e specializuara dhe ato shkencore në realizimin e objektivave të saj është një prej sfidave të Ministrisë së Kulturës në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së monumenteve. Në këtë kuadër sjellim në vëmendje se nuk është fusha e kompetencës së Ministrisë së Kulturës studimet arkeologjike por fushë e përgjegjësisë së Institutit të Arkeologjisë, institucion jo strukturë e Ministrisë së Kulturës.		
114	8.04.2019	Kërkesë për informacion lidhur me “Banesa e Fishtës”	25.04.2019 Në listën e monumenteve të Qarkut Lezhë ka dy objekte “Banesa e Gjergj Fishtës” të cilat gëzojnë statusin monument kulture, përkatësisht: 1. “Banesa e Gjergj Fishtës, Lezhë (ku ka	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail	Nuk ka

			lindur)", shpallur monument kulture për rëndësinë historike me Urdhëresë nr.4, datë 07.05.1991 të Komitetit për Kulturën dhe Artet, Drejtoria e Muzeve dhe Monumenteve; 2. "Banesa e Gjergj Fishtës", Fishtë, Blinisht, Lezhë, shpallur monument kulture Kategoria e II-të me Urdhër nr. 702 datë 05.06.2008 të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Njëkohësisht sjellim në vëmendje se këto objekte janë pjesë e itinerarit fishtian dhe janë në projekt konceptimi për realizimin e projekteve të dedikuara këtij itinerari me qëllim promovimin e vlerave të trashëgimisë sonë historike.		
115	15.04.2019	Kërkoj informacionin e mëposhtëm në lidhje me:	26.04.2019 1. A ka shifra se sa njerëz punojnë aktualisht në	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail	Nuk ka

		1. A ka shifra se sa njerëz punojnë aktualisht në profesione artizanale në Shqipëri? 2. Sa është numri i subjekteve që janë të regjistruar dhe që ushtrojnë aktivitetin e profesioneve artizanale? 3. A ofron shteti mundësi kursesh dhe trajnimesh në mënyrë që të mos zhduken këto profesione të vjetra(artizanale) ? 4. Cilat janë mënyrat që përdor shteti për të ndihmuar këta zejtarë (dhënia e kredive të buta,subvencione t,investimet, etj)? 5. Në çfarë formash bëhet bashkëpunimi mes bizneseve tradicionale dhe institucioneve shtetërore kur bëhet fjalë për promovimin e tyre?	profesione artizanale në Shqipëri? Institucioni që ka shifra të sakta për njerëzit që punojnë aktualisht në profesione artizanale në Shqipëri dhe për numrin e subjekteve që janë të regjistruar dhe që ushtrojnë aktivitetin e profesioneve artizanale është Dhoma Kombëtare e Zejtarisë. - Adresa: Blv “Bajram Curri”, Godina 2 Kate, brenda ambjenteve të Drejtorisë Rajonale të Arsimit dhe Formimit Profesional DRAFP, Nr.4, Tiranë, e-mail : info@biznesalbania.org.al 1. Sa është numri i subjekteve që janë të regjistruar dhe që ushtrojnë aktivitetin e profesioneve artizanale? Ashtu siç ju kemi sqaruar edhe në pikën 1 të kërkesës suaj, informacionin e kërkuar e disponon Dhoma Kombëtare e Zejtarisë, institucion jo në strukturën e Ministrisë së Kulturës. 2. A ofron shteti mundësi kursesh dhe trajnimesh në		
--	--	---	--	--	--

			mënyrë që të mos zhduken këto profesione të vjetra(artizanale)? Dhoma Kombëtare e Zejtarisë organizon trajnime, ëorkshope, etj në kuadër të programeve të ndryshme, në rang kombëtar dhe ndërkombëtar. Gjithashtu ka Shoqata apo Subjekte të liçensuara nga Shteti Shqiptar që kryejnë trajnime për zanatin e artizanit dhe zejeve. 3. Cilat janë mënyrat që përdor shteti për të ndihmuar këta zejtarë (dhënia e kredive të buta,subvencionet,investimet, etj)? 4. Në çfarë formash bëhet bashkëpunimi mes bizneseve tradicionale dhe institucioneve shtetëror kur bëhet fjalë për promovimin e tyre? Ministria e Kulturës në këtë drejtim ndihmon me :		
--	--	--	--	--	--

			-Vënien në dispozicion të ambienteve për zhvillim aktiviteteve. -Promovim në faqen zyrtare ëeb të Ministrisë së Kulturës, ëëë.kultura.gov.al -Mbështetje financiare të projekteve të paraqitura prej tyre, -Promovime në rrjetet sociale të veprimtarisë së tyre, -Promovim të punës së tyre në veprimtari jashtë vendit, -Hapjen e panairëve të ndryshme të zejtarisë, kulinarisë, etj, gjatë ditëve të organizimit të Festivaleve Folklorike të ndryshme në rang vendi.		
116	6.05.2019	1. Sa nëpunës civil janë të transferuar përkohësisht në institucionin tuaj dhe në institucionet e varësisë tuaj?(Numri total); 2. Identifikimi i nëpunësve civil me transferim të përkohshëm në institucionin tuaj dhe në institucionet e varësisë tuaj?(Emer_Mbi emer);	15.05.2019 1. Institucionet në varësi të Ministrisë së Kulturës nuk janë pjesë e shërbimit civil dhe si e tillë nuk janë objekt i kërkesës suaj. 2. Në aparatin e Ministrisë së Kulturës nuk kemi nëpunës civil të emëruar me procedura të transferimit të përkohshëm.	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail.	Nuk ka

		3.Pozicionet përkatëse të tyre; (të lartë drejtues; b) të mesëm drejtues; c) të ulët drejtues; ç) ekzekutiv) Numri total për secilën kategori në institucionin tuaj dhe në institucionet e varësisë tuaj; 4.Data e transferimit të nëpunësve civil me transferim të përkohshëm në institucionin tuaj dhe në institucionet e varësisë tuaj (data kur është transferuar nëpunësi civil) ; 5.Arsyet e emërimit të transferimit të përkohshëm të nëpunësit civil në institucionin tuaj dhe në institucionet e varësisë tuaj.			
117	6.05.2019	1. Kur është planifikuar të përfundojë shtrimi i kalldrëmeve në qafën e Pazarit në Gjirokastrë? 2. A do të jetë e mundur që shtrimi i kalldrëmeve të bëhet përpara	17.05.2019 Në projektin “Rehabilitimi i infrastrukturës dhe restaurimi i kalldrëmeve në pazarin e Gjirokastrës” i cili zbatohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Gjirokastrë është e	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail	Nuk ka.

		çeljes zyrtare të sezonit turistik ? 3. Cilat janë masat që ju si ministri keni marrë që Gjirokastra të jetë gati për pritjen e turistëve vendas dhe të huaj?	ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit të këtij projekti. Në informacionin e përcjellë nga ky institucion referuar grafikut të punimeve është parashikuar përfundimi i punimeve në fund të muajit Shtator 2019. Njëkohësisht lidhur me pyetjen nëse këto punime do të përfundojnë para çeljes zyrtare të sezonit turistik ju informojmë se sezonit turistik veror ka filluar në datën 1 Maj dhe përfundon në 15 Tetor 2019. Për sa më sipër, çdo fillim sezoni turistik veror Ministri Kulturës miraton udhëzimin lidhur me masat që institucionet e trashëgimisë kulturore, artit dhe kulturës duhet të marrim me qëllim mbarëvajtjen e aktiviteteve dhe vizitueshmërisë në këtë periudhë		
118	6.05.2019	1. Cili është plani i Ministrisë së Kulturës në lidhje me restaurimin dhe mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore në Zonën e	27.05.2019 <i>Cili është plani i Ministrisë së Kulturës në lidhje me restaurimin dhe mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore në Zonën</i>	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail	Nuk ka

		Zagorisë dhe Libohovës? 2. Sa objekte janë të evidentuara nga Ministria e Kulturës në këto zona të cilat kanë nevojë për ndërhyrje restauruese? 3. Sa prej tyre planifikohen që të restaurohen brenda këtij viti? 4. Sa është buxheti i planifikuar për trashëgiminë kulturore në këtë zonë?	<i>e Zagorisë dhe Libohovës?</i> Ministria e Kulturës ka në vëmendje mbrojtjen, restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore në të gjithë vendin po kështu dhe në zonën e Zagorisë dhe Libohovës. Gjatë vitit 2017-2018 ju bëjmë me dije se janë restauruar objektet me statusin trashëgimi kulturore si më poshtë: - Kisha e Shën Mërisë, Labovë e Kryqit, Njësia Administrative Qendër Libohovë; - Kisha e Shën Apostujve, Hoshtevë, Zagorie, - Ura e Nivanit mbi lumin e Zagorisë, afër manastirit të Nivanit. Janë të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Restaurimit projektet për objektet si më poshtë: - Shtëpia e Andon Zako Çajupit, Sheper, Zagorie; - Banesa e Avni Rustemit, Libohovë; - Kalaja e Libohovës; - Ura e Zonjës, Suhë, Njësia		
--	--	--	---	--	--

			Administrative Qendër Libohovë; - Kisha e Profet Ilisë, Stegopull, Njësia Administrative Qendër Libohovë; - Kisha e Shën Kollit, Saraqinisht, Lunxhëri, Libohovë. • <i>Sa objekte janë të evidentuara nga Ministria e Kulturës në këto zona të cilat kanë nevojë për ndërhyrje restauruese?</i> Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Gjirokastrë, institucion që mbikëqyr dhe monitoron gjendjen e objekteve monument kulture në të gjithë Qarkun e Gjirokastrës, ka evidentuar disa objekte problematike që kanë nevojë për ndërhyrje restauruese, si: - Ura e Zonjës në Labovë (Suhë), Bashkia Libohovë; - Kalaja e Labovës; - Kisha e Manastirit të Shën Kollit, me godinat në fshatin Nivan, (është restauruar vetëm Kisha);		
--	--	--	---	--	--

			- Kisha Paleokristiane e Manastirit në Nepravishtë, etj. Sa më sipër Instituti i Monumenteve të Kulturës për vitin 2019 do të hartojë projektin e restaurimi i objektit “Ura e Zonjës në Labovë (Suhë)”, Bashkia Libohovë. • <i>Sa prej tyre planifikohen që të restaurohen brenda këtij viti? Sa është buxheti i planifikuar për trashëgiminë kulturore në këtë zonë?</i> Gjatë vitit 2019 me fondet e buxhetit të shtetit alokuar DRKK Gjirokastër do të kryhet realizimi i projektit; - Shtëpia e Andon Zako Çajupit, Sheper, Zagori me fond 6,160,922 lekë. Njëkohësisht sjellim në vëmendje se Ministria e Kulturës nisur nga numri i konsiderueshëm i monumenteve të kulturës në të gjithë territorin e vendit të cilat kanë nevojë për financim e ka të pamundur të përballojë		
--	--	--	--	--	--

			me fondet e buxhetit te shtetit. Por në bashkëpunim me Fondin për Zhvillimin e Rajoneve, Fondin e Bashkive, si rasti i restaurimit të Kishës së Labovës së Kryqit; me fonde të komuniteteve fetare dhe të donatorëve të ndryshëm ajo realizon këtë proces me qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e pasurisë kombëtare.		
119	9.05.2019	1. Mënyra e financimit të Teatrit Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" 2. Buxheti për Teatrin Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" 3. Për çfarë shërbejnë paratë e grumbulluara nga shitja e biletave	15.05.2019 Kërkesa i ka kaluar TKEKS me e-mail dhe përgjigja i është kthyer nga ky institucion personit të interesuar.	Përfunduar.	Nuk ka
120	11.05.2019	Sipas VKM-së së Nr.68, datë 07.02.2018, "Për kufinj të dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagesës së përfituar në natyrë dhe që i	28.05.2019 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 68, datë 7.02.2018 "Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagesës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore", ka	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail	Nuk ka.

		shtohet pagës për pushimet vjetore” është parashikuar që punëdhënësi, ka detyrimin që ndaj punëmarrësve të tij të paguajë shpërblimin për ushqimin gjatë pushimit në ndërmarrje, nëse nuk mund t'i sigurojë lokal për ngrënie. Në këto kushte kërkojmë nga ana juaj, të na jepni informacion nëse institucioni juaj, gjatë veprimtarisë së tij të përditshme, i zbaton kushtet e parashikuara më lart, duke përmeshur detyrimet që lindin ndaj punëmarrësve.	dalë në bazë e për zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, konkretisht nenit 94 dhe 118 të tij. Pika 2 e nenit 118 citon se: <i>“Përveç pagës në vlerë, punëmarrësi mund të përfitojë pagë në natyrë, për strehimin dhe ushqimin që konsumohet gjatë pushimit në ndërmarrje nga punëmarrësi. Për pagën në natyrë merren vesh vetëm me shkrim dhe brenda kufijve të caktuar me vendim të Këshillit të Ministrave”</i>. Pra ky vendim zbatohet për marrëdhëniet e punës që rregullohen nga Kodi i Punës, që janë ndërmarrjet/institucione t private në cilësinë e punëdhënësit. Marrëdhëniet e punës në administratën shtetërore rregullohen sipas ligjit nr. 152/2013 <i>“Për nëpunësin civil”</i>, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij, ku konkretisht vendimi nr. 511, datë 24.10.2002 <i>“Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”</i>, i ndryshuar, nuk parashikon pushim dreke ose pagesë ekuivalente në natyrë,	
--	--	---	--	--

			për punonjësit në institucionet shtetërore.		
121	17.06.2019	Kërkesë për informacion në lidhje me thirrjen e hapur për propozime, nën programin “Creative Europe (2014-2020)”, me titull “Bridging culture and audiovisual content through digital”, thirrje në të cilën CBS mendon të aplikojë, si më poshtë: 1. Sipas udhëzimeve të kësaj thirrjeje, konsorciumi mund të përbehet nga të paktën 3 partnerë në 3 vende që janë pjesëmarrëse në programin Creative Europe. Cili është numri maksimal i partnerëve që mund të përfshihen në një partneritet? 2. Në sa shtete mund të shtrihet ndërhyrja (veprimi/projekti i propozuar): në çdonjërin prej	28.06.2019 Të interesuarit i është dhënë informacioni i kërkuar.	Përfunduar. Kthim përgjigje me postë.	Nuk ka

		vendeve të partnereve pjesëmarrës në aplikim, apo mund të jetë edhe për një vend të vetëm? 3. Sipas udhëzimeve, kontributi financiar i kërkuar nuk duhet të tejkalojë masën 60% të kostove totale të projektit. Çfarë kupton kjo, që pjesa tjetër prej 40% e kostove të projektit duhet të mbulohet nga vetë partnerët, apo në ndonjë formë tjetër?			
122	22.07.2019	Kërkesë për Informacion: 1. Ankesat e shumta të adresuara në MK nga artistë të Cirkut Kombëtar 2. Dokumentacion për inspektimin e kryer nga MK për Cirkun Kombëtar 3. Arsyet e anulimit të konkursit, datë 23/03/2019 4. Procedura e konkurimit për komisionin e	02.08.2019 Personit të interesuar i janë vendosur në dispozicion dokumentacioni i kërkuar.	Përfunduar. Kthim përgjigje me postë.	Nuk ka

		ri të kërkuar pranë MK nga drejtori I Cirkut 5. Një kopje të borderove të Cirkut Kombëtar, për periudhën 2016-2019.			
123	12.08.2019	Bazuar në Ligjin për Trashëgiminë Kulturore, nr. 9048 datë 07.04.2003, ligjin nr. 27/2018 PËR TRASHËGIMINË KULTURORE DHE MUZETË dhe “Manualin e procedurave” të ministrisë së Kulturës, lidhur me urdhërat që ka lëshuar ministri i kulturës në vitet 2010 – korrik 2019, “PËR SHFUQIZIMIN E URDHRAVE “PËR SHPALLJE MONUMENT KULTURE TË KATEGORISË SË I-të dhe II-të”, pra heqja e statusit Monument Kulture për objekte të shpallura Monumente	13.09.2019 Gjatë periudhës 2010 – korrik 2019, ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore ka miratuar shfuqizimin e urdhrave “Për shpallje monument kulture të kategorisë I-rë dhe II-të” dhe deklarin e mungesës së interesit kulturor bazuar në ligjin nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” dhe ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”. Këto urdhra janë miratuar në vijim të procesit të vlerësimit të gjendjes së monumenteve të kulturës në të gjithë territorin e Shqipërisë. Ky proces u ndërmor në vitin 2014 nga Ministria e Kulturës dhe institucionet e saj të specializuar të varësisë. Procesi përfshiu një sërë etapash të rëndësishme si: diagnostikimi i detajuar i gjendjes së monumenteve,	Përfunduar. Kthim përgjigje me postë.	Nuk ka.

		Kulture, të ardhura si; Kërkesa të individit/ institucionit/ subjektit të interesuar (shtetëror dhe privat) të paraqitur në MK, ku nga kjo e fundit përcillet për mendim pranë DRKK përgjegjëse dhe IMK. DRKK dhe IMK përgatisin relacionin përkatës në mbështetje ose jo të kërkesës së paraqitur. Në rast se relacioni argumentues shprehet në mbështetje të heqjes së statusit monument kulture të një objekti të veçantë, ky i fundit përcillet për shqyrtim pranë Këshillit Shkencor të IMK dhe më pas në KKR. Pas shqyrtimit dhe miratimit në KKR të propozimit, hartohet urdhëri për heqjen e statusit monument	përgatitja e listës së riskut, rishikimi i listës së monumenteve dhe përditësimi i bazës së të dhënave të Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore. Në përmbyllje të këtij procesi ndër të tjera rezultuan: 106 monumente që nuk ekzistojnë, 52 objekte plotësisht të shkatërruara, 219 objekte në rrezik qëndrueshmërie, 80 objekte të tjetërsuara dhe 198 objekte pa kartelë. Pjesë e procesit të vlerësimi është edhe identifikimi i interesit kulturor dhe propozimi për shpallje të reja bazuar në studimet dhe propozimet e institucioneve të specializuara. Në këtë kuadër gjatë viteve 2014-2019 janë studiuar, vlerësuar dhe shpallur 15 qendra historike dhe ansamble historik urban, 845 monumente kulture të kategorisë I-rë dhe II-të, dhe 102 zona të mbrojtura të monumenteve të kulturës.		
--	--	---	--	--	--

		kulture të objektit. Urdhëri i miratuar i përcillet institucioneve në varësi sipas rastit dhe subjekteve/institucioneve të interesuara. Bazuar në sa shpjeguar, kërkohet nga ministria e Kulturës të na vendosni në dispozicion dokumentet publike: 1. Urdhërat që ka lëshuar ministri i kulturës në vitet 2010 – korrik 2019, “PËR SHFUQIZIMIN E URDHRAVE “PËR SHPALLJE MONUMENT KUTURE TË KATEGORISË SË I dhe II”, pra heqja e statusit Monument Kulture për objekte të shpallura më herët Monumente Kulture; 2. Kërkesat e individëve/institucionere/subjekteve të interesuar (shtetëror dhe			
--	--	--	--	--	--

		privat) në vitet 2010 – korrik 2019, të paraqitur në MK, ku nga kjo e fundit përcillet për mendim pranë DRKK përgjegjëse dhe IMK. Pavarësisht nëse ato janë miratuar apo jo, na i vendosni në dispozicion. 3. Saktësoni cilat prej tyre janë miratuar dhe cilat jo.			
124	15.08.2019	1. Në kuadër të një punimi shkencor, ju lutem mund të më ndihmoni duke më bashkangjitur programet vjetore të aktiviteve të Ministrisë së Kulturës nga 1990-2017 2. Mund të më rendisni projektet e ndërmarra, iniciuar nga Ministria e Kulturës (1990-2017) lidhur me reflektimin, njohjen e së shkuarës komuniste në Shqipëri ?	13.09.2019 Personit të interesuar i janë dhënë informacionet e kërkuara për vitet 2004-2019. Pjesa tjetër e informacionit gjendet ne Arkivin e Shtetit.	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail.	Nuk ka.

125	29.08.2019	1-Sa turistë kanë vizituar Syrin e Kaltër dhe Malin e Tomorrit gjatë vitit 2019? 2- Përse shpenzohet taksa që paguajnë turistët në hyrje të Syrit të Kaltrës?	29.08.2019 Personit i është bërë me dije se MK nuk është institucioni përgjegjës për shifrat e turizmit, por për vizitorët në objektet e trashëgimisë kulturore, si kala, parqe, muze, etj. Informacionin duhet ta kërkojë në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.	Përfunduar. Kthyer përgjigje me e-mail	Nuk ka
126	30.08.2019	1- Sa projekte ka pasur nga Ministria e Kulturës për rehabilitimin e “Piramidës” që nga viti 2005 deri në gusht të 2019-s? 2- Kërkoj të më vihen në dispozicion të gjitha projektet që janë bërë për rehabilitimin e “Piramidës” ? 3- A janë zbatuar këto projekte ? Nëse, po, sa ka qënë kostoja totale ose sa kanë kushtuar këto projekte? 4- Nëse jo, cilat kanë qënë shkaqet që këto projekte nuk janë zbatuar? 5- A ka aktualisht një projekt për rehabilitimin e “Piramidës”? Nëse po, sa do	18.09.2019 Qendra Ndërkombëtare e Kulturës “Arbnori”-Piramida, për periudhën 2005- gusht 2019, ka kaluar në proces rikonstruksioni, konkretisht: Pas daljes së VKM nr. 730, datë 18.10.2006, për rehabilitimin e Piramidës, (Qendra Ndërkombëtare e Kulturës “Arbnori”), mes Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Shoqërisë “ORION S.A, “GREQI, “A.K”, Sh.P.K & “ARTI” Sh.P.K, është lidhur kontrata me nr. 1371, datë 21.02.2008 me objekt rikonstruksionin e godinës së Piramidës, në vlerën totale prej 637.634.001 lekë (me TVSH). Kontrata është zbatuar pjesërisht në vlerën prej 229.983.692 lekë(me TVSH), pasi me daljen	Përfunduar. Kthyer përgjigje me postë	Nuk ka

		kushtojë rehabilitimi i kësaj ndërtesë? Kur pritet të fillojnë punimet? Kur do mbarojnë punimet për rehabilitimin e “Piramidës”? Kërkoj një fotokopje të projektit që pritet të vihet në zbatim?	e VKM nr.66, datë 21.10.2010 “Për Ndërtimin e Kompleksit të ri Parlamentar”, punimet në këtë godinë u ndërprenë në vitin 2010. Për sa i përket kërkesës se nëse aktualisht ka një projekt për rehabilitimin e “Piramidës”, ju bëjmë me dije se bazuar në VKM nr.847, datë 07.12.2016, Qendra Ndërkombëtare e Kulturës “Arbnori”, ka kaluar në pronësi të Bashkisë Tiranë dhe Ministria e Kulturës nuk e disponon një informacion të tillë. Për informacion më të plotë rreth kërkesës suaj, lutemi ti drejtoheni Bashkisë Tiranë.		
127	11.09.2019	Kërkesë për dhënie informacioni për listën emërore dhe funksionin përkatës, të zyrtarëve të larguar nga Ministria e Kulturës dhe institucionet e varësisë direkte gjatë 2015-2019 në kuadër të zbatimit të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të			

		personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.			
128	09.09.2019	• Sa herë ka lëvizur në udhëtime zyrtare jashtë shtetit titullari i ministrisë në periudhën janar 2018- qershor 2019 dhe në cilat destinacione? • Sa udhëtime ka kryer me avion dhe në çfarë klasi? • Sa kanë qenë kostot e secilit prej udhëtimeve (bileta, akomodimi, dietat etj)? • Sa ka qenë gjatë kësaj periudhe zëri në buxhet për udhëtimet jashtë vendit?	13.09.2019 Vizitat zyrtare të Ministrit të Kulturës organizohen në përputhje me dispozitat e parashikuara në VKM nr.870, datë 14.02.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” dhe Udhëzimin nr. 22, datë 10.07.2013 e Ministrit të Financave. - Për periudhën janar 2018 – qershor 2019, Titullari i Ministrisë së Kulturës ka kryer 11 udhëtime jashtë vendit, ndër të cilat 5 prej tyre janë kryer me avion (klasi ekonomik) dhe 6 të tjera me automjet. - Kostoja totale e shpenzimeve të këtyre udhëtimeve për Titullarin ka qenë në vlerën prej 1,132,074.5 lek. - Udhëtimet janë kryer në destinacionet : Kosovë, Itali, Gjermani, Mali i Zi, Francë, Armeni.	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail	Nuk ka

			Theksojmë se në vlerën e sipërcituar përfshihen shpenzimet totale për biletat e udhëtimit, akomodimi, dietat e Titullarit, etj. Shpenzimet e mësipërme zënë 18.7 % të fondit të parashikuar për udhëtime dhe dieta jashtë vendit (<i>nen-zeri i parashikuar ne kodin 602 te shpenzimeve operative</i>) për aparatin e Ministrisë së Kulturës për vitin 2018 dhe 0.11 % të fondit të parashikuar për udhëtime dhe dieta jashtë vendit (<i>nen-zeri i parashikuar ne kodin 602 te shpenzimeve operative</i>) për aparatin e Ministrisë së Kulturës për vitin 2019, dhe janë realizuar në përputhje me procedurat ligjore dhe financiare referuar sa më sipër. Informacioni përcillet në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit “Për të drejtën e informimit”, për rrjedhojë shpresojmë dhe besojmë se të dhënat e përftuara prej tij do të përdoren me		
--	--	--	---	--	--

			qëllim të transparencës ndaj interesit publik.		
129	13.09.2019	Kërkoj informacion se kur do të hapet thirrjen për projekt-propozime për promovimin e kulturës, specifikisht për minoritetet Rome dhe Egjiptiane, kjo në kuadër të ligjit për Pakicat Kombëtare	17.09.2019 Thirrja për projekt-propozimet për projektet në art-kulturë-trashëgimi kulturore hapet në muajin dhjetor 2019 dhe mbyllet rreth datës 15 janar 2020. Në këtë thirrje përfshihen dha trajtohen edhe projektet e pakicave kombëtare, ku bëjnë pjesë edhe pakicat Rome dhe Egjiptiane. VKM nr.462, dt.3.7.2019, “Për miratimin e masave dhe të politikave të nevojshme për të siguruar pjesëmarrjen e personave, që u përkasin pakicave kombëtare, në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike në Republikën e Shqipërisë”, mbështetur në Ligjin nr.96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, në numrin 7 shprehet “ <u>Nga numri i përgjithshëm i projekteve që do të financohen, 5 (pesë) për</u>	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail.	Nuk ka.

			<u>qind e tyre të mbështeten me burime financiare, logjistike dhe/ose materiale për shoqatat kulturore/individët, të cilët kanë aplikuar dhe që u përkasin pakicave kombëtare”.</u>		
130	25.09.2019	Kërkesë për informacion në lidhje me: 1-Numrin e personave të punësuar pranë ministrisë tuaj dhe institucioneve të varësisë për vitet 2018 dhe 2019 2-Numrin e personave me aftësi të kufizuar të punësuar pranë ministrisë tuaj dhe institucioneve të varësisë për vitet 2018 dhe 2019. Ju lutem të specifikoni llojin e aftësisë së kufizuar.	7.10.2019 Për pikën 1 të kërkesës personit të interesuar i është dhënë informacioni i kërkuar. Për pikën 2: Nga informacionet e ardhura nga institucionet e varësisë rezulton që nuk ka të punësuar persona me aftësi të kufizuar.	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail	Nuk ka
131	11.11.2019	Bazuar në ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit” lutemi na vini në dispozicion të dhëna konkrete për statusin aktual (10.11.2019) të	20.11.2019 Për Ministrinë e Kulturës, për vitin 2019, është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.764, datë 27.12.2018, Plani Analitik i Projektakteve ku janë parashikuar për t’u miratuar 57	Përfunduar. Kthim përgjigje në portalin Pyetshtetin.al	Nuk ka.

		secilit prej akteve të parashikuara për hartim / propozim / miratim nga MK në përputhje me Programin e Përgjithshëm Analitik i Projekt-akteve për vitin 2019, katërmujori I, II dhe III.	projektakte, nga ku 47 janë aktet nënligjore në zbatim të ligjit 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”. Projektaktet paraqiten të ndarë në tre katërmujorë, ku deri më tani Realizimi i Planit Analitik të Projektakteve për vitin 2019 për Ministrinë e Kulturës është si vijon: 1. Vendimi nr. 788, datë 26.12.2018 i Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, kompetencat, mënyrën e funksionimit dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Muzeve”. 2. Vendimin nr. 24, datë 16.1.2019 i Këshillit të Ministrave. “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit. 3. Vendimin nr. 209 datë 10.4.2019 “Për miratimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale dhe përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të tij” 4. Vendimi nr. 208 datë 10.4.2019 “Për miratimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”		
--	--	---	--	--	--

			5. Vendimin nr. 24, datë 16.1.2019 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin në detyrë të kryetarit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë” 6. Vendimi nr. 279 date 2.5.2019 “Për përbërjen, kompetencat, mënyrën e funksionimit dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore 7. Vendimi nr.126, datë 13.03.2019 “Për mbylljen e ndërmarrjes shtetërore Qendra Ndërkombëtare e Kulturës “Arbnori” 8. VKM nr. 352 datë 04.04.2019 “Për ngritjen dhe funksionimin e komisionit për vlerësimin dhe neocimin e kontratës më objekt me realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar, përcaktimin e kriterëve kualifikuese dhe vlerësuese për përzgjedhjen e palës private për realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar si dhe hartimin e kontratës për realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar duke përfshirë dhe		
--	--	--	--	--	--

			projektimin, ndërtimin dhe dorëzimin e Tetarit Kombëtar”, bashkpropozimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. 9. VKM nr. 364, datë 29.05.201 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”. 10. VKM nr. 463, datë 03.07.2019 "Për përcaktimin e drejtimeve për miratimin e strategjive, programeve dhe planeve të veprimit për promovimin dhe krijimin e kushteve të nevojshme, për personat që u përkasin pakicave kombëtare për të përdorur dhe zhvilluar elementët themelore të identitetit të pakicave kombëtare, duke përfshirë dhe gjuhën e tyre" 11. VKM nr. 462, datë 03.07.2019 "Për miratimin e masave dhe politikave të nevojshme për të siguruar pjesëmarrjen e personave që u përkasin pakicave kombëtare në jetën publike, 12. VKM nr. 432 date 26.06.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së		
--	--	--	--	--	--

			Instituti Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore” 13. VKM nr.433 datë 26.06.2019 Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale" 14. VKM nr. 581 date 28.08.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Berat 15. VKM nr. 581 date 28.08.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Tirane 16. VKM nr. 581 date 28.08.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Vlorë 17. VKM nr. 581 date 28.08.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë 18. VKM nr. 581 date 28.08.2019 “Për		
--	--	--	--	--	--

			funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër 19. VKM nr. 581 date 28.08.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Korçë 20. VKM nr.434 datë 26.06.2019 “Per krijimin dhe organizimin e Veprimtarise se Muzeut Kombetar “Shtepia me Gjethe” 21. VKM nr.567 datë 31.07.2019” Për emërimin në detyrë të drejtorit të Bibliotekës Kombëtare” 22.VKM nr. 625 dt.04.09.2019 “Për miratimin e rregullave të administrimit të pasurive kulturore dhe funksionimin e subjekteve juridike me qëllim vlerësimin dhe rijetëzimin e pasurive kulturore”. Ndërkohë theksojmë se Ministria e Kulturës është në proces bashkërendimi edhe me projektaktet e tjera të parashikuara në Planin Analitik të Projektakteve për vitin 2019.		
--	--	--	--	--	--

132	20.01.2020	Në bazë të drejtës së informimit, kërkoj të pajisem me informacionin e mëposhtëm: 1. Emër, mbiemër, numër kontakti dhe adresë e-maili për rolin e Koordinatorit Për të Drejtën e Informimit në Autoritetin Tuaj Publik? 2. Një kopje të plote, të përditësuar, të organikës së Autoritetit Tuaj Publik duke përfshirë: emrin, mbiemrin, funksionin, adresën e postës elektronike (email) dhe numrin e telefonit për përdorim zyrtar. P a g e 2 Në lidhje me mënjanimin e konfliktit të interesit: 3. Kopje të procedurës / udhëzimit për deklarimin e ‘konfliktit të	31.01.2020 Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 20.01.2020 “<i>Kërkesë për informacion Autoritetit Tuaj Publik</i>” Bazuar në nenin 3 të ligjit nr. 119/2014 “<i>Për të drejtën e informimit</i>”, Ministria e Kulturës shprehet sa më poshtë vijon: Pika 1 Irena Prici, Koordinatore për të Drejtën e Informimit e-mail irena.prici@kultura.gov.al Pika 2 Bashkëlidhur do të gjeni në formë tabelare organikën e përditësuar të Ministrisë së Kulturës, përfshirë: emër, mbiemër, funksionin, adresën elektronike. Nr. Tel për përdorim zyrtar do ta gjeni në faqen ëeb të Ministrisë së Kulturës në adresën https://kultura.gov.al/kontakt/ Pika 3 • Pranë Ministrisë së Kulturës, është krijuar Autoriteti Përgjegjës, i cili funksionon në bazë të Ligjit nr. 9049,	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail.	Nuk ka

	interesit' nga e gjithë organika e përmendur në piken 2. 4. A ekzistojnë lidhje familjare mes punonjësve të organikës në Autoritetin Tuaj Publik ? Nëse po, a janë deklaruar keto lidhje në regjistrin e posaçëm për deklarimin e konfliktit të interesit në Autoritetin Tuaj Publik dhe cilat janë ato, për secilin prej tyre? Në lidhje me procesin e vlerësimit të figurës së stafit të organikës Tuaj: Personat e Zhdukur dhe Krimet Kunder Njerezimit: Në Shqipëri, rezultojnë te pakten mbi 5157 persona (lista e bashkelidhur) pjesa me e madhe e te cileve janë zhdukur gjate viteve te rregjimit te diktatures. Zhdukja e Personit	datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nënpunësve publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave” i ndryshuar si dhe të udhëzimit “Për Rolin e Autoriteteve Përgjegjëse në Parandalimin dhe Kontrollin e Konfliktit të Interesave”, • Pas përditësimit të rregullores “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, nëpërmjet e-mailit zyrtar që do ta gjeni bashkëlidhur, u bënë me dije të gjithë punonjësit e Ministrisë së Kulturës, me të drejtat dhe detyrimet që kanë në zbatim të këtij ligji. • Çdo zyrtar i emëruar në detyrë, plotëson autorizimin në zbatim të nenit 10 të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 i		
--	--	---	--	--

		konsiderohet si Krim Kunder Njerezimit, veper penale e parashikuar në Nenin 74 të Kodit Penal, veper e cila nuk parashkruhet: Neni 74 Krime kundër njerëzimit “Vrasjet, zhdukja me forcë, shfarosjet, kthimi në skllëvër, internimet dhe dëbimet, si dhe çdo lloj torture ose dhune tjetër njerëzore, të kryera, sipas një plani konkret të paramenduar, ose në mënyrë sistematike, kundër një grupi të popullsisë civile, për motive politike, ideologjike, raciale, etnike e fetare dënohen jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm”. 5. A është dërguar lista e organikes se autoriteti tuaj publik tek AIDSSH (Autoriteti i	ndryshuar. Autorizimi sipas formatit të miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm. Pika 4 Nuk kemi patur raste të deklaramit apo të raportuara mbi ekzi stencën e lidhjeve familjare mes punonjësve të organikës së Ministrisë së Kulturës. Pika 5 Në bazë të nenit 9 të ligjit nr. 45/2015 “<i>Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë</i>” personat e interesuar paraqesin kërkesë pranë Autoritetit për t’u informuar për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. <u>Bashkëlidhur do të gjeni:</u> • Tabela me organikën e Ministrisë së Kulturës. • E-mailin zyrtar që vërteton njohjen e punonjësve me rregulloren “<i>Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike</i>”.		
--	--	---	---	--	--

		Dosjeve) per vleresimin e figures në perputhje me Ligjin Nr. 45/2015 Per te Drejten e Informimit Per Dokumentet e ish Sigurimit te Shtetit te ish RPSSHse? 6. Nese po, cili ka qene rezultati i ketij vleresimi per organiken e Autoritetit Tuaj Publik dhe sa prej tyre kane rezultuar se gjate periudhes 29 Nëntor 1944 - 2 Korrik 1991 te kene qene: 1) Anëtar ose kandidat i Byrosë Politike, 2) anëtar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, 3) anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, 4) kryetar i Gjykatës së Lartë, 5) Prokuror i Përgjithshëm, 6) Kryetar i Hetuesisë së Përgjithshme, 7) anëtar i Këshillit të Ministrave, 8)	• Formatin e Autorizimit të miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm.		
--	--	---	---	--	--

		kryetar i degëve të punëve të brendshme, P a g e 3 9) punonjës i organeve të ish-Sigurimit të Shtetit, 10) bashkë - punëtor i ish-Sigurimit të Shtetit apo i favorizuar, 11) anëtar i Komisionit Qendror të Dëbim-Internimeve, 12) hetues, 13) prokuror, 14) gjyqtar në procese politike, 15) denoncues apo dëshmitar i akuzës në proceset politike, të posaçme; 7. Nese jo, cila eshte arsyeja e mos kerkimit te ketij vleresimi nga AIDSSH, ne perputhje me ligjin e sipercituar ?			
133	17.02.2020	Bazuar në ligjin “për të drejtën e informimit”, lutemi na vini në dispozicion të dhënat e punonjësve aktual në organikën e Ministrisë, të shoqëruar me	25.02.2020 ISP i është dhënë informacioni i kërkuar	Kthim përgjigje në portal	Nuk ka.

		statutin që kanë në raport me ligjin mbi nëpunësin civil. si dhe kohën e emërimit të tyre në funksionin që mbajnë.			
134		31/03/2020 Kërkesë për informacion për vënien në dispozicion të Urdhrit të Ministrit të Kulturës nr. 715, datë 10.12.2019. Për sa më sipër në cilësinë e koordinatorës për të drejtën e informimit, do të kërkoja ndihmën tuaj që: 1. Të më informoni nëse është botuar ky akt ? (nëse po, ku ? Nëse jo, pse ?)	07/04.2020 Referuar kërkesës suaj për informacion, bashkëlidhur do të gjeni Urdhrin e Ministrit të Kulturës Nr.715 datë 10.12.2019 për miratimin e formatit, çmimit, kategorisë së biletave në muze dhe sitet e trashëgimisë kulturore në varësi të MK. Institucionet shtetërore kanë detyrimin për publikim në Qendrën e Botimeve Zyrtare për Udhëzimet e Ministrit dhe Urdhrat e delegimit. Rasti në fjalë nuk përfshihet. Të gjitha institucionet e varësisë, referuar Urdhrit të sipërcituar, afishojnë listën e çmimeve të reja në një vend të dukshëm për cilindo që kërkon të vizitojë Sitin, monumentin, muzeun.	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail.	Nuk ka
135	26.05.2020	Kërkesë për informacion si më poshtë: •Kopje të relacionit dhe propozimin e Ministres së			

		Kulturës lidhur me vendimin nr. 325, 12.04.2017 “Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Tiranës dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj dhe zonës përreth” ; •Cilat janë kriteret mbi të cilën është bazuar përcaktimi/zoni mi i zonës historike të qytetit? Ju lutem na vini në dispozicion kopje të dokumenteve si më poshtë: raporte ekspertesh, raporte institucionesh, konsultime publike, dhënie mendimi nga ekspertë të tjerë etj; •Cilat janë vendimet që ka mbledhur Ministria e Kulturës për propozimin e këtij vendimi? Ju lutem na vini në dispozicion një kopje të dokumenteve të kërkuara;			
--	--	--	--	--	--

		•Ju lutem na vini në dispozicion kopje të propozimit të Ministres së Kulturës dhe dokumentat mbështetëse lidhur me VKM nr. 377, dt. 08.05.2020 “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë Nr. 1/241, me emërtimin “Teatri Kombëtar”, në zonën kadastrale 8150, Tiranë”.			
136	27.05.2020	Do vlerësonim ndihmesën tuaj në lidhje me kërkesën e mëposhtme si bashkepronar i pasurisë Nr 4/384 vol 10 faqe 195 ZK 8631 me sipërfaqe pyll ne pronësi të bashkëpronareve Resuli, ne Lagjen Spitali, Lezhë: 1.Eshtë aktualisht Ministria e Kulturës institucioni përgjegjës për administrimin e kësaj pasurie meqë ndodhet			

		pjesërisht në zonat arkeologjike A dhe B? 2. Nese po, a disponon Ministria e Kulturës një listë të ndërtimeve pa leje/jashtligjshme në këtë pasuri të cdo periudhe kohore? Nëse po, do vleresonim nëse mund te na e vinit në dispozicion një kopje. Nëse jo, mund të na sugjeroni ku mund ta gjejmë (IKMT dhe as IMT Lezhë nuk po na japin përgjigje të saktë). 3. Vazhdon te jete i zbatueshem per Institucionin tuaj te nderuar VKM Nr 728, dt 1.9.2010, Nese po, a ka akte nënligjore, urdheresa ne zbatim te tij te dala me vone, cka do tju ishim mirenjohes nese do na i benit te dituraë			
--	--	--	--	--	--

		4. Do vleresonim mendimin tuaj nese ligji i miratuar rishtazi 20/20 (i Marsit 2020) per legalizimet, do jete ne gjendje te ndale legalizimin e objekteve pa leje/jashtligjshme ne zonen e pasurise ne fjale meqe shohim perpjekje per legalizim te tyre, objekte qe nga banimi jane kthyer ne objekte per biznes si magazina materiale ndertimi e dyqane (cka shihet edhe nga aplikacionet ne internet googlemap, etj). Bashkia Lezhe na u pergjigj zyrtarisht qe nuk eshte tagri i saj Legalizimi por i ASHK (Lezhe).			
137	2.06.2020	kërkesë për informacion, mbi: 1. Ju lutem me dërgoni regjistrin e botuesve të licensuar/			

		regjistruar në Shqipëri. 2. Ju lutem me dërgoni kriteret/ kushtet për regjistrimin/ licensimin e botuesve. 3. Ju lutem me dërgoni rregulloren e funksionimit të KËSHILLIT KOMBËTAR TË LIBRIT DHE I NXITJES SË LEXIMIT. 4. Ju lutem me informoni mbi mënyrën e përzgjedhjes së librave që financohen përmes fondit kombëtar të librit. 5. Ju lutem më dërgoni listën e librave të përzgjedhur gjatë tre viteve të fundit (2017, 2018, 2019) për tu financuar përmes fondit kombëtar të librit.			
138	9.06.2020	•Me cilin akt është hequr statusi i Teatrit Kombëtar si "monument kulture"? •Kopje të aktit për heqjen e			

		statusit të Teatrit Kombëtar si "monument kulture"; kopje të relacionit shoqërues të tij dhe procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Shkencor dhe Këshillit Kombëtar të Restaurimit, që kanë rekomanduar heqjen e statusit monument kulture të Teatrit Kombëtar.			
139	21.07.2020	Kërkesë për informacion në lidhje me: 1.Në cilën fazë janë punimet Amfiteatrin e Durrësit? 2.Sa është buxheti që do të akordojë qeveria shqiptare dhe sa është vlera e projektit për Amfiteatrin e Durrësit ?	30.07.2020 Referuar pyetjes së parë se në cilën fazë janë punimet Amfiteatrin e Durrësit, nga informacionet e përcjella nga institucionet e varësisë aktualisht në këtë objekt nuk po kryhen ndërhyrje. Referuar pyetjes së dytë mbi buxhetin që do të akordojë qeveria shqiptare dhe vlerën e projektit për Amfiteatrin e Durrësit, sqarojmë se në zbatim të VKM Nr. 213, date 11.03.2020 "Për caktimin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore si njësi zbatuese, dhe	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail	Nuk ka

			për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e restaurimit/rindërtimit të pasurive kulturore” është akorduar një fond total prej 197,500,584 lekë pa TVSH për hartimin e projekteve të detyruara për restaurimin / rindërtimin e pasurive kulturore, në të cilën përfshihet dhe objekti "Amfiteatri i Durrësit". Aktualisht IKTK, si njësi zbatuese është në fazën e hartimit të termave të referencës për procedurat e konkurimit të hartimin e projekteve të detyruara. Në këto kushte deri më tani nuk disponohet një vlerë e përcaktuar për projektin e Amfiteatrit të Durrësit		
140	30.07.2020	Kërkesë për informacion	13.08.2020 Cili është personi përgjegjës në institucion për njoftimin e fillimit të procesit të konsultimit dhe përveç Regjistrit Elektronik, cilat janë mënyrat e njoftimit të procesit të konsultimitë Personi përgjegjës për njoftimin e fillimit të	Përfunduar. Kthim përgjigje në portal	Nuk ka

			procesit të konsultimit ndryshon në varësi të çështjes që do të shtrohet për konsultimit. Zakonisht caktohet dikush nga drejtoritë e përmbajtjes, që lidhet drejtpërdrejt me çështjen objekt konsultimi. Përveç Regjistrat Elektronik, që menaxhohet nga 1 specialist i Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit, përdoret edhe njoftimi, nëpërmjet emailit, i grupeve të interesit për çështjen përkatëse. A keni përdorur gjatë vitit të kaluar, ose më herët njoftimin paraprak të konsultimit publik, sipas nenit 12 të ligjit 146/2014, dhe rregullisht, në cilën fazë të hartimit të projektaktit bëhet njoftimi i konsultimit publikë Njoftimi për konsultimin publik është bërë pasi ka patur një draft fillestar të hartuar nga Ministria.		
--	--	--	---	--	--

			Njoftimi i konsultimit publik bëhet pasi të jetë rënë dakord me drejtoritë përkatëse dhe/ose institucionet e linjës (kur akti është në bashkëpropozim) mbi një draft përfundimtar, i cili do t'i paraqitet për mendim/konsultim grupeve të interesit. Sa herë hidhni të dhëna për konsultimin në RENKPë (vetëm një herë, në fillim dhe në fund apo më shumë se dy herë) Të dhënat në RENKP hidhen sa herë kemi një projektakt që kërkon konsultim publik (si rregull, një herë për çdo projektakt; përveç rasteve kur projektakti pëson ndryshime thelbësore, që kërkon të diskutohen sërish). Sa seanca / takime publike keni realizuar gjatë vitit 2019 në kuadër të procesit të konsultimit publik dhe a janë rekorde të tyre shpresore dhe regjistrime video, sipas		
--	--	--	---	--	--

			rastitë Sa evente me regjistrim video janë realizuarë Gjatë vitit 2019 anë realizuar 12 takime publike në kuadër të procesit të konsultimit publik për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Kulturës 2019-2025. Gjithashtu, janë realizuar edhe 3 takime publike në kuadër të procesit të konsultimit publik për diskutimin e draftit të Planit të Menaxhimit të Butrintit. A ka pasur raste në ministrinë tuaj kur procesi i hartimit të aktit ka filluar me kërkesën e publikut / shoqërisë civile sipas nenit 9 pika “b” e Ligjit 146/2014ë Nuk kemi patur raste kur hartimi i aktit ka filluar me kërkesën e publikut/shoqërisë civile		
--	--	--	--	--	--

			A ka rregulla të brendshme të tjera, përveç rregullores, për realizmin në praktikë të procesit konsultimit, (si prsh. Procedura Standarde të Veprimit)ë Kemi një VKM (nr.169, datë 20.02.2020), e cila aplikohet në rastin e procesit të konsultimit publik për hartimin e planeve të menaxhimit për pasuritë kulturore të paluajtshme. A keni një data bazë me organizatat e shoqërisë civile që operojnë në fushën e ministrisë suajë Po.		
141	03.08.2020	-A ka ndonjë projekt konkret Ministria e Kulturës për rikonstruksionin e Urës së Zogut? -Nëse po, kur pritet të fillojë investimi dhe sa mund të kushtojë?	18.08.2020 “Ura e Zogut”gëzon statusin pasuri kulturore me emërtimin “Ura e Matit”, monument kulture kategoria e I-rë, shpallur me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 313, datë 08.07.1999. Aktualisht Ministria e Kulturës, nëpërmjet institucioneve e saj të specializuara, nuk ka të	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail	Nuk ka

			hartuar asnjë projekt për rikonstruksionin e pasurisë kulturore të sipërcituar.		
142	13.08.2020	Qeveria shqiptare miratoi këto ditë Planin e Menaxhimit të Integruar për Parkun Kombëtar të Butrintit 2020-2030. Në këtë plan parashikohet menaxhimi i Qytetit Antik të Butrintit përmes një partneri strategjik dhe krijimit të një fondacioni. A ka nisur Ministria e Kulturës hedhjen e hapave për këtë proces? UNESCO ka kërkuar për autoritetet shqiptare një Plan menaxhimi, të kombinuar dhe të integruar për Butrintin (Pjesa natyrore dhe Qyteti antik) ndërkohë që Plani i miratuar përfshin menaxhimin përmes Fondacionit	24.09.2020 A ka nisur Ministria e Kulturës hedhjen e hapave për këtë proces? Përgjigje Fondacioni i posaçëm do të bashkëthemelohet në kuadër të një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Partnerit Strategjik. Krijimi i Fondacionit bazohet në nenin 172 të ligjit 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, VKM-së nr.625, datë 4.9.2019 “Për miratimin e rregullave të administrimit të pasurive kulturore publike dhe të funksionimit të subjekteve juridike të themeluara në formën e fondacionit” dhe udhëzimit nr. 583, datë 14.10.2019 të Ministrit të Kulturës “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave standarde të kalimit të pronës në administrim”. Organizimi dhe funksionimi i fondacioni do të nënshtrohet rregullave të legjislacionit civil në	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail	Nuk ka

		vetëm për Qytetin Antik A i përmbush ky hap pritshmëritë, jo vetëm të UNESCOS për menaxhimin gjithëpërfshirës të Parkut Kombëtar Butrint? Kritikët e Planit të ri të menaxhimit thonë se përfshirja e një fondacioni shkel konvenat ndërkombëtare dhe përgjegjësitë e “shtetit palë” në menaxhimin e një pasurie botërore, siç është Butrinti. Sipas kritikëve parku ka aktualisht një integritet të lartë financiar dhe menaxhimi i tij nuk ka nevojë për një partneritet shtet – privat. A ka Ministria komente lidhur me këto kritika ?	fuqi për organizimin dhe funksionimin e organizatave jofitimprurëse, si dhe legjislacionit për trashëgimisë kulturore. Marrëveshja e menaxhimit midis Ministrisë së Kulturës dhe fondacionit të ri do të vendosë detyrimet dhe detyrat specifike të palëve. Sipas parashikimeve të ligjit 27/2018 kjo marrëveshje do t’i nënshtrohet miratimit nga ana e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Ministria e Kulturës në çdo rast do të garantojë mbrojtjen e nevojave të menaxhimit të pasurisë në dy nivele: si bashkëthemelues dhe si palë mbikëqyrëse e shtetit që do të sigurojë përmbushjen e çdo detyrimi nga marrëveshja e menaxhimit. 2. UNESCO ka kerkuar per autoritetet shqiptare nje Plan menaxhimi, te kombinuar dhe te integruar per Butrintin (Pjesa natyrore dhe Qyteti antik) ndërkohe qe Plani i miratuar perfshin menaxhimin		
--	--	--	---	--	--

			permes Fondacionit vetem per Qytetin Antik A i permbush ky hap pritshmerite, jo vetem te UNESCOs per menaxhimin gjithëperfshires te Parkut Kombetar Butrint? Përgjigje Plani i Menaxhimit të Integruar (PMI) përfshin të gjithë territorin e Parkut Kombëtar Butrint, me sipërfaqe prej 9,424 ha, pjesa më e madhe e të cilit, me sipërfaqe prej 8,591.2 ha, shërben si zonë mbrojtëse e sitit Pasuri Botërore të Butrintit prej 2,500 ha, pra jo vetëm qytetin antik. Plani bazohet në ruajtjen e Vlerës së Jashtëzakonshme Universale të pasurisë së trashëgimisë botërore “Butrint”, duke marrë në konsideratë në mënyrë të integruar të gjitha burimet kulturore dhe natyrore. PMI fokusohet edhe në një model të ri administrimi dhe menaxhimi për Zonën A3 me vlera të trashëgimisë kulturore prej 614,3 ha, në përgjegjësi		
--	--	--	--	--	--

			administrimi të Ministrisë së Kulturës (në bazë të VKM-Nr. 495, datë 22.7.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 693, datë 10.11.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit "park kombëtar"", të ndryshuar). Drafti i PMI ka qenë objekt i një procesi të gjatë konsultimi gjatë hartimit dhe në përfundim të finalizimit të tij. Në përputhje me linjat guidë operationale për zbatimin e Konventës së UNESCO-s për Mbrojtjen e trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore të ratifikuar nga shteti shqiptar, drafti i PMI ka qenë objekt i disa konsultimeve dhe takimeve pune me Qendrën e Trashëgimisë Botërore/UNESCO. Gjatë këtij procesi të gjatë konsultimi me QTB/UNESCO dhe trupat këshillimore ICOMOS dhe ICCROM është bërë rishikimi i draftit të planit duke shtjelluar, sqaruar, plotësuar kërkesat dhe		
--	--	--	---	--	--

			rekomandimet e të dy trupave këshillimore në funksion të përmirësimeve të seksioneve të ndryshme të draftit të planit. Gjithashtu gjatë procesit të hartimit të draftit janë zhvilluar: - seminare, takime dhe intervista me përfaqësues të bashkive të Sarandës, Konispolit dhe Finiqit, kryepelqë të fshatrave të Vrinës, Shëndellit, Xarrës dhe Mursit, si dhe grupe të tjera me ekspertizë të veçantë lokale (shoqëri turistike dhe udhërrëfyes turistikë, që kanë lidhje me burimet kulturore dhe natyrore, fermerë lokal, aktivistë të mjedisit dhe zejtarë lokal, përfaqësues të subjekteve private, që ushtrojnë veprimtari ose janë licensuar për aktivitetet e peshkimit dhe akuakulturës), për identifikimin e problematikave që ndikonin në këto grupe dhe propozimin e zgjidhjeve të mundshme. - konsultimet individuale në mënyrë të vazhdueshme me përfaqësues të institucioneve qendrore shtetërore të cilët kanë fushë përgjegjësie dhe kanë impakt të		
--	--	--	---	--	--

			drejtpërdrejtë në Parkun Kombëtar të Butrintit të tillë si: Zyra për Administrim dhe Koordinim të Parkut Kombëtar të Butrintit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Instituti Kombëtar për Trashëgiminë Kulturore, Instituti i Arkeologjisë, Akademia e Studimeve Albanologjike, Universiteti i Tiranës, AKZM – Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, AdZM – Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura, Vlorë Në përfundim të finalizimit të draft Planit, janë mbajtur prezantime publike me një sërë grupe interesi dhe palë të interesuara të mbajtura në Bashkinë e Sarandës, Parkun Kombëtar Butrint dhe Tiranë me pjesëmarrje të gjerë të specialistëve të mjedisit dhe trashëgimisë kulturore, operatorë turistikë, institucioneve të pushtetit vendor, arkeologë të Institutit Arkeologjik,		
--	--	--	---	--	--

			përfaqësues të komunitetit vendas nga njësitë administrative Konispol, Xarrë, Markat, artizanë vendas që ushtrojnë aktivitet sezonal në Parkun Kombëtar Butrint, përfaqësues të institucioneve qendrore dhe vendore përgjegjëse për kulturën, natyrën, planifikimin urban, përfaqësues të institucioneve të specializuara pjesë e Akademisë së Studimeve Albanologjike, personalitete akademikë dhe studiues të fushës së trashëgimisë, mjedisit, planifikimit urban, turizmit, grupe interesi dhe përfaqësues të komunitetit lokal. Në përmbledhje të sa më lart, PMI ka trajtuar, integruar dhe reflektuar mendime, komente, qëndrime, sugjerime dhe rekomandimet e dhëna gjatë të gjithë këtij procesit të gjatë dhe gjithëpërfshirës konsultimi. 3. Kritiket e Planit të ri të menaxhimit thone se perfshirja e nje fondacioni shkel konvenat		
--	--	--	--	--	--

			nderkombetare dhe pergjegjesite e “shtetit pale” ne menaxhimin e nje pasurie boterore , sic eshte Butrinti. Sipas kritikeve parku ka aktualisht nje integritet te larte financiar dhe menaxhimi i tij nuk ka nevojte per nje parneritet shtet –privat. A ka Ministria komente lidhur me këto kritika ? Përgjigje Sic edhe parashtruar më lart, drafti i PMI ka qenë objekti i një konsultimi të gjatë me QTB/UNESCO-n dhe trupat këshillimomre ICOMOS dhe ICCROM. PMI është hartuar në referencë të plotë me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë (27/2018), Ligjin për Zonat e Mbrojtura (81/2017) dhe rekomandimet e Vendimeve të Komitetit të Trashëgimisë Botërore dhe organeve këshillimore të Qendrës së Trashëgimisë Botërore/UNESCO. Plani bazohet në ruajtjen e Vlerës së Jashtëzakonshme Universale të pasurisë së trashëgimisë botërore “Butrint”, duke marrë në konsideratë në mënyrë		
--	--	--	--	--	--

			të integruar të gjitha burimet kulturore dhe natyrore. Në lidhje me sa cituar nga ju “Sipas kritikeve parku ka aktualisht një integritet të lartë financiar dhe menaxhimi i tij nuk ka nevojë për një partneritet shtet –privat” sqarojmë si më poshtë vijon: Edhe pse sistemi aktual i menaxhimit ka siguruar i sforcuar mbrojtjen e vlerave kulturore të Parkut, ai nuk është fleksibël, nuk ka arritur pritshmëritë e tij dhe nuk garanton në perspektivë mbrojtjen dhe ruajtjen e vlerave kulturore dhe natyrore të sitit dhe zhvillimin e integruar të tij. Nevojat për ndryshim diktohen nga nevojat për të sjellë burime të reja financimi, të qëndrueshme dhe afatgjatë dhe qasje të reja menaxhimi për parkun kombëtar. Për këtë qëllim PMI ka analizuar modele alternative menaxhimi bazuar në përvoja të mira ndërkombëtare të cilat mund të aplikohen edhe në rastin e Butrintit. Plani i referohet shembujve më të mirë të praktikës nga		
--	--	--	---	--	--

			Mbretëria e Bashkuar, SH.B.A., Gjeorgji; Italia, Shqipëria, Franca, Turqia. Modeli i ri që propozohet për menaxhimin e parkut kombëtar Butrint përmes krijimit të një fondacioni të dedikuar të bashkë-themeluar nga Ministria e Kulturës dhe një partner privat do të sigurojë: - menaxhim të integruar të pasurive kulturore dhe natyrore në përputhje me standartet ndërkombëtare të një qendre njëherësh pasuri botërore e UNESCO-s dhe sit RAMSAR - lehtësira, fleksibilitet dhe avantazhe në mbledhjen e fondeve, shfrytëzimin e financimeve nga burime të ndryshme, rritjen e të ardhurave nëpërmjet aktivitetit tregtar, sponsorizimit, angazhimeve të palëve të treta - ekspertizë të kualifikuar menaxhimi, kërkimi, konservimi, marketingu, etj., në përputhje me standartet dhe nevojat bashkëkohore - strukturë menaxhimi në sit më të madhe në numër dhe të		
--	--	--	--	--	--

			kualifikuar për fushat e nevojshme të ekspertizës dhe menaxhimit - zhvillim të qëndrueshëm për të gjithë Parkun Kombëtar të Butrintit dhe avantazhe ekonomike për komunitetin lokal nëpërmjet rritjes së fondeve, investimeve në përmirësimin e infrastrukturës turistike, zhvillimin e kapaciteteve lokale dhe rritjes së punësimit në Park. Për sa më sipër, administrimi nëpërmjet këtij modeli, në terma ekonomiko-financiarë dhe efektiviteti, synon zhvillimin e qëndrueshëm për të gjithë Parkun Kombëtar të Butrintit dhe komunitetin përreth.		
143	8.09.2020	Kërkesë për informacion mbi pasurinë kulturore “Ura e Darsit”-KLOS	23.09.2020 të interesuarit i është kthyer përgjigja, referuar të gjitha masave të mara nga MK	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail	Nuk ka
144	19.11.2020	Material për turizmin Kulturor.	20.11.2020 Programin e Trashëgimisë Kulturore 2013-2017, bashkëlidhur gjendet linku ku tregohen shtyllat kryesore të këtij programi:	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail	Nuk ka

			https://kultura.gov.al/p/rogrami-i-trashegimise-kulturore-2013-2017/		
--	--	--	---	--	--